



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 94

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 5 qershor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 197, datë 29.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10403
Dekret i Presidentit nr. 198, datë 29.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 10403
Dekret i Presidentit nr. 199, datë 29.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 10403
Dekret i Presidentit nr. 200, datë 30.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10404
Dekret i Presidentit nr. 201, datë 30.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10404
Dekret i Presidentit nr. 202, datë 30.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10404
Dekret i Presidentit nr. 203, datë 30.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10405
Dekret i Presidentit nr. 204, datë 30.5.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10405
Dekret i Presidentit nr. 206, datë 31.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 10405
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 2, datë 28.5.2024	Mbi kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesëpropozimet për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit..... 10405
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 193, datë 30.4.2024	Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar..... 10412

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 381, datë 24.5.2024	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar.....	10412
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 23.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2204, datë 26.4.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	10415
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 24.4.2024	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	10426
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 30.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1071 (236), datë 10.6.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.....	10471
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 95, datë 20.5.2024	Mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a.”.....	10479
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 4/9, datë 30.5.2024	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i Qendrës së fshatit Liboshë, Njësia Administrative Liboshë, Bashkia Fier”.....	10500
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ernest Matosha.....	10502
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Latif Balo.....	10502

**DEKRET****Nr. 197, datë 29.5.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Noel Pëllumb Kallaba

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 198, datë 29.5.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Vangjel Jorgji Xhima
2. Sonila Sazan Sulaj Kloppenborg

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 199, datë 29.5.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Oltian Besim Dabinovci
2. Valdeta Esat Dokollari (Osmani)
3. Karima Ramdane Saad
4. Mary Jane Dagunio Celso San Diego

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 200, datë 30.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Vinçenc Kolë Preka
2. Marinela Hyso Pashaj
3. Arba Bardhyl Kuçi (Bejko)
4. Pjetër Ndue Paloka
5. Klotilda Martin Shpati (Kola)
6. Esli Kanto Shpati
7. Ersila Kanto Shpati
8. Hera Kanto Shpati

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bajram Begaj**DEKRET****Nr. 201, datë 30.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edes Fatmir Bocaj
2. Petrit Tahir Toshi
3. Ava Astrit Hakberdi (Çifliku)
4. Arlind Islam Ceka
5. Violca Pjetër Pjetri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bajram Begaj**DEKRET****Nr. 202, datë 30.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Andrea Nesti Nita
2. Edon Shefqet Meda
3. Kledis Dashamir Koltraka
4. Persa Millo Matanovic (Kershtoja)
5. Aida Agim Buzi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 203, datë 30.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Daniel Dritan Lybeshari
2. Anita Rifat Curaj (Abdyli)
3. Katerina Spiro Koçi
4. Orsiola Xhevair Jakschütz (Çela)
5. Enkelejd Avdi Harizi
6. Marina Frederik Shestani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 204, datë 30.5.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Artan Mihal Prifti
2. Edlir Çelnik Hoxhallari
3. Isilda Sokol Isufi

4. Elona Agim Xhulaj**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 206, datë 31.5.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Svetlana Vladimir Haxhiu (Osipova)
2. Juan Manuel Eugenio De Jesus Ciro Marin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM**Nr. 2, datë 28.5.2024****MBI KRITERET DHE AFATET NË
LIDHJE ME KËRKESËPROPOZIMET
PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË
PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës



2, të nenit 31/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e kriterëve dhe afateve në lidhje me kërkesë propozimet për të përfituar mbështetje financiare për projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit, sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “c” të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar.

2. Për të përfituar mbështetje financiare, kërkesë propozimet në fushën e turizmit duhet që:

a) të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend dhe politikat e ministrisë për zhvillimin e industrisë së turizmit;

b) të promovojnë industrinë e turizmit për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës;

c) të promovojnë produktet dhe destinacionet turistike, vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit në përputhje me kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse;

d) të nxisin edukimin profesional të burimeve njerëzore të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit, në funksion të rritjes së cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit;

e) të ndikojnë në digjitalizimin e industrisë së turizmit për të rritur efikasitetin e përpjekjeve për zhvillim të produkteve dhe shërbimeve inovative;

f) të përmirësojnë kornizën e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike;

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI QË PLOTËSOJNË PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË PËR TË PËRFITUAR MBËSH-TETJE FINANCIARE PËR PROJEKTE NË FUSHËN E TURIZMIT

1. Kriteret që duhet të plotësojë personi fizik, juridik, vendës ose i huaj (këtu e në vijim “subjekti”) për të përfituar mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit, janë si më poshtë:

a) të jetë i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të ketë eksperiencë të ngjashme në fushën e kulturës, turizmit, argëtimit, promovimit;

c) të mos ketë detyrime përmbarimore;

d) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;

dh) të ketë përmbushur detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) të ketë përmbushur detyrimet për pagimin e kontributeve shoqërore në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

2. Dokumentacioni që depozitohet nga subjekti për të përfituar mbështetje financiare është si më poshtë:

2.1 Për projekte dhe veprimtari të ideuara dhe të propozuara nga vetë ministria përgjegjëse për turizmin/Agjencia Kombëtare e Turizmit, subjekti depoziton:

a) kërkesën që përmban shprehjen e interesit për marrjen pjesë në procedurë;

b) portofolin e veprimtarive dhe aktiviteteve të realizuara ndër vite;

c) certifikatën e regjistrimit, regjistruar në organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi;

d) ekstraktin e regjistrit tregtar, në rast se subjekti është person fizik apo juridik, ose vërtetimin e regjistrimit si organizatë jofitimprurëse;

e) vërtetimin se nuk ka detyrime përmbarimore;

f) vërtetim se nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;

g) vërtetim se ka përmbushur detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

h) vërtetim se ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

2.2 Për projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendës ose të huaj, subjekti përveç dokumentacionit të parashikuar në shkronjat “b” deri në “h”, të pikës 2.1, të këtij udhëzimi, depoziton edhe:

a) formularin e aplikimit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) tabelën e kostove financiare, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Formulari i aplikimit dhe tabela e kostove financiare, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, plotësohet në mënyrë të detajuar dhe që përmban të



dhëna të plota për subjektin/ përfaqësuesin ligjor/ përshkrimin e projektit dhe aktiviteteve përbërëse, data dhe vende ku ato zhvillohen, si dhe të kenë të pasqyruara kosto reale të tregut.

III. AFATET PËR PARAQITJEN E KËRKESË PROPOZIMEVE PËR FINANCI-MIN E PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

1. Kërkesë propozimet për projektet në fushën e turizmit sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, i ndryshuar, paraqiten në çdo kohë përgjatë vitit buxhetor:

a) për projektet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 31, Ministria/Agjencia Kombëtare e Turizmit bën publike në faqen zyrtare të institucionit propozues dhe/ose në Buletin e Njoftimeve Zyrtare, thirrjen për aplikim duke specifikuar tematikën ku fokusohet thirrja, kriteret dhe afatet që duhet të plotësojnë subjektet për të përfituar mbështetjen financiare.

b) për projektet e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 1, të nenit 31, Ministria/Agjencia Kombëtare e Turizmit, kërkon bashkëpunimin e subjekteve të specializuara mbi analizën e tregut për veprimtari/shërbime/produkte të ngjashme me zërat buxhetore të projektit të ideuar/propozuar.

2. Rregullat që ndiqen në zbatim të pikës 1, të këtij kreu, janë si më poshtë:

a) Struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit në Ministrinë përgjegjëse për turizmin/Agjencia Kombëtare e Turizmit, harton një memo informuese respektivisht mbi iniciativën konkrete, me një parashikim të përafërt financiar, drejtuar Ministrit përgjegjës për turizmin/titullarit të institucionit. Struktura përgjegjëse, në varësi të rastit apo kompleksitetit të projektit, merr mendimet parapra-ke të drejtorive të tjera që lidhen direkt ose indirekt me iniciativën;

b) Ministri përgjegjës për turizmin/ titullari i institucionit, në rast se është dakord me iniciativën, udhëzon ngritjen e kolegjiut, sipas pikës 1, të nenit 31/1 dhe pikës 2, të nenit 31/3, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmintitullari të institucionit, sipas pikës 2, të nenit 31/2 dhe pikës 3, të nenit 31/3, ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar;

c) Subjekti plotëson kriteret sipas pikës 1, të kreut II dhe depoziton dokumentacionin e parashikuar në

pikën 2, të kreut II, të këtij udhëzimi. Në varësi të natyrës së projektit dhe veprimtarisë, me propozim të Kolegjiut, mund t’i kërkohej subjektit të paraqesë dokumentacion shtesë për të provuar ekspertizën dhe kapacitetin profesional, ekonomik dhe teknik në përmbushjen e shërbimit që ofrohet.

3. Ministri përgjegjës për turizmin/ titullari i institucionit, me propozimin e kolegjiut, miraton projektet dhe veprimtaritë në fushën e turizmit që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit.

4. Lista e projekteve fituese, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut III, publikohet në faqet zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për turizmin/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe vijohet me nënshkrimin e kontratave me subjektet fituese.

5. Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe realizimit të aktiviteteve kryhet nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe/ apo drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Në përfundim të aktivitetit/ projektit, përgatitet relacioni i monitorimit nga grupi i monitorimit. Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit caktohen me urdhër ministri, ndërsa përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe/apo Drejtoritë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, caktohen rast pas rasti nga titullari i institucionit përkatës.

6. Pagesat e përfituara nga fondi buxhetor do të kryhen 60% e vlerës, të paktën 5 ditë përpara fillimit të projektit dhe 40% e vlerës në përfundim të projektit, kundrejt dokumenteve që vërtetojnë zhvillimin dhe shpenzimet e kryera në shërbim të projektit.

7. Përfitimi financiar realizohet pasi të depozitohet shkresa drejtuar Drejtorisë së Financës, me të gjitha materialet financiare dhe promovuese të aktivitetit.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit në Ministrinë përgjegjëse për turizmin/Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe kolegjiutet përkatëse për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi



MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

ANEKSI 1

FORMULARI I APLIKIMIT

PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË
FUSHËN E TURIZMIT

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit	
Emri i Aplikantit	
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës, Nr.)	Numri i Vendimit dhe Data e regjistrimit në Gjykatë;
	NIPT-i
	Emri i Bankës Numri IBAN Nr. i Llogarisë Bankare (në lekë)
Adresa:	
E-mail:	
Ëëbsite:	
Nr. Tel:	
Kohëzgjatja e projektit	< datë/muaj nga / deri>
Vendi/-et ku zbatohet projekti	
Personi i kontaktit	
Funksioni:	
Buxheti total:	
Fondet e kërkuara nga MTM:	
Informacion për bashkëfinancim	
Partnerët e projektit:	



PJESA II - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Titulli i projektit:

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (maksimumi 10 rreshta).

[Shpjegoni...]

Objektivat e projektit (maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv):

1. [Shpjegoni...]

2. [Shpjegoni...]

3. [Shpjegoni...]

Etj.

Aktivitetet kryesore të projektit (maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet, të planifikuar në çdo fushë)

1. [Shpjegoni...]

2. [Shpjegoni...]

3. [Shpjegoni...]

Etj.

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (Maksimumi 5 rreshta):

[Shpjegoni...]

A është projekti/prodakti objektivisht i verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve (Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):

Aktiviteti 1:

Projekti/Produkti rezultatet e pritura dhe treguesit lidhur me: [Shpjegoni...]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

**Plotëso: Tabelën për aktivitet/nën-aktivitetet e projektit*

Aktiviteti (Përshkrimi)	Qyteti	Vendi/ data/ora	Periudha	Fusha/ Gjinia	Nr. i Audiençës (parashikim)	Nr. personave të angazhuar (pagesa honorar)	Partneri Zbatues

Shënim:

- Ju lutem, shënoni **Aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkohen.



Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës suaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Struktura. Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti I saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Partneri 2

Emri organizatës: [Shpjegoni...]

Personi i kontaktit: _____

E-mail: _____

Adresa: _____

Faqja në internet: _____

Etj.

PJESA IV: BUXHETI

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruara dhe të mundshme?

***PLOTËSO TABELËN PËR KOSTOT FINANCIARE TË PROJEKTIT- sipas Aneksit 2**



Aneksi 2

Projekti :

Aplikanti:

Koha e zbatimit: nga/deri:

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në Lekë	TOTAL	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-
SHPENZIMET SIPAS ZËRAVE PËRKATËS									
1.	PROMOCIONI DHE PËRGATITJE Ftesa, poster, baner, programi (Të specifikuara sipas pershkrimit të eventit dhe vendit)								
1.1									
1.2									
1.3									
1.4									
	TOTAL 1								
2.	PAGESA E GRUPIT REALIZUES								
2.1									
2.2									
2.3									
2.4									
	TOTAL 2								
3.	PAGESA PËR PERSONIN/ PERSONAT E ANGAZHUAR								
3.1									
3.2									
3.3									
3.4									
	TOTAL 3								
4.	SHPENZIME TEKNIKE (Ndriçim, Foni, etj)								
4.1									
4.2									
4.3									
4.4									
	TOTAL 4								
5.	SHPENZIME TË TJERA								
5.1									
5.2									
5.3									
5.4									
	TOTALI 5								
	TOTAL (edhe në %):								

Ju lutem shtoni linja buxhetore për çdo aktivitet.

Sqarim:

1. Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe vetë aplikantin), edhe si % e buxhetit total për projektin;
2. Vlerat financiare të paraqitura në këtë formular, duhet të jenë të shprehura në LEKË.



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 193, datë 30.4.2024

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
VITIT SHKOLLOR 2024–2025 NË
SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2024–2025 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

- a) mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 13 qershor 2025;
- b) pushimet fillojnë më 23 dhjetor 2024 dhe mbarojnë më 3 janar 2025;
- c) pushimet fillojnë më 31 mars 2025 dhe mbarojnë më 4 prill 2025;
- ç) provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 16–27 qershor 2025.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

- a) mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 13 qershor 2025;
- b) për maturat, mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 30 maj 2025;
- c) pushimet fillojnë më 23 dhjetor 2024 dhe mbarojnë më 3 janar 2025;
- ç) provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2–27 qershor 2025.

3. Në arsimin profesional:

- a) mësimet fillojnë më 9 shtator 2024;
- b) për nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2, si dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare, mësimet mbarojnë më 13 qershor 2025;
- c) për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe për nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2, mësimet mbarojnë më 30 maj 2024;

ç) për të gjithë nxënësit maturantë, mësimet mbarojnë më 16 maj 2025;

d) pushimet fillojnë më 23 dhjetor 2024 dhe mbarojnë më 3 janar 2025;

dh) provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të nivelit II dhe III të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) zhvillohen në periudhën 2–13 qershor 2025;

e) provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të nivelit IV të KSHK-së zhvillohen në periudhën 26–30 maj 2025;

ë) provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 2–27 qershor 2025.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 381, datë 24.5.2024

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË
MINISTRIT NR. 275, DATË 5.5.2023,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE
VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË
TJERË, NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të



Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve;

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:
- a) në pjesën B, të shtojcës 1, miratohet për shtim 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - b) rinovohet regjistrimi për 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - c) zgjaten afatet e regjistrimit për 25 (njëzet e pesë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - ç) hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përditësimi sipas shkronjave “b” dhe “c” të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.
3. Për PMB-të me përmbajtje të lëndëve vepruese sipas shkronjës “ç”, çregjistrimi dhe heqja nga tregu të kryhen brenda afateve të përcaktuara sipas këtij urdhri, si dhe të njoftohen Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

1. MIRATOHET PËR SHTIM NË PJESËN B, TË SHTOJCËS 1, LËNDA VEPRUESE BAZIKE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Dispozita specifike
1	Hydroksid magnezi E528 CAS No: 1309-42-8 CIPAC No: I padisponueshëm	magnesium dihydroxide	950 g/kg. Papastërti relevante: Plumb < 2 mg/kg Arsenik < mg/kg	2 prill 2024	Nuk ka

2. RINOVOHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR:
2.1 LËNDA VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Trinexapac-ethyl CAS No: 95266-40-3 CIPAC No: 732.202	ethyl (1 <i>RS</i> ,4 <i>EZ</i>)-4-cyclopropyl(hydroxy)methylene-3,5-dioxocyclohexanecarboxylate	950 g/kg. Papastërtitë e mëposhtme nuk duhet të kalojnë nivelet e mëposhtme në materialin teknik: -toluen: 3 g/kg; - etil (1 <i>RS</i>)-3-hidroksi-5-oksocikloheks-3-ene-1-karboksilat (CGA158377): 6 g/kg.	1 maj 2024	30 prill 2039	Në vlerësimin e përgjithshëm, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë, për: - specifikimet e materialit teknik të përdorur në produktet për mbrojtjen e bimëve, veçanërisht kur kryhen vlerësime të ekuivalencës në përputhje me nenin 38 të rregullores (KE) nr. 1107/2009; - vlerësimin e marrjes së konsumatorit nga dieta duke marrë parasysh mbetjet e metabolitëve të trinexapac-etilit dhe ndikimin e përpunimit; - nivelet e mbetjeve të metabolitëve të trinexapac-etilit, kur kashta përdoret si ushqim për kafshët. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë kufizime për ushqimin e kafshëve me kashtë dhe masa për zbutjen e rrezikut, sipas rastit. Aplikanti të paraqesë informacion konfirmues gjatë aplikimit në lidhje me efektin e proceseve të trajtimit të ujit në natyrën e mbetjeve të trinexapac-ethyl dhe metabolitëve të tij të pranishëm në ujërat sipërfaqësore, kur uji sipërfaqësor është nxjerrë për ujë të pijshëm, nga 1 prill 2026.



2.2 LËNDËT VEPRUESE ME RISK TË ULËT SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Urea CAS No: 57-13-6 CIPAC No: 913	Urea	980 g/kg. Papastërtitë e mëposhtme janë konsideruar si shqetësim toksikologjik dhe është vendosur një nivel maksimal i: Biure: < 12 g/kg; Formaldehid: < 0,5 g/kg; Kadmium: < 1 mg/kg; Mërkuri: < 0,1 mg/kg; Plumbi: < 1 mg/kg; Arseniku: < 1 mg/kg.	1 maj 2024	30 prill 2039	Në vlerësimin e përgjithshëm, do t'i kushtohet vëmendje veçantë specifikimit të materialit teknik si i prodhuar komercialisht mbi bazën e një analize për të paktën pesë njësive përfaqësuese. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.
2	Proteina të hidrolizuara CAS No: I padisponueshëm CIPAC No: 901	I padisponueshëm	Proteinat e hidrolizuara. <i>Indet e hidrolizuara të kafshëve, duke përjashtuar lëkurën e ripërtypësve</i> (pa emër të përbashkët ISO): -708 g/kg mbi bazën e peshës së thatë [vargu në TK (koncentrat teknik) 400-434 g/kg]. Proteinat e hidrolizuara. <i>Melasa e panxharit të pasuruar me ure, e hidrolizuar</i> (pa emër të përbashkët ISO): -110 g/kg mbi bazën e peshës së thatë [vargu në TK (koncentrat teknik) 90-110 g/kg]. Proteinat e hidrolizuara. <i>Hidrolizat e proteinës së kolagjenit</i> (pa emër të përbashkët ISO): -582 g/kg mbi bazën e peshës së thatë [vargu në TK (koncentrat teknik) 249-262 g/kg]. Plumbi, kadmiumi, arseniku, zhiva dhe biureti në përputhje me legjislacionin për produktet plehëruese. Formaldehid nën 1 g/kg.	1 maj 2024	30 prill 2039	Në vlerësimin e përgjithshëm, do t'i kushtohet vëmendje veçantë specifikimit të materialit teknik për “proteina të hidrolizuara-melasa panxhari të pasuruar me ure, të hidrolizuar” siç prodhohet komercialisht mbi bazën e një analize për të paktën pesë njësive përfaqësuese.



3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- Deri më 31 gusht 2024:

1. Dodemorph
2. Trichoderma atroviride (formerly T. harzianum): STRAIN: IMI 206040 – Culture collection No IMI 206040, ATCC 20476;

3. Fatty acids C7 to C20: Lauric Acid; Oleic Acid; Fatty acids C8-C10 Me esters; Methyl octanoate; Methyl decanoate;

Gjithsej: 3 (tre) lëndë vepruese.

- Deri më 15 dhjetor 2024:

1. Fatty acids C7 to C20: Pelargonic Acid; Fatty acids C7-C18 and C18 unsaturated potassium salts; Caprylic Acid; Capric Acid.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 prill 2025:

1. Trichoderma atroviride (formerly T. harzianum): STRAIN: T11, Culture collection: No Spanish type culture collection CECT 20498, identical with IMI 352941

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 qershor 2026:

1. Prosulfuron

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 korrik 2026:

1. Dodine
2. 6-benzyladenine
3. 1-decanol
4. Fluometuron
5. Sintofen
6. Sulfat aluminium

Gjithsej: 6 (gjashtë) lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2026:

1. Quinmerac
2. Phosphid zinku
3. Orange oil (Vaj portokalli)
4. Tembotrione
5. Sodium silver thiosulfate (tiosulfat argjendi natriumi)

Gjithsej: 5 (pesë) lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2027:

1. Azadirachtin
2. Bupirimate
3. Dithianon
4. Hexythiazox
5. Lime Sulphur (squfuri me gëlqere)
6. Isoxaben
7. Tau-fluvalinate
8. Tebufenozide

Gjithsej: 8 (tetë) lëndë vepruese.

Totali: 25 (njëzet e pesë) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Mepanipyrim

Nuk rinovohet për miratim lënda vepruese mepanipyrim.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë mepanipyrim, brenda datës 20 nëntor 2024.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë mepanipyrim, të përfundojë brenda datës 20 maj 2025.

2. Dimethomorph

Nuk rinovohet për miratim lënda vepruese dimethomorph.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë dimethomorph, brenda datës 20 nëntor 2024.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë dimethomorph, të përfundojë brenda datës 20 maj 2025.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

VENDIM

Nr. 33, datë 23.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimimi	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.4.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 23 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “Energy Albania Group” sh.p.k., shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., përfaqësuar nga zonja Anna Xheka Fröb, me autorizim.



SUBJEKT I INTERESUAR:

“Adre Hydropower” S.r.l., përfaqësuar në gjykim nga studio ligjore “Kalo Associates”, me avokat Armando Toslluku, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2204, datë 26.4.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueseve, të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “Adre Hydropower” S.r.l., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuerset, shoqëritë “Energy Albania Group” sh.p.k. dhe “MP-HEC” sh.p.k., kanë si objekt të aktivitetit të tyre, ndër të tjera, operimin, ndërtimin dhe transferimin e hidrocentraleve. Gjithashtu, rezulton se kërkuësja, shoqëria “Energy Albania Group” sh.p.k., është zotëruese e 100% të kuotave të kapitalit të kërkueses tjetër, shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k.

2. Për shkak të pamundësive financiare për përfundimin e një hidrocentrale, kërkuerset kanë hyrë në bisedime me shoqërinë “Adre Hydropower” S.r.l., për blerjen nga kjo e fundit të 90% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. Për këtë qëllim, në datën 19.3.2015, kërkuerset kanë nënshkruar kontratën paraprake të shitjes së kuotave, sipas së cilës shoqëria “Energy Albania Group” sh.p.k. ka marrë përsipër shitjen e 90% të kuotave që kjo shoqëri zotëronte në shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k. te shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l., pas përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm

dhe pas marrjes së miratimit nga ministria përkatëse për kalimin e këtyre kuotave.

3. Sipas paragrafit 9 të kontratës paraprake të shitjes së kuotave: “*Çdo mosmarrëveshje e çdo lloji dhe natyre që lind ndërmjet Palëve, për interpretimin, ekzekutimin dhe përfundimin e kësaj marrëveshjeje ose të akteve të vendosura në zbatim të saj, si dhe çdo mosmarrëveshje ose divergjencë të çdo lloji dhe natyre, që mund të lindë ndërmjet Palëve, në lidhje me tërheqjen nga kontrata do t’i nënshtrohet vendimit të një Bordi Arbitrazhi të përbërë nga tre anëtarë, të cilët do të gjykojnë sipas ligjit (...) Selia e Arbitrazhit do të jetë Romë*”. Ndërsa në paragrafin 2.3. të saj është përcaktuar se kontrata do të merrte vlefshmëri në rast se brenda datës 24.3.2015, shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l. do të kryente pagesën e shumës prej 50.000 eurosh, e cila do të shërbente si parapagesë për çmimin e shitjes së kuotave në rast se premtimi i shitjes do të finalizohet në shitje përfundimtare.

4. Në datën 24.3.2015, shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l., përmes një transferte bankare, ka kryer pagesën e shumës prej 50.000 eurosh në favor të shoqërisë “Energy Albania Group” sh.p.k., me përshkrimin sipas kontratës, datë 19.3.2015. Po në të njëjtën datë, ndërmjet shoqërisë “Adre Hydropower” S.r.l. dhe shoqërisë “Energy Albania Group” sh.p.k., është nënshkruar edhe kontrata e huas nr. 2651 rep., nr. 850 kol., datë 24.3.2015 (*kontrata e huas*), ku e para paraqitet si huadhënëse, ndërsa e dyta si huamarrëse. Afati i shlyerjes së huas është përcaktuar deri në datën 30.6.2015, me kusht që huamarrësi të mos ketë marrë brenda këtij afati lejet, licencat, autorizimet përkatëse të parashikuara nga kontrata paraprake e datës 19.3.2015, për shitjen e 90% të kuotave që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k. (neni 2.1.). Në kontratën e huas palët kanë përcaktuar se shuma e huas do të përdorej nga huamarrësi për qëllimin që ato kanë rënë dakord paraprakisht në kontratën paraprake të shitjes së kuotave të datës 19.3.2015 (neni 5.1.). Po kështu, palët kanë rënë dakord që kontrata e huas do të kontrollohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar dhe se çdo mosmarrëveshje, keqkuptim ose pretendim që lind për këtë kontratë ose në lidhje me të, do të gjykohen nga Gjykata e Rrethit Tiranë (neni 8).

5. Në datën 23.6.2015, shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l. ka njoftuar kërkuerset se nuk do të vijonte me nënshkrimin e blerjes së kuotave. Në vijim, ndërsa kërkuerset nuk kanë pranuar kthimin e



shumës së paguar sipas kontratës paraprake të shitjes së kuotave, në vitin 2021 shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l, i është drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit, e cila, me vendimin e datës 26.1.2022, ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë “Adre Hydropower” S.r.l. kundër shoqërisë “Energy Albania Group sh.p.k. dhe shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., duke i detyruar këto të fundit t’i paguajnë shoqërisë “Adre Hydropower” S.r.l. shumën prej 49.870 eurosh. Gjatë këtij procesi, kërkueset kanë ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit të Gjykatës së Arbitrazhit, me argumentin se klauzola e arbitrazhit në kontratën paraprake të shitjes së datës 19.3.2015, është ndryshuar përmes kontratës së huas së datës 24.3.2015. Gjykata e Arbitrazhit nuk e ka pranuar këtë pretendim, duke arsyetuar, ndër të tjera, se nga përmbajtja e kontratës së huas nuk rezulton asnjë element ose arsyetim logjik nga i cili të identifikohet vullneti i palëve për të zëvendësuar klauzolën e arbitrazhit në kontratën paraprake të shitjes, përveçse palët në këto kontrata nuk janë të njëjta, ndërsa shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. palë në kontratën paraprake të shitjes, nuk është e tillë në kontratën e huas.

6. Pas përfundimit të procesit të arbitrazhit, ndërsa shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l. ka kërkuar përmbushjen e detyrimit, sipas vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit, kërkueset, duke pretenduar shuarjen e detyrimit prej 49.870 eurosh sipas kontratës së huas dhe asaj paraprake të shitjes së kuotave, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt konstatimin e shuarjes së detyrimit “kthim huaje”. Sipas argumenteve të kërkueseve në kërkesëpadi, kontrata i detyronte ato të kthenin huan vetëm në rast të mosmarrjes së lejeve, licencave dhe autorizimeve, por duke qenë përpara faktit se këto të fundit janë marrë të gjitha prej tyre, sipas kërkueseve, jemi në rastin e parashikuar nga neni 2.2., i kontratës së huas, sipas të cilit, nëse merren lejet, licencat dhe autorizimet, huaja do të konsiderohet e shlyer dhe huadhënësi nuk do të ketë të drejtën të kërkojë shumën.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka vënë në diskutim dhe dëgjuar palët në lidhje me çështjen e juridiksionit gjyqësor të ngritur nga pala e paditur “Adre Hydropower” S.r.l., me vendimin nr. 190, datë 25.1.2023, ka vendosur deklarimin e mungesës së juridiksionit të saj gjyqësor. Sipas asaj gjykate, duke qenë se marrëdhënia juridike e palëve e gjen shkakun e saj ligjor te kontrata paraprake e shitjes së

kuotave, është në dispozitat e saj që rregullohen dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me juridiksionin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që kanë shkakun e tyre në këtë kontratë. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë, bazuar në paragrafin 9 të kontratës paraprake të shitjes së kuotave, ka vlerësuar se nuk ka juridiksion për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, pasi ajo është kompetencë ekskluzive e Gjykatës së Arbitrazhit. Ndaj këtij vendimi kanë bërë rekurs të veçantë kërkueset.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2204, datë 26.4.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Edhe sipas Kolegjit Civil, kontrata e huas lidhet pashmangshmërisht me kontratën paraprake të shitjes së kuotave, ndaj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar përpara gjykatës kjo e fundit do të duhej të interpretonte dhe analizonte kushtet e kontratës paraprake të shitjes së kuotave në të cilën kontrata e huas referon, por një gjë e tillë ndalohet nga paragrafi 9 i kontratës paraprake të shitjes së kuotave që përcakton klauzolën e arbitrazhit.

9. Në datën 7.9.2023, kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.9.2023. Kolegji i Gjykatës, në datën 18.12.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se i janë cenuar:

10.1 *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë është shprehur për çështje të ligjit, të cilat janë marrë në shqyrtim kryesisht prej saj, pa njoftuar më parë palët për to, në kundërshtim me nenin 473/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, kontratën e huas dhe kontratën paraprake të shitjes së kuotave, si edhe gabon kur e quan vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit gjë të gjykuar. Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Arbitrazhit janë shprehur se nuk mund ta gjykojnë kontratën e huas, duke mos i dhënë zgjidhje përfundimtare së drejtës



së kërkueseve për shuarjen e detyrimit të kthimit të huas.

10.2 *E drejta e mbrojtjes efektive*, pasi kërkueset nuk janë njoftuar në asnjë prej formave të përcaktuara në nenin 482, pika 3, të KPC-së për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, si dhe përbërjen e trupit gjykues, edhe pse të dhënat ishin dhënë në shkallët e tjera të gjykimit.

10.3 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkueseve, duke e bërë vendimin tërësisht të paarsyetur.

10.4 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim me praktikën e saj në lidhje me juridiksionin gjyqësor. Janë mbi 20 vendime të Gjykatës së Lartë lidhur me juridiksionin vetëm në harkun kohor të viteve të fundit që e argumentojnë këtë konkluzion. Vendimet e Gjykatës së Lartë përbëjnë një shtyllë të rëndësishme të jurisprudencës si burim i së drejtës së bashku me kuadrin ligjor dhe nënligjor.

11. Subjekti i interesuar, shoqëria “Adre Hydropower” S.r.l., në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi, në rastin konkret, kërkueset kanë marrë përgjigje për pretendimet e tyre në lidhje me çështjen e juridiksionit, për të cilën vetë ato kanë pranuar atë të arbitrazhit. Në këtë kuptim, gjykatat shqiptare, duke konstatuar mungesën e juridiksionit të tyre për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, nuk i kanë mohuar aksesin kërkueseve, por ia kanë deleguar atë juridiksionit të arbitrazhit, i cili i ka dhënë përgjigje themelit të pretendimeve të tyre. Argumentet e tjera të kërkueseve në lidhje me cenimin e *së drejtës së aksesit* nga Gjykata e Lartë, pasi kjo e fundit ka injoruar faktet e çështjes, si edhe ka interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin për pavlefshmërinë e veprimit juridik, nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, pasi ato kanë të bëjnë me vlerësimin dhe interpretimin e fakteve të mosmarrëveshjes, të cilat janë kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

11.2 Edhe pretendimi i kërkueseve për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi, sipas jurisprudencës së Gjykatës, ky parim lidhet me rregullimet ligjore dhe ndryshimet e tyre të paarsyeshme, të cilat sjellin përkeqësim të gjendjes ligjore të personave që iu nënshtrohen atyre dhe nuk zbatohet për vendimet gjyqësore. Gjithashtu,

kërkueset nuk kanë sjellë asnjë argument konkret se cili disponim i vendimit të Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim me jurisprudencën e asaj gjykate. Në jurisprudencë konstante, Gjykata e Lartë ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjet në rastin e konstatimit të një klauzole arbitrazhi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueseve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkueset legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata vëren se kërkueset i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë më mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

16. Gjykata ka vlerësuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura



atyre arsytet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke zbatuar këtë qasje, në rastin konkret, Gjykata, bazuar në informacionin e marrë nga Gjykata e Lartë, vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar, i marrë në dhomën e këshillimit, është bërë i disponueshëm për palët në datën 3.7.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 7.9.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkueset legjitimohen *ratione temporis*.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkueset, ndër të tjera, kanë pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, duke argumentuar se Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim me praktikën e saj për juridiksionin gjyqësor.

19. Në lidhje me këto argumente të kërkueseve, subjekti i interesuar ka prapësuar se ato nuk kanë sjellë asnjë argument konkret se cili disponim i vendimit të Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim me jurisprudencën e asaj gjykate.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë, e cila ka autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u

përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë e të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 47, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkueset nuk kanë sjellë ndonjë argument konkret kushtetues për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Në vlerësimin e Gjykatës, fakti që në rastin e kërkueseve Gjykata e Lartë ka arritur në një përfundim/vlerësim të ndryshëm nga praktika të tjera të saj, nuk përbën *apriori* cenim të parimit të sigurisë juridike, për sa kohë që ato nuk kanë arritur të provojnë cenimin e së drejtës për proces të rregullt në një nga aspektet e tij. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se, sikundër prapësohet edhe nga subjekti i interesuar, argumentet e kërkueseve për cenimin e parimit të sigurisë juridike janë haptazi të pabazuara, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

22. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueseve, Gjykata vëren se ato kanë argumentuar se u është cenuar e drejta e aksesit dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk kanë marrë zgjidhje përfundimtare për shuarjen e detyrimit të kthimit të huas dhe se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs. Sipas tyre, Gjykata e Lartë është shprehur për çështje të ligjit, të cilat janë marrë në shqyrtim kryesisht prej saj, pa njoftuar më parë palët për to, në kundërshtim me nenin 473/a të KPC-së. Po kështu, kërkueset kanë pretenduar se u është cenuar edhe e drejta e mbrojtjes, duke argumentuar se ato nuk janë njoftuar në asnjë prej formave të përcaktuara në nenin 482, pika 3, të KPC-së (*shih faqen zyrtare dhe email-in edhe pse të dhënat ishin dhënë në shkallët e tjera të gjykimit*), për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Duke u bazuar në këto argumente, Gjykata vëren se këto pretendime hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe në drejtim të së drejtës së mbrojtjes efektive.

*B. Për themelin e pretendimeve*

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkueset kanë pretenduar se nuk kanë marrë zgjidhje përfundimtare për shuarjen e detyrimit të kthimit të huas dhe se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs. Po kështu, kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë është shprehur për çështje të ligjit, të cilat janë marrë në shqyrtim kryesisht prej saj, pa njoftuar më parë palët për to, në kundërshtim me nenin 473/a të KPC-së. Sipas tyre, ky cenim vërehet në paragrafin 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë, ku evidentohet se ajo ka verifikuar pavlefshmërinë e kontratës së huas, si çështje ligjore për herë të parë, e paparaqitur më parë në rekurs ose kundërrkurs.

24. Subjekti i interesuar ka prapësuar se në rastin konkret kërkueset kanë marrë përgjigje për pretendimet e tyre në lidhje me çështjen e juridiksionit, për të cilën vetë ato kanë pranuar juridiksionin e Gjykatës së Arbitrazhit. Në këtë kuptim, sipas subjektit të interesuar, gjykatat shqiptare, duke konstatuar mungesën e juridiksionit të tyre për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, nuk i kanë mohuar aksesin kërkueseve, por ia kanë deleguar atë juridiksionit të arbitrazhit, i cili i ka dhënë përgjigje themelit të pretendimeve të tyre.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për t'u njoftuar dhe pjesëmarrja në proces është e lidhur me vendimmarrjen, sidomos kur ajo ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'u drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë*

1.11.2022; nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

26. Sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se palëve duhet t'u jepet mundësia të paraqesin paraprakisht mendimin e tyre për çështjet ligjore të analizuar kryesisht nga ajo gjykatë në mënyrë që t'u garantohet efektivisht e drejta e aksesit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 13, datë 21.3.2023; nr. 7, datë 21.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.2.2023; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 1, datë 19.1.2018; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se juridiksioni gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkueset nëpërmjet kërkesëpadisë, me objekt konstatimin e shuarjes së detyrimit "kthim huaje". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përfundim të gjykimit ka deklaruar mungesën e juridiksionit për



shqyrtimin e kësaj çështjeje. Gjithashtu, Gjykata konstaton se në gjykatën e shkallës së parë dhe Gjykatën e Lartë është diskutuar, në thelb, për çështjen e juridiksionit dhe akteve të lidhura midis palëve, kontratës paraprake të shitjes së kuotave dhe kontratës së huas. Në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuueset, Gjykata vëren se çështja e nxjerrjes jashtë juridiksionit gjyqësor është ngritur si pretendim nga subjekti i interesuar (pala e paditur), sipas të cilit paragrafi 9 i kontratës paraprake të shitjes së kuotave parashikon se çdo lloj mosmarrëveshje do t'i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës së Arbitrazhit. Ndërsa, sipas pretendimit të kërkueseve, të ngritur në gjykatën e shkallës së parë, kjo kërkesë e subjektit të interesuar ishte e pabazuar, ndaj duhej të rrëzohej.

29. Sipas gjykatës së shkallës së parë, bazuar në nenin 59 të KPC-së, gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor. Në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, në rastin konkret, kontrata e huas, ndryshe nga ajo paraprake e shitjes së kuotave, e cila është kontrata kryesore në qëllimin e palëve, është nënshkruar vetëm nga shoqëria “Energy Albania Group” sh.p.k. Në këtë kuptim, sipas gjykatës së shkallës së parë, rezulton se baza juridike e marrëdhënies së palëve është kontrata paraprake e shitjes së kuotave dhe ky fakt është konfirmuar nga vetë palët paditëse, të cilat në këtë gjykim janë bashkë, siç janë palë edhe në kontratën paraprake të shitjes së kuotave, pasi, në të kundërt, në rast se shkaku i padisë do të ishte kontrata e huas, paditës i legjitimuar do të ishte vetëm shoqëria “Energy Albania Group” sh.p.k. Në këto kushte, duke qenë se marrëdhënia ndërmjet palëve gjente shkakun e saj ligjor në kontratën paraprake të shitjes së kuotave, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se është në dispozitat e saj që rregullohen të drejtat dhe detyrimet lidhur me juridiksionin. Nga sa më sipër, sipas gjykatës së shkallës së parë, rezulton se çdo mosmarrëveshje që shkakun e saj ligjor e ka në kontratën paraprake të shitjes së kuotave dhe aktet e nxjerra në zbatim të saj, kompetencë ekskluzive për gjykimin e tyre do të ketë Gjykata e Arbitrazhit Romë (*shih faqet 3 dhe 4 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

30. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja drejt e së cilës sjell automatikisht prishjen e vendimit. Sipas atij kolegji, nëse çështja

hyn në juridiksionin gjyqësor ose në ndonjë juridiksion tjetër, ka rëndësi të madhe për fatin e çështjes dhe për zgjidhjen përfundimtare të saj. Në këtë kuptim, Kolegji Civil ka vlerësuar se bazuar në nenin 59 të KPC-së, çështja e juridiksionit mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor nga çdo gjykatë e pushtetit gjyqësor dhe në çdo fazë gjykimi, dhe se çdo lloj gjykate në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor ose në ndonjë juridiksion tjetër, përfshirë atë të Gjykatës së Arbitrazhit. Sipas Kolegjit Civil, vlerësimin nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor ose jo, gjykata mund ta bëjë edhe kryesisht, pra dhe pa u pretenduar nga palët, kjo pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih paragrafët 17 dhe 19–20 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

31. Lidhur me paragrafin 27 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mbi të cilin kërkuueset mbështesin pretendimin e tyre, Gjykata konstaton se ai kolegji ka çmuar se kontrata e huas me të cilën pala paditëse (kërkuueset) pretendon se ka ndryshuar klauzolën e arbitrazhit, nuk është e vlefshme, pasi ajo është nënshkruar vetëm nga shoqëria “Energy Albania Group” sh.p.k. dhe nuk është nënshkruar edhe nga shoqëria tjetër “MP-HEC” sh.p.k., sikurse kontrata paraprake e shitjes së kuotave. Po kështu, sipas Kolegjit Civil, për zgjidhjen e çështjes ai do të duhej të interpretonte dhe analizonte kushtet e kontratës paraprake të shitjes së kuotave, në të cilën referon kontrata e huas, gjë të cilën e ndalon paragrafi 9 i kontratës paraprake të shitjes së kuotave, i cili përcakton klauzolën e arbitrazhit.

32. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatonin, ose të jepnin mendimin e tyre më parë, përkundrazi, rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar njësoj si gjykata e shkallës së parë, se paragrafi 9 i kontratës paraprake të shitjes së kuotave referon juridiksionin e Gjykatës së Arbitrazhit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve. Po kështu, Gjykata konstaton se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të kompetencës së tyre, kanë interpretuar përmbajtjen e kontratave dhe kanë arritur në përfundimin se ato janë të lidhura, duke



arsyetuar se kontrata e huas nuk mund të interpretohet pa analizuar kushtet e kontratës paraprake të shitjes së kuotave.

33. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vlerëson se kërkeset kanë pasur mundësi të paraqisnin paraprakisht mendimin e tyre për çështjet ligjore të analizuar nga Gjykata e Lartë, duke iu garantuar efektivisht e drejta e aksesit. Prandaj, pretendimi i tyre se Gjykata e Lartë është shprehur për çështje të ligjit, të cilat janë marrë në shqyrtim kryesisht prej saj, pa njoftuar më parë palët për to, sipas nenit 473/a të KPC-së, nuk është i bazuar. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, për shkak të lidhjes së kontratës së huas me kontratën paraprake të shitjes së kuotave, nuk duket të ketë interpretuar ose zbatuar ligjin në mënyrë arbitrare.

34. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar nga kërkeset, Gjykata konstaton se ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e tij në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes konkrete. Gjykata e Lartë ka argumentuar mjaftueshëm vendimin e saj, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve për shkakun mbi të cilin kërkeset kanë ushtruar të drejtën e rekursit, që kishte të bënte me **mungesën e juridiksionit të Gjykatës së Arbitrazhit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga juridiksioni gjyqësor shqiptar. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton se Gjykata e Lartë e ka përmbushur detyrimin e saj për arsyetimin e vendimit gjyqësor sipas standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.**

35. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueseve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive

36. Kërkeset kanë pretenduar se nuk janë njoftuar në asnjë prej formave të përcaktuara në nenin 482, pika 3, të KPC-së për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, si dhe përbërjen e trupit gjykues, edhe pse të dhënat ishin dhënë në shkallët e tjera të gjykimit.

37. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar rëndësia e së drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për

datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që u garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Kërkesat kushtetuese të procesit të rregullt ligjor janë reflektuar në përmbajtje të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, sipas të cilit, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve, në dhomën e këshillimit (*pika 1*). Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara (*pika 2*). Në shtesë të këtyre rregullave, neni 482, pika 3, i KPC-së, i zbatueshëm për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Krahës njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Këto rregulla janë detajuar në urdhrin nr. 131, datë 2.7.2021, “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve” të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

39. Në rastin konkret, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, rezulton se rekursi i paraqitur nga kërkeset është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.4.2023, ndërsa shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është caktuar të zhvillohet në datën 26.4.2023. Gjithashtu, rezulton se në datën 11.4.2023, në mjediset e Gjykatës së Lartë është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e



këshillimit në datën 26.4.2023, ku përfshihej edhe çështja e kërkueseve, si dhe përbërja e trupit gjykues. I njëjti njoftim rezulton të jetë bërë edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, po sipas faqes zyrtare të asaj gjykate, rezulton se në datën 26.4.2023, ajo ka njoftuar edhe vendimarrjen për çështjet e shqyrtuara në atë datë, ku përfshihej dhe çështja e kërkueseve. Ndërkohë, sipas akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se në rekursin e paraqitur nga mbrojtësit e kërkueseve, ata kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*email*) dhe nuk rezulton që atyre t'u jetë komunikuar njoftimi për datën dhe orën e zhvillimit të seancës individualisht në këtë mënyrë.

40. Në këtë kontekst faktesh, Gjykata ka vlerësuar se një mangësi e tillë duhet analizuar në aspektin e ndikimit të saj në të drejtën kushtetuese të mbrojtjes efektive të lidhur me të drejta të tjera procedurale kushtetuese për kërkuueset. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e respektimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Duke iu referuar këtyre standardeve, Gjykata çmon se mungesa e njoftimit individual nga Gjykata e Lartë, nëpërmjet adresave elektronike të kontaktit të lëna në paraqitjen e rekursit, nuk rezulton t'i ketë vendosur kërkuueset në pozita të pafavorshme ose të ketë ndikuar në mohimin e së drejtës së mbrojtjes, në kuptimin substancial, ndaj nuk është e mjaftueshme që ta bëjë të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të kundërshtuar. Në

nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata mban në konsideratë faktin se, nga njëra anë, janë kërkuueset që kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë nëpërmjet paraqitjes së rekursit dhe kohën e shkurtër të marrjes në shqyrtim të tij nga momenti i depozitimit. Po kështu, njoftimi për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes së tyre ishte afishuar nga Gjykata e Lartë në këndin e njoftimeve në mjediset fizike të saj, si dhe në faqen e internetit. Nga ana tjetër, ato nuk kanë sjellë asnjë argument thelbësor të ri, të paparashtuar më parë, i cili potencialisht mund të sillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tyre nga Gjykata e Lartë.

42. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueseve për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive është i pabazuar.

43. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueseve në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, si edhe në drejtim të së drejtës së mbrojtjes efektive janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 23.4.2024.

Shpallur, më 29.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim



MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes së vënë në lëvizje nga shoqëritë “Energy Albania Group” sh.p.k., dhe “MP-HEC” sh.p.k., me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, jemi kundër vendimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Kërkueset kanë paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, u ka cenuar të drejtën kushtetuese për proces të rregullt ligjor, në aspektin e aksesit në gjykatë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, për sa kohë ato nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin se detyrimi për kthimin e huas ishte shuar.

3. Pretendimi i kërkueseve është analizuar nga shumica në këndvështrimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe në përfundim është vlerësuar se pretendimi është i pabazuar. Sipas shumicës, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatonin apo të jepnin mendimin e tyre më parë, përkundrazi, rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar njësoj si gjykata e shkallës së parë, se paragrafi 9 i kontratës paraprake të shitjes së aksioneve referon juridiksionin e Gjykatës së Arbitrazhit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve. Po kështu, sipas shumicës, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të kompetencës së tyre, kanë interpretuar përmbajtjen e kontratave dhe kanë arritur në përfundimin se ato janë të lidhura, duke arsyetuar se kontrata e huas nuk mund të interpretohet pa analizuar kushtet e kontratës paraprake të shitjes së kuotave. Në vlerësimin e shumicës, kërkueset kanë pasur mundësi të paraqisnin paraprakisht mendimin e tyre për çështjet ligjore të analizuar nga Gjykata e Lartë, duke iu garantuar efektivisht e drejta e aksesit dhe se

arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, për shkak të lidhjes së kontratës së huas me kontratën paraprake të shitjes së aksioneve, nuk duket të ketë interpretuar ose zbatuar ligjin në mënyrë arbitrare (*shih paragrafët 32–34 të vendimit*).

4. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, çojmë se pretendimi i kërkueseve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të çështjes së tij/saj nga një gjykatë. E drejta e aksesit i garanton individit t’i drejtohet një gjykate, e cila duhet të degjojë pretendimet e tij/saj dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara se gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 22, datë 25.4.2023; nr. 14, datë 21.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjykata i ka kushtuar rëndësi të veçantë rasteve kur gjykatat e zakonshme nxjerrin çështjet jashtë juridiksionit gjyqësor, për shkak se ky lloj vendimi gjyqësor ndërhyr tek e drejta e aksesit në gjykatë të individit. Sipas Gjykatës, e drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 18, datë 15.3.2016; nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), zgjedhja vullnetare nga palët e juridiksionit të arbitrazhit, në parim, nuk ngre ndonjë çështje sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës, datë 2.10.2018, § 96; Apollo Engineering Limited kundër Mbretërisë së Bashkuar (dek.), datë 2.7.2019, § 38*). Pranimi i një klauzole arbitrazhi që të konsiderohet si heqje dorë nga garancitë e procesit të rregullt ligjor



duhet të jetë “i lirë, i ligjshëm dhe i paekuivok” (*shih Suda kundër Republikës Çeke, datë 28.10.2010, §48; Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës, datë 2.10.2018, § 96; Beg S.p.a kundër Italisë, datë 20.5.2021, § 127*). Megjithatë, kur palët bien dakord për arbitrazhin, kjo nuk nënkupton automatikisht se ato kanë hequr dorë pa mëdyshje nga të gjitha të drejtat e tyre, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës, datë 2.10.2018, §§ 121–123*). Po kështu, GJEDNJ-ja, në rastet e nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ka pohuar se kufizohet ushtrimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, ndaj duhet analizuar nëse rrethanat e rastit e justifikojnë një kufizim të tillë (*shih Cudak kundër Lituanisë, datë 23.3.2010, § 59*).

7. Në zbatim të këtyre standardeve të mësipërme vlerësojmë se nxjerrja e çështjes së kërkueseve nga juridiksioni gjyqësor ka ndërhyrë në të drejtën e tyre të aksesit në gjykatë. Ky përfundim bazohet fillimisht në përmbajtjen e nenit 135, pika 1, të Kushtetutës, që i jep Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të zakonshme pushtetin gjyqësor *vis-à-vis* përmbajtjes së nenit 42 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e aksesit në gjykatë për çdo individ. Kjo do të thotë se kompetenca e dhënies së drejtësisë u përket gjykatave të sistemit gjyqësor dhe individit nuk mund t'i mohohet e drejta që mosmarrëveshjen ta zgjidhë në juridiksionin gjyqësor. Në këtë mënyrë, nxjerrja e një mosmarrëveshjeje jashtë juridiksionit gjyqësor me arsyetimin se kompetenca i përket Gjykatës së Arbitrazhit përbën rast përjashtimor, për të cilin vullneti i palëve duhet të jetë pa vese, si dhe të jetë shfaqur shprehimisht dhe qartësisht në kontratë. Nga ana tjetër, nëse kontrata përmban një klauzolë që përcakton se kompetenca e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i përket sistemit gjyqësor dhe jo arbitrazhit, atëherë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë detyrimin për të dhënë arsye të plota dhe të qarta se përse nuk gjen zbatim kjo klauzolë kontraktore. Në kushtet kur kontrata ka forcën e ligjit, vepron prezumimi se të gjitha klauzolat kontraktore janë të detyrueshme dhe çdo interpretim i ndryshëm nga gjykatat ka nevojë për arsye bindëse që lidhen me veset e vullnetit, përfshirë pozitën e pafavorshme negociuese ose me përmbajtjen e paligjshme të kontratës.

8. Në çështjen konkrete, vihet re se midis shoqërive tregtare rezultojnë të jenë lidhur dy kontrata noteriale: i. kontrata e datës 19.3.2015 për

premtimin e shitjes së kuotave të shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., e cila përmban një klauzolë arbitrazhi; ii. dhe kontrata e datës 24.3.2015, për dhënien e huas, e cila përmban një klauzolë për juridiksionin gjyqësor. Thelbi i çështjes ka të bëjë me interpretimin që gjykatat e zakonshme u kanë bërë klauzolave kontraktore të dy kontratave në fjalë, si dhe me faktin nëse dy kontratat janë akte të mëvetshme. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar se kontrata e dytë është e aksesore e kontratës së parë dhe është e lidhur pashmangshmërisht me të. Me anë të këtij arsyetimi, ato kanë arritur në konkluzionin se megjithëse dy kontratat kanë klauzola të ndryshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (e para me arbitrazh dhe e dyta me juridiksion gjyqësor), klauzola e arbitrazhit e kontratës së parë zbatohet edhe për mosmarrëveshjet e kontratës së huas, ndaj kanë vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me pasojë kufizimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të kërkueseve.

9. Duke analizuar interpretimin e klauzolave kontraktore të bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çmojmë se ai nuk përmbush standardet kushtetuese dhe konventore, pasi, duke mos dhënë arsye bindëse se përse nuk ka marrë në konsideratë vullnetin e shfaqur nga palët lirisht dhe shprehimisht në kontratën e huas. Më konkretisht, dy kontratat rezultojnë të mëvetshme në disa drejtime: i. referuar natyrës dhe objektit të tyre, shitja dhe huaja janë të dyja kontrata kryesore; ii. referuar palëve kontraktore, ato nuk janë ekzaktësisht të njëjta, sepse kontrata e parë “*Premtim shije*” ka krijuar një marrëdhënie juridike mes tre subjekteve të së drejtës – dy kërkueseve dhe subjektit të interesuar, ndërsa kontrata e dytë e “*Huas*” ka krijuar një marrëdhënie tjetër juridike, mes dy subjekteve të së drejtës – kërkueses shoqërisë “Energy Albania Group” sh.p.k. dhe subjektit të interesuar; iii. referuar përmbajtjes së dy kontratave, kontrata e huas parashikon kushtin e marrjes së autorizimeve dhe lejeve për shitjen e kuotave, kusht i cili nëse përmbushet brenda afatit kontraktor, krijon detyrimin për kthimin e huas dhe anasjelltas, nëse autorizimet dhe lejet nuk merren, detyrimi për kthimin e huas shuhet. Në këtë mënyrë, si detyrimet, ashtu edhe eventualisht mosmarrëveshjet për të janë të mëvetshme nga kontrata e parë.

10. Për sa më lart, është e qartë se bëhet fjalë për dy marrëdhënie juridike kontraktore që kanë



gjeneruar mosmarrëveshje të ndryshme midis palëve kontraktore, për të cilat ato kanë përcaktuar me vullnet të qartë dhe shprehimisht përkatësisht: në kontratën e parë një klauzolë arbitrazhi, sipas së cilës kompetenca për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të premtimit të shitjes së kuotave i përket Gjykatës së Arbitrazhit, ndërsa në kontratën e dytë, atë të huas, palët kontraktore kanë përcaktuar me vullnet të qartë dhe shprehimisht se kompetenca i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kontrata e huas nuk përcakton as në mënyrë të shprehur, as të nënkuptuar klauzolën e arbitrazhit. Gjuha e përdorur nga palët në klauzolën kontraktore që përcakton juridiksionin kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është e shprehur qartë dhe nuk krijon paqartësi ose nuk lë shteg për nënkuptime, për rrjedhojë nuk dikton nevojën e interpretimit.

11. Në shtesë të argumenteve të mësipërme, evidentojmë se Gjykata e Arbitrazhit në Romë, pasi ka shqyrtuar mosmarrëveshjen e krijuar midis palëve, bazuar në kontratën e premtimit për shitje, mbështetur në paragrafin 9 të saj, ka refuzuar shqyrtimin e mosmarrëveshjes së krijuar për shkak të kontratës së huas, sepse kjo e fundit jo vetëm nuk e kishte një klauzolë të ngjashme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh, por kishte të përcaktuar që gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të palëve ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (*shih vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit të Romës faqet 7–8 në gjubën italiane dhe faqet 5–6 në gjubën shqipe*). Në këto kushte, mbeten të pamohueshme faktet se palët në kontratën e huas, me vullnet të lirë janë shprehur qartë për juridiksion gjyqësor dhe se kontrata është ligj për to, se Gjykata e Arbitrazhit në Romë, vendimi i së cilës ndonëse ende nuk është njohur në Shqipëri, ka pohuar që nuk është në kompetencën dhe juridiksionin e saj gjykimi i mosmarrëveshjeve të lindura nga kontrata e huas si kontratë e mëvetshme. Kjo do të thotë se edhe sikur të anashkalohet për një moment diskutimi për natyrën e kontratave dhe tipologjinë e tyre, përsëri mbetet i evidentueshëm fakti që për mosmarrëveshjet që kanë lindur nga kontrata e huas kërkeset nuk kanë më asnjë mjet tjetër procedural dhe nuk kanë më asnjë mundësi rishqyrtimi nga trupa e arbitrazhit që është shprehur për mungesën e juridiksionit të saj. Në këtë mënyrë, mundësia e vetme që mbetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ajo nga gjykatat shqiptare të juridiksionit të zakonshëm, siç e kanë parashikuar edhe vetë palët.

12. Për sa më lart, në vlerësimin tonë, gjykatat e zakonshme, duke i konsideruar aktet e nënshkruara mes palëve si të lidhura me njëra tjetrën, ku sipas tyre kontrata e huas ishte aksesore e kontratës së shitjes së aksioneve, si edhe duke përcaktuar se zgjidhja e mosmarrëveshjeve do t'i nënshtrohej juridiksionit të arbitrazhit, i përmendur vetëm në kontratën paraprake të shitjes së aksioneve, i cili, sipas tyre, mbulon edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kontratës së huas, pavarësisht se ajo përcakton në mënyrë të shprehur juridiksionin gjyqësor, u kanë mohuar kërkuueseve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë zgjidhje përfundimtare për pretendimin e tyre, duke i cenuar të drejtën e aksesit.

13. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuueseve për cenimin e së drejtës së aksesit ishte i bazuar, ndaj ankimi kushtetues individual i tyre duhej të pranohej dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM Nr. 34, datë 24.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 15.6.2023, 11.7.2023, 4.10.2023, 13.11.2023, 30.11.2023 dhe 21.3.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare publike dhe mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar nga deputetja Ina Zhupa dhe avokatët Rudina Jasini,



Agron Alibali, Franci Nuri, Ivi Kaso dhe Ledio Nuraj, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Presidenti i Republikës, në mungesë.

Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Erind Merkur, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Irma Qosja, Entela Çipa dhe Sonila Kora, me autorizim.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përfaqësuar nga Koço Sokoli dhe Qeram Cibaku, me autorizim.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, përfaqësuar nga avokatët Artan Hajdari, Eris Hysi, Fatma Muça dhe Ekflodia Leskaj, me autorizim.

Avokati i Popullit, përfaqësuar nga Alket Jaupi dhe Enio Haxhimihali, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 6, 7, 11, 13, 15, 18, pika 1, 59, pika 1, shkronja “g”, 116, pika 1, 117, 118, 122, 124, 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “c”, 162 dhe 163 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (*Konventa e Parisit*), e miratuar nga UNESCO; Karta Evropiane e Autonomisë Vendore; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, qëndrimin e subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës (*Presidenti*), i cili

e ka lënë këtë çështje në vlerësim të Gjykatës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit (*FMB*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Kontrollit të Lartë të Shtetit (*KLSH*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, mendimin e Avokatit të Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (*ligji nr. 27/2018*), cili ka për qëllim ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitjen e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore (neni 1) dhe për objekt përcaktimin e rregullave, procedurave dhe të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me mënyrën e administrimit të pasurive kulturore në pronësi publike, neni 171, i ligjit nr. 27/2018, ka parashikuar se ajo mund të jetë: direkte, që realizohet nëpërmjet strukturave organizative të specializuara në varësi të institucioneve shtetërore ose subjekteve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative, financiare dhe me personel të specializuar tekniko-shkencor ose në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike; indirekte, që realizohet nëpërmjet: a) fondacioneve të posaçme; b) fondacioneve të krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore; c) personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, të cilëve pasuria kulturore u jepet në administrim nëpërmjet procedurave publike të përcaktuara me VKM dhe vendim të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të



Pasurive Kulturore (KKMPK), bazuar në vlerësimin krahasimor të projekteve të paraqitura.

2. Në nenin 172, të ligjit nr. 27/2018 parashikohet se administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore mund të kryhet edhe nga persona juridikë jofitimprurës, të bashkëthemeluar ndërmjet institucioneve shtetërore, të përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, dhe personave fizikë ose juridikë privatë, vendas apo të huaj, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin civil në fuqi. Personi juridik i krijuar për këtë qëllim organizohet në formën e fondacionit sipas legjislacionit civil në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe parashikimet e këtij ligji për aq sa janë të zbatueshme, duke ruajtur pavarësinë e funksionimit dhe të respektimit të tyre nga ana e shtetit. Rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit të fondacioneve të posaçme të trashëgimisë kulturore vendosen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në marrëveshjen e posaçme që lidhet ndërmjet palëve. Sipas pikës 5 të këtij neni, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, e cila i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Në mbështetje të nenit 12, pika 4, të ligjit nr. 27/2018, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 625, datë 4.9.2019, “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit” (VKM nr. 625/2019), i cili ka për objekt miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit, me qëllim ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe miradministrimin e pasurive kulturore publike, duke garantuar aksesin e publikut në këto pasuri dhe përmirësimin e shërbimeve në to.

4. Në datën 15.10.2019, Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), një organizatë jofitimprurëse, e organizuar dhe themeluar sipas ligjeve të shtetit të Delaware në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që vepron përmes degës së saj në Shqipëri, e regjistruar me vendimin nr. 359, datë

18.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ka paraqitur ministrisë përgjegjëse shprehjen e interesit për krijimin e fondacionit të posaçëm për administrimin indirekt të pasurisë kulturore në nënzonat A3 të Parkut Kombëtar të Butrintit (*Parku i Butrintit*). Me vendimin nr. 3, datë 6.4.2020, KKMPK-ja ka vendosur vlerësimin si partner strategjik të AADF-së për themelimin e fondacionit të posaçëm.

5. Në datën 24.2.2021, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe AADF-së është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për themelimin e fondacionit “Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit” (*Marrëveshja për Themelimin e Fondacionit*). Sipas nenit 2 të saj, fondacioni krijohet me qëllim administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore, sigurimin e aksesit dhe shërbimet për publikun në të, promovimin e saj dhe aktivitetet studimore e kërkimore, si dhe përdorimin, qarkullimin dhe veprimtaritë arkeologjike të pasurisë kulturore, duke menaxhuar dhe zhvilluar atë në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar mjetet e nevojshme financiare dhe stafin e specializuar, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e saj për të gjithë kohëzgjatjen e administrimit indirekt.

6. Në datën 11.6.2021, palët e Marrëveshjes për Themelimin e Fondacionit kanë miratuar Aktin e Themelimit, i cili është regjistruar me vendimin nr. 858, datë 21.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, mes Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së është lidhur marrëveshja “Për administrimin e pasurisë kulturore të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit” (*Marrëveshja e Administrimit*), me anë të së cilës Ministria e Kulturës, si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i jep FMB-së të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për administrimin indirekt të pasurisë kulturore dhe të të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë marrëveshje, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe marrëveshjen e bashkëpunimit (pika 4.1).

7. Këshilli i Ministrave, bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, ka paraqitur projektligjin për miratimin e Marrëveshjes së Administrimit. Në vijim, Kuvendi, në seancën plenare të datës 23.5.2022, ka miratuar ligjin nr. 50/2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit



kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” (*ligji nr. 50/2022*). Ligji është kthyer për rishqyrtim nga Presidenti me dekretin nr. 13703, datë 20.6.2022. Pas rrëzimit të dekretit nga Kuvendi në seancën plenare të datës 14.7.2022, ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 29.7.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

8. Me kërkesën e datës 14.11.2022, një grup prej 36 deputetësh, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 50/2022, si të papajtueshëm me Kushtetutën, duke kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të këtij akti deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës.

9. Me vendimin e datës 15.12.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 22.12.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuesi, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, ka parashtruar në mënyrë të përmblodhur se *ligji nr. 50/2022, bie ndesh me:*

10.1 *Identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore*, pasi shteti nuk mund të heqë dorë nga detyrimi për të ruajtur, administruar e zhvilluar Parkun e Butrintit si përfaqësues i identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, duke ia dhënë me koncesion një personi juridik privat. Neni 59 i Kushtetutës është përdorur indirekt si baza e vetme kushtetuese në mbështetje të nismës ligjvënëse, por kjo dispozitë nuk mund të merret e veçuar nga nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës. Statuti dhe Marrëveshja për Themelimin e Fondacionit parashikojnë se shteti do të luajë rolin e tij nëpërmjet një përfaqësi të pagënë në Bordin e Drejtorëve, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, ku përfaqësuesit e shtetit janë në pakicë dhe ku vetëm ministria paraqitet në cilësi shtetërore, ndërsa përfaqësuesi tjetër nuk ka asnjë funksion shtetëror. Për më tepër, përfaqësuesi tjetër i caktuar në Bordin e Drejtorëve, konkretisht avokatja F.B., ka qenë e përfshirë më parë si eksperte ligjore për përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe për negocimin e

marrëveshjeve për krijimin dhe funksionimin e vetë fondacionit të posaçëm, duke vënë kështu në dyshim interesin shtetëror që përfaqëson. Gjithashtu, përbërja e bordit është përcaktuar në mënyrë nominale, çka lë hapësirë që të humbë përfaqësimi i ministrit përgjegjës në të ardhmen. Nga ana tjetër, referuar pikës 9.2 të Marrëveshjes së Administrimit, FMB-ja duhet të përcaktojë edhe qasjen për zbulimet që lidhet drejtpërdrejt për nga natyra me identitetin kombëtar dhe territorin, veçanërisht kur anëtar i përzgjedhur i bordit është një figurë kontroverse, që në botime dhe leksione publike është shprehur për një “narrativë të re” për Butrintin. Duke marrë në dorë administrimin e Parkut të Butrintit, FMB-ja merr përsipër prerogativa që i takojnë si detyrim sovran dhe ekskluziv shtetit shqiptar e që nuk mund të transferohen te një subjekt privat, ndërkohë që sipas neneve 5 e 29 të Konventës së Parisit menaxhimi i drejtpërdrejtë dhe ekskluziv nga shteti i një vendi të trashëgimisë botërore është kusht i domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve në pajtueshmëri me këtë konventë. Parashikimet e Marrëveshjes së Administrimit përbëjnë rrezik edhe për nxjerrjen jashtë shtetit të pasurive kombëtare shqiptare, çka rrezikon tjetërsimin (humbjen) dhe pse jo shitjen e tyre për sa kohë që shteti nuk është më garant.

10.2 *Parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve normative*, pasi ligji nr. 50/2022 është nxjerrë në kundërshtim me nenin 122 të Kushtetutës, për sa kohë që në Konventën e Parisit nuk ka asnjë dispozitë që lejon menaxhimin ose administrimin e pasurive kulturore kombëtare nga ente/organizata jofitimprurëse (OJF) private. Sipas neneve 4, 5, 6, 17 dhe 29 të Konventës së Parisit, menaxhimi ose administrimi i vendeve/siteve të trashëgimisë botërore të shpallura ose të marra në mbrojtje nga UNESCO është detyrim dhe përgjegjësi ekskluzive dhe e patransferueshme e shtetit palë. Për sa i takon rolin të fondacioneve, Konventa e Parisit në nenin 17 parashikon se ato kanë si qëllim “vetëm të ftojnë donacione” dhe se duhet të jenë vendase, jo të huaja. Pavarësisht miratimit të ligjit nr. 27/2018, që ka parashikuar format e administrimit të pasurive kulturore, dhe të ligjit të posaçëm nr. 50/2022, zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës së Parisit nuk e zhbën fuqinë detyruese të saj në drejtim të përgjegjësisë së shtetit shqiptar. Përplasja me Kushtetutën dhe Konventën e Parisit shfaqet në momentin kur vihen në zbatim nenet 171 dhe 172,



të ligjit nr. 27/2018, që kërkojnë hartimin dhe nënshkrimin e një kontrate dhe konkretizimin e një forme bashkëpunimi të përcaktuar në detaje, që duhet të miratohet sërish përmes një ligji dhe të jetë në harmoni me parashikimet konventore, qoftë për sa i përket përgjegjësisë së shtetit për të përmbushur detyrimet e tij, qoftë për sa i përket pjesëmarrjes dhe rolit të tij në fondacionin e posaçëm, të cilat nuk ofrohen në rastin konkret.

10.3 Ligji nr. 50/2022 praktikisht ka transferuar pasurinë pronë publike të një subjekt privat, i cili mund të bëjë ç'të dojë, madje të ndërtojë aty edhe objekte komerciale që nuk kanë lidhje direkte me sitin konkret. Dispozitat e marrëveshjes që parashikojnë vlerësimin e monitorimin (pika 24) dhe korrigjimin e rasteve të mospërmbushjes dhe ndërhyrjen e ministrisë (pika 28) ngrenë shqetësime serioze për zbehjen e attributeve sovranë të shtetit shqiptar për kontrollin e plotë dhe efektiv të territorit të tij, si dhe parimin e sovranitetit. Në relacionin e projektligjit nuk argumentohet arsyeja për lidhjen e marrëveshjes me një subjekt privat dhe përse shteti shqiptar nuk ka fonde të mjaftueshme apo kapacitete të tjera jofinanciare që të menaxhojë vetë një pasuri si Butrinti. Referuar jurisprudencës kushtetuese vetëm mungesa e fondeve financiare nuk përligj interesin publik të miratimit të ligjit. Duke qenë se zhvillimi i zonave të caktuara mbart interes publik, Gjykata duhet të vlerësojë nëse kjo ndërhyrje respekton ose jo edhe parimin e proporcionalitetit. Ligji nr. 50/2022 përmban kriterë favorizuese për fondacionin në raport me subjekte të tjera private potencialisht të interesuara për të konkurruar për këtë projekt zhvillimi, kriterë që janë dekurajuese dhe të vështira për t'u përmbushur nga entitete të tjera.

10.4 *Parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës*, për shkak të procedurës për dhënien e statusit “partner strategjik” AADF-së, pasi ligji nr. 27/2018, nuk i ka dhënë kompetenca KKMPK-së që të vlerësojë si të tillë një subjekt që synon të marrë administrimin e një pasurie kulturore me vlera universale. Sipas nenit 40, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 27/2018, ky organ ka kompetencë të miratojë vetëm strategjitë për administrim të qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore. Ky parim cenohet edhe nga kreu IV, i VKM-së nr. 279, datë 2.5.2019, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të

Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore” (VKM nr. 279/2019), i cili i ka dhënë KKMPK-së më shumë kompetenca nga ato që parashikon ligji nr. 27/2018. Të njëjtin tejkalim, në shkelje të rezervës ligjore, e gjejmë edhe te VKM-ja nr. 625/2019, kreu IV, seksioni A, pika 1, e tij, që i jep KKMPK-së një kompetencë që nuk e ka sipas ligjit dhe as nuk mund ta kryejë, nisur dhe nga kriteret që përcaktojnë emërimin e anëtarëve të këtij organi. Duke qenë se AADF-ja e gëzon statusin e saj në mënyrë antiligjore, ekzistenca e fondacionit është antikushtetuese.

10.5 *Parimin e kontrollit të financave publike*, pasi shmanget tërësisht kontrolli i shtetit për të ardhurat që do të gjenerohen nga një pasuri kombëtare. Sipas nenit 5, pika 1, shkronja “o”, të aktit të themelimit të fondacionit, ai ka edhe të drejtën që pasurinë kulturore ta japë në përdorim tek të tretët, me synim rritjen e të ardhurave. Duke qenë se objekti i Marrëveshjes së Administrimit është, ndër të tjera, dhënia në administrim e pasurisë publike me qëllim rritjen e të ardhurave për ta përmirësuar atë, kurrsesi nuk mund të shmanget kontrolli i KLSH-së. Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes FMB-së do t'i transferohen paratë që Parku i Butrintit ka gjendje aktualisht, pra bëhet fjalë për para publike. Me krijimin e FMB-së i hiqet mundësia KLSH-së të kontrollojë se çfarë bëhet me paratë e pasurisë publike, duke qenë ai një subjekt privat që sipas pikës 26.5 të statutit nuk auditohet nga ky organ.

10.6 *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe atë të autonomisë vendore*, pasi në momentin e miratimit të ligjit nr. 50/2022, neni 54, shkronja “e”, i ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (ligji nr. 139/2015) parashikonte kompetencën e këshillit bashkiak që të vendoste me shumicë të cilësuar miratimin e tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të tretëve, ndërkohë që Bashkia Sarandë nuk është konsultuar dhe nuk është shprehur me votim për kalimin në përdorim të sipërfaqeve që administroheshin prej saj. Ligji nr. 50/2022 i ka hequr asaj bashkie ushtrimin e kompetencave të saj për Butrintin dhe zhvillimet rreth tij. Shkelja e parashikimeve të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore ka të bëjë me heqjen e rolit të pushtetit vendor për planet zhvillimore të zonës dhe për mbledhjen e të ardhurave nga aktivitete të kryera në territorin e bashkisë, mungesën e konsultimit paraprakisht me autoritetet vendore duke munguar një vendimarrje



ose thjesht një diskutim në këshillin bashkiak, si dhe injorimin e opinionit të banorëve të zonës, të cilët kanë protestuar disa herë në hyrje të parkut dhe kanë qenë pjesëmarrës në tryezat e organizuara nga shoqëria civile.

10.7 Raporti i misionit të përbashkët të UNESCO/ICOMOS mbështet pretendimet se ligji nr. 50/2022 nuk ruan rolin parësor të shtetit palë si garant i mbrojtjes së Vlerave të Jashtëzakonshme Universale (OUV), duke ia lëshuar atë një OJF-je private. Sipas këtij raporti është shkëlur parimi i “rolit parësor” të shtetit palë sipas Konventës së Parisit, rrjedhimisht edhe Kushtetuta. Ai mbështet qëndrimin se legjislacioni i miratuar, përfshirë ligji nr. 50/2022, janë raste të korrupsionit legjislativ ose ligjit të bërë me porosi (*tailor made law*) dhe se ky ligj zhvesh shtetin palë nga atributet sovranë të identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transferimit të brezave të ardhshëm të pasurisë. Raporti del hapur kundër qasjes së FMB-së dhe ngre shqetësimin se marrëveshja mund të përkeqësojë OUV-të që janë vulnerabël dhe që mund të përkeqësohen për shkak të prioritetëve aktualë të financimit të FMB-së. Në lidhje me Qendrën e Vizitorëve raporti shprehet se nuk ka marrë informacionin e kërkuar dhe se shteti duhet të mbajë përgjegjësi për ndërtimet dhe të ruajë parametrat e OUV-ve. Raporti kritikon edhe heqjen e sipërfaqes 600 ha nga Zona B buferike, duke e konsideruar si cenim të një pjese të territorit të pasurisë, çka ka rezultuar në një ndryshim të konsiderueshëm në regjimin e mbrojtjes së kësaj zone.

10.8 Po në drejtim të këtij raporti, ai ngre shqetësimin për mangësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në drejtim të njohurive të cinguara të fushës dhe thekson se menaxhimi, posedimi dhe të drejtat ekskluzive duhet t’u lihen organeve shtetërore, duke përdorur kapacitetet shkencore dhe teknike, si dhe eksperiencën e akumuluar ndër vite. Ai parashtron qëndrimin negativ të UNESCO-s ndaj propozimit për modelin hibrid të menaxhimit “indirekt” dhe nxjerr në pah mangësinë thelbësore të ligjit nr. 50/2022 dhe akteve të tij, konkretisht moskryerjen e vlerësimeve të ndikimit në trashëgimi nga ana e autorëve të planit të biznesit. Kritikat thelbësore të raportit mbështetnin qëndrimin e kërkuar se Konventa e Parisit nuk ka qenë në vëmendjen e arkitektëve të modelit të administrimit indirekt të Butrintit dhe as në hartimin e ligjit nr. 27/2018. Raporti evidenton si mangësi mungesën e

pushtetit vendor dhe vë theksin në rëndësinë e pjesëmarrjes së tij në administrimin e pasurisë, madje në Bordin e Drejtorëve, çka mbështet pretendimet e kërkuar për shkeljen e Kartës së Autonomisë Vendore. Raporti nxjerr në pah edhe korrespondencat e shumta mes UNESCO-s dhe shtetit shqiptar që prej vitit 2015, që kanë qenë shqetësim i kërkuar për sa kohë që këto akte janë të domosdoshme për gjykimin kushtetues dhe marrja e tyre është penguar nga subjektet e interesuara, të cilat kanë fshehur edhe vetë këtë raport.

11. Subjekti i interesuar, Presidenti, me shkresën nr. 411/1 prot., datë 4.5.2023, ka informuar se e ka të pamundur të mbajë një qëndrim në lidhje me këtë çështje, duke e lënë atë në vlerësim të Gjykatës.

12. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar si vijon:

12.1 Për legjitimitetin

12.1.1 Pretendimi për cenimin e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore lidhet me përbërjen e Bordit të Drejtorëve të FMB-së, që rregullohet nga akti i themelimit, i cili nuk është objekt i këtij gjykimi. Vlerësimi dhe dhënia e statusit “investitor strategjik” AADF-së është bërë në përputhje me ligjin nr. 27/2018 dhe VKM-në nr. 625/2019. Shteti nuk zhvishet në asnjë moment nga përgjegjësia e tij për ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kulturore të Butrintit, pasi ai, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, është edhe administrues, edhe kontrollues.

12.1.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ligjshmërisë, kërkuar nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi ka paraqitur argumente për antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 27/2018 dhe të VKM-ve nr. 279/2019 e nr. 625/2019, për rrjedhojë ai është paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar të përcaktuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

12.1.3 Kërkuar nuk legjitimohet edhe për pretendimin për cenimin e parimit të kontrollit të *financave publike*, pasi ai u referohet akteve të themelimit të një OJF-je (statutit), të cilat nuk janë objekt kontrolli kushtetues. Pretendimi për cenimin e nenit 163 të Kushtetutës është i pabazuar, pasi mënyra e administrimit të të ardhurave të FMB-së rregullohet sipas ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse” (ligji nr. 8788/2001). As ligji nr. 50/2022, as neni 26 i statutit të FMB-së nuk e pengojnë KLSH-në të ushtrojë kontroll në pjesën e fondeve që kanë burim buxhetin e shtetit.



12.2 Për themelin e çështjes

12.2.1 Pretendimi për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve normative është i pabazuar, pasi FMB-ja merr vetëm administrimin e pasurisë kulturore dhe jo pronësinë e saj, ndërkohë që kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret për të mbështetur këtë pretendim dhe nuk ka referuar në asnjë dispozitë konkrete kushtetuese të cenuar. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit kërkuesi nuk përmend asnjë të drejtë ose vlerë kushtetuese që të jetë prekur për shkak të themelimit dhe funksionimit të një fondacioni nga shteti në bashkëpunim me një organizatë joqeveritare për administrimin e një pjese të trashëgimisë kulturore.

12.2.2 Në lidhje me pretendimin për papajtueshmërinë me Konventën e Parisit, në nenin 17 të saj parashikohet krijimi i fondacioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe detyrimi i vendeve anëtare për të kontribuar në ekzistencën e tyre. Krijimi i fondacionit dhe modeli i zgjedhur për administrimin e tij kanë për qëllim rritjen e donacioneve dhe financimeve në fushën e trashëgimisë kulturore. Kjo bën të mundur që të ardhurat e realizuara nga administrimi të përdoren ekskluzivisht për mbrojtjen e pasurisë kulturore me vlera universale. Për rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me asnjë konflikt kushtetues dhe as mes legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Përkundër sa pretendon kërkuesi, neni 17 i Konventës së Parisit nuk vendos kufizime për formën, mënyrën ose subjektin të cilit duhet t'i kalojë ose jo në administrim një pasuri e tillë. As neni 4 i Konventës së Parisit nuk vendos ose imponon ndonjë ekskluzivitet të autoriteteve shtetërore dhe përjashtimin absolut të subjekteve private në detyrën për të garantuar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transmetimin e vlerave të trashëgimisë kulturore. Ministria mbetet përgjegjëse dhe ruan rolin e saj kryesor në menaxhimin e të gjithë trashëgimisë botërore të vendit, si dhe vijon të veprojë si pika qendrore për të gjitha këto çështje dhe për raportimin periodik pranë UNESCO-s. Ky rol i saj garantohet nga ligji nr. 50/2022 përmes monitorimit të vazhdueshëm, kontrollit fizik, si dhe kontrollit përmes lejeve, licencave dhe autorizimeve që duhet të marrë FMB-ja për çdo aktivitet në administrimin e pasurisë kulturore.

12.2.3 Pretendimi për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të autonomisë vendore është i

pabazuar, pasi për shkak të rëndësisë së tij si pasuri kulturore universale, Parku i Butrintit nuk ka qenë asnjëherë në administrim të pushtetit lokal, por të Ministrisë së Kulturës.

12.2.4 Në lidhje me raportin e misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS, shpjegimet e këtij organi kanë fuqi rekomanduese dhe nuk përbëjnë të drejtë ndërkombëtare të detyrueshme, ndaj nuk mund të shërbejnë për kontrollin e ligjit të kundërshtuar. Raporti nuk ka ngritur shqetësime në lidhje me mënyrën e menaxhimit të nënzonës A3 apo nëse zgjidhja e dhënë nga Kuvendi cenon Konventën e Parisit. Ai, pavarësisht shqetësimeve, nuk e vendos Parkun e Butrintit në pasuritë e rrezikuara dhe konfirmon nevojën për kalimin sa më parë në administrim të FMB-së të pasurisë sipas marrëveshjes. Raporti nuk ngre shqetësime në lidhje me konflikte normash kushtetuese në plan të brendshëm ose ndërkombëtar. Problematika kryesore dhe rekomandimet kanë të bëjnë me zonimin e Parkut të Butrintit, çka nuk lidhet me ligjin nr. 50/2022. Raporti vë theksin në rekomandimet e mëparshme të UNESCO-s për përfshirjen e të gjithë parkut në kompetencat e Ministrisë së Kulturës dhe rekomandimet shkojnë më tej, duke sugjeruar që FMB-ja nuk duhet të kufizohet vetëm në administrimin e nënzonës A3, por të të gjithë Parkut të Butrintit. Megjithatë, kjo çështje lidhet me politikat e shtetit në administrimin e pasurisë së trashëgimisë kulturore, kurse çështjet e tjera lidhen me sipërfaqet e lëvizura nga parku, që nuk parashikohen ose rregullohen nga ligji nr. 50/2022.

13. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

13.1 Për legjitimitetin

13.1.1 Pretendimi për cenimin e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kombëtare ka të bëjë tërësisht me përbërjen e bordit, pra me dispozitat e aktit të themelimit të FMB-së, të cilat nuk janë objekt kërkesë. Për më tepër, akti i themelimit për nga natyra nuk hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjithsesi, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore është kryetar i Bordit të Drejtorëve dhe referuar nenit 13 të statutit, emërimi i tij si kryetar lidhet me funksionin. Ministria e Kulturës, në dallim nga AADF-ja, paraqitet në funksion të dyfishtë, si bashkëthemeluese dhe si organ monitorues.



13.1.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e nenit 118 të Kushtetutës, kërkuesi nuk i referohet përmbajtjes së ligjit nr. 50/2022, por akteve të tjera ligjore ose nënligjore që nuk janë objekt i këtij gjykimi kushtetues. Vlerësimi i partnerit strategjik është bërë nga KKMPK-ja në bazë të kriterëve të parashikuara nga ligji nr. 27/2018 dhe aktet e tjera nënligjore. Kriteret e referuara nga kërkuesi si antikushtetuese janë përcaktuar nga VKM-të nr. 279/2019 dhe nr. 625/2019, të cilat nuk janë objekt kërkesë, ndaj nuk i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues. Pavarësisht kësaj, kriteret e parashikuara nga këto VKM nuk cenojnë parime dhe të drejta kushtetuese.

13.1.3 Pretendimi për cenimin *e parimit të kontrollit të financave publike* i referohet nenit 5, pika 1, shkronja “o”, të aktit të themelimit të FMB-së, që nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues. Në asnjë dispozitë të Marrëveshjes së Administrimit apo ligjit nr. 50/2022 nuk është parashikuar përjashtimi i veprimtarisë së FMB-së nga auditimi i KLSH-së. Objekt auditimi nga KLSH-ja janë fondet e shtetit shqiptar në fondacion, si dhe veprimtaria ekonomike në menaxhimin e të ardhurave që vijnë nga Parku i Butrintit, si pasuri publike, por jo fondet që investohen nga AADF-ja.

13.1.4 Në thelb, të gjitha pretendimet e kërkesës bazohen në vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 172 të ligjit nr. 27/2018, që parashikon të drejtën e administrimit të pasurive të trashëgimisë kulturore edhe nga OJF-të, si dhe procedurën për këtë qëllim. Ligji nr. 27/2018 ka prodhuar efekte që nga data 27.6.2018 dhe nuk është bërë objekt i gjykimit kushtetues.

13.2 Për themelin e çështjes

13.2.1 Në lidhje me pretendimin për cenimin *e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore*, modeli i administrimit të nënzonës së trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut të Butrintit nëpërmjet administrimit indirekt përmes krijimit të një fondacioni të dedikuar, erdhi si nevojë e gjetjes së vlerave të reja të administrimit në funksion të ruajtjes, mbrojtjes dhe rritjes së vlerave të trashëgimisë kulturore. Kjo, pasi sistemi aktual i menaxhimit nuk garantonte në perspektivë mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore e natyrore të sitit dhe zhvillimin e integruar të tij, si dhe nuk siguronte të ardhura sipas pritshmërive që duhet të ketë një pasuri me vlera kaq të rëndësishme kombëtare universale.

13.2.2 Pretendimi për cenimin *e parimit të shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve normative* është i pabazuar, pasi ligji nr. 50/2022 ka miratuar Marrëveshjen e Administrimit në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 27/2018. Në asnjë rast dhe në asnjë dispozitë të marrëveshjes nuk parashikohet kalimi i pronësisë së Parkut, e cila i mbetet shtetit përgjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Qëllimi i FMB-së është mirëmenaxhimi i aseteve të Parkut, pasuri botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s, dhe në rastin konkret respektohen të gjitha rekomandimet e rëndësishme të mirëcaktuara dhe mirëkoordinuara me këtë të fundit që në fazën e planit të menaxhimit të integruar. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të proporcionalitetit, përzgjedhja e formës së administrimit të një prone shtetërore, qoftë edhe të një pasurie që përbën vlerë të trashëgimisë kulturore, është kompetencë që i takon vetë shtetit, ndaj nuk mund të klasifikohet si shkelje e të drejtave dhe lirive themelore sipas nenit 17 të Kushtetutës.

13.2.3 Neni 4 i Konventës së Parisit nuk trajton mjetet dhe mënyrat se si shtetet palë do të realizojnë detyrimet në nivel të brendshëm, por përcakton vetëm pozicionin e shtetit në raport me UNESCO-n dhe komunitetin ndërkombëtar. Neni 17 i konventës nuk ndalon ngritjen, bashkëpunimin dhe përfshirjen e fondacioneve në administrimin e pasurive kulturore, përkundrazi inkurajon shtetet të rrisin financimet për mbrojtjen e këtyre pasurive. As nenet 5, 6 dhe 29 të konventës nuk parashikojnë ndonjë ndalim për modelin e administrimit të pasurisë kulturore nga një fondacion. Pavarësisht nga forma e administrimit, funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, kontrollit teknik, inspektimit dhe mbikëqyrjes ushtrohen nga Ministria e Kulturës në përputhje me ligjin nr. 27/2018.

13.2.4 Pretendimi për cenimin *e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të autonomisë vendore* është i pabazuar, pasi sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Parku i Butrintit ka qenë gjithnjë në pronësi dhe në administrim të pushtetit qendror dhe nuk i është transferuar asnjëherë njësisë së qeverisjes vendore. Për sa kohë nuk gëzon titull pronësie për këtë pasuri asaj nuk i është cenuar asnjë e drejtë. Për sa u përket veprimeve me karakter ndërtimor, ato kryhen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, dhe Marrëveshja e Administrimit nuk parashikon heqjen e këtyre kompetencave apo shmangien e këtyre organeve. Ajo nuk përmban as ndonjë



dispozitë që të cenojë të drejtën e bashkisë për të arkëtuar taksat dhe tarifat vendore sipas legjislacionit në fuqi. Përpara miratimit të marrëveshjes është kryer një proces i gjatë konsultimi, janë zhvilluar tryeza, takime me palë të interesuara, ekspertë, si dhe konsultimi publik sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ministria e Kulturës është konsultuar edhe me profesionistë e grupe interesi, si dhe ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Qendrën e Trashëgimisë Botërore pranë UNESCO-s.

13.2.5 Raporti i misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS nuk ka sjellë asnjë ndikim ose implikim në gjykimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 50/2022 dhe Marrëveshjes së Administrimit. Përmbajtja e raportit ka të bëjë me elemente fakti dhe jo ligji dhe opinionet e shprehura në të përbëjnë vlerësime të rrafshit të dobishmërisë dhe jo të natyrës juridike.

14. Subjekti i interesuar, KLSH-ja, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar si vijon:

14.1 Marrëveshja e Administrimit bie ndesh me *nenin 162 të Kushtetutës*. Pasuria objekt i marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 50/2022, për nga natyra, është brenda fushës së kompetencës së KLSH-së, ndërkohë që ky ligj e anashkalon këtë, duke penguar KLSH-në në ushtrimin e funksionit dhe kompetencave të saj. Përmbajtja e nenit 26, pika 5, të statutit të FMB-së dhe e nenit 18 të Marrëveshjes për Themelimin e Fondacionit cenojnë sferën e kompetencave dhe pavarësinë e KLSH-së dhe ato janë pjesë integrale e vetë Marrëveshjes së Administrimit.

14.2 Ligji nr. 50/2022 bie ndesh me parimin e *shtetit të së drejtës* dhe të *hierarkisë së akteve juridike*, pasi cenon kompetencat e një organi kushtetues, KLSH-së, duke bërë që një akt ligjor i miratuar me shumicë të thjeshtë të ketë epërsi mbi ligjin organik të këtij organi, i miratuar me shumicë të cilësuar.

15. Subjekti i interesuar, FMB-ja, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar si vijon:

15.1 Për legjitimitimin

15.1.1 Pretendimet për mënyrën e krijimit, statutin, organizimin e brendshëm, si dhe procedurën e shpalljes së tij partner strategjik i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, për rrjedhojë nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata.

15.1.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të kontrollit të financave publike* nuk rezulton të jetë ngritur për kundërshtimin e ligjit nr. 50/2022, për rrjedhojë del jashtë juridiksionit kushtetues. Marrëveshja e

Administrimit nuk ndalon ushtrimin e kontrollit nga KLSH-ja dhe parashikimet e nenit 26.5 të statutit të FMB-së nuk e pengojnë KLSH-në të ushtrojë kontroll të fondeve që kanë burim buxhetin e shtetit. Kjo dispozitë parashikon se fondet e financuara nga AADF-ja nuk janë objekt i KLSH-së, pasi ato nuk janë fonde publike të shtetit shqiptar.

15.1.3 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për pretendimin për cenimin e *parimit të ligjshmërisë*, pasi ai ka të bëjë me përmbajtjen e ligjit nr. 27/2018 dhe të VKM-ve nr. 279/2019 e nr. 625/2019, për rrjedhojë është paraqitur jashtë afatit 2-vjeçar të përcaktuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

15.2 Për themelin e çështjes

15.2.1 Pretendimi për cenimin e *identitetit kombëtar* dhe të *trashëgimisë kulturore* është i pabazuar. Sipas raportit të KLSH-së të datës 30.4.2021, Ministria e Kulturës dhe institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore kanë shfaqur dobësi në marrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të parqeve arkeologjike, ndaj administrimi nga vetë shteti ka pasur probleme dhe nuk ka rezultuar efektiv. Administrimi indirekt i pasurive kulturore, bazuar në nenet 171 dhe 172 të ligjit nr. 27/2018, konsiston në krijimin e një subjekti jofitimprurës të posaçëm. Në këtë kuptim, është përgjegjësi e vetë shtetit të ruajë trashëgiminë kulturore, por pa e kufizuar atë në ushtrimin e detyrave të tij vetë ose nëpërmjet bashkëpunimit me palë private. Qëllimi i FMB-së është mbrojtja, ruajtja, zhvillimi, promovimi dhe menaxhimi më i mirë i pasurisë kulturore, ndërsa shteti mbetet pronar i vetëm i kësaj pasurie. Ky model administrimi është përdorur edhe nga vende të tjera. Për sa u përket pretendimeve për përbërjen e Bordit të Drejtorëve, ky organ nuk parashikohet në marrëveshjen e miratuar me ligjin nr. 50/2022, por në aktet e themelimit, të cilat nuk janë objekt i juridiksionit kushtetues, për më tepër as objekt kërkese. Gjithsesi, pjesëmarrja dhe vendimmarrja në atë bord është e balancuar dhe ndryshimi i numrit të anëtarëve bëhet vetëm me shumicë të cilësuar, ndërsa përcaktimi i anëtarëve në mënyrë nominale buron nga ligji nr. 8788/2001.

15.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës* dhe të *hierarkisë së akteve normative*, pasi FMB-ja merr në administrim dhe jo në pronësi pasurinë kulturore. Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit kërkuesi nuk përmend asnjë të drejtë ose vlerë kushtetuese që të jetë prekur



për shkak të themelimit dhe funksionimit të një fondacioni nga shteti në bashkëpunim me një OJF. Qëllimi i Konventës së Parisit është përcaktimi i rregullave për krijimin e një sistemi kolektiv të mbrojtjes së trashëgimisë botërore që nuk synon të zëvendësojë shtetet palë dhe as të përcaktojë rregulla administrimi apo menaxhimi që duhet të zbatohen për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore. Parashikimet e nenit 4 të Konventës së Parisit nuk vendosin apo imponojnë asnjë ekskluzivitet të autoritetit shtetëror të një shteti dhe përjashtimin absolut të subjekteve private në detyrën për të garantuar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transferimin e vlerave të trashëgimisë kulturore. Mënyra se si shtetet palë organizojnë administrimin e pasurive është një çështje e brendshme që i përket sovranitetit shtetëror. Ligji nr. 50/2022 është në përputhje me Konventën e Parisit, pasi Ministria e Kulturës mbetet përgjegjëse dhe ruan rolin e saj kryesor në menaxhimin e trashëgimisë botërore të Shqipërisë, si dhe vijon të veprojë si pika qendrore për të gjitha këto çështje dhe raportimin në UNESCO. Edhe neni 5 i Konventës së Parisit nuk vendos asnjë detyrim menaxhial të autoritetit shtetëror për pasuritë kulturore. Kurse neni 17 i saj inkurajon shtetet palë që të krijojnë fondacione për mbledhjen e donacioneve dhe financimeve në fushën e trashëgimisë kulturore.

15.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të autonomisë vendore* është i pabazuar, pasi Parku i Butrintit nuk ka qenë asnjëherë në administrim të pushtetit lokal, por të Ministrisë së Kulturës për shkak të rëndësisë si pasuri kulturore universale. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë rekomandimet e UNESCO-s, ministria ka zhvilluar disa seanca konsultimesh në nivel vendor dhe qendror.

15.5 Raporti i misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS nuk ka shprehur asnjë shqetësim për kapërcim të kufijve të Kushtetutës dhe ligjit apo mospërputhje me konventat ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore. Ai konfirmon nevojën për kalimin sa më parë të pasurisë në administrim të FMB-së. Raporti është një dokument me fuqi rekomanduese dhe që hartohet në kuadër të monitorimit të pasurisë trashëgimi botërore dhe ai nuk shpreh rezerva për krijimin e FMB-së, por e referon si rekomandim të përmbushur nga plani i menaxhimit të integruar të

Parkut të Butrintit. Raporti pranon administrimin indirekt dhe e njeh FMB-në si institucion të ligjshëm, duke lënë rekomandime dhe duke i dhënë përgjigje shqetësimeve të kërkuarit. Problematika kryesore dhe rekomandimet kanë të bëjnë me zonimin e Parkut që nuk parashikohet nga ligji nr. 50/2022, por me akte nënligjore.

16. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

16.1 Në lidhje me pretendimin *për cenimin e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore*, nëpërmjet Marrëveshjes së Administrimit i janë dhënë FMB-së kompetenca mjaft të gjera, pasi ajo mund të vendosë vetë për kryerjen e kërkimeve arkeologjike, miratimin e të gjitha llojeve të ndërhyrjeve dhe aktiviteteve në pasurinë kulturore apo për kufizime të përkohshme të hyrjes në Park të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore (përfshirë punonjësit e Institutit të Arkeologjisë). Kjo situatë pasigurie juridike (në kushtet kur do të duhej të parashikohej me ligj dhe jo me protokolle bashkëpunimi garantimi i të drejtave të Institutit Arkeologjik), në aspektin praktik mund të krijojë probleme për gërmimet arkeologjike në të ardhmen, ndërkohë që në aspektin juridik nuk është në harmoni me parimin e shtetit të së drejtës, sipas nenit 4 të Kushtetutës.

16.2 Me miratimin e ligjit nr. 50/2022 situata e zbatimit të planeve të menaxhimit mund të komplikohet, pasi duket sikur FMB-ja do të marrë kompetenca për zbatimin e planeve të hartuara nga ajo vetë. Bashkëhartimi dhe miratimi i planeve të menaxhimit të pasurive të përfshira në listën e UNESCO-s nga institucionet shtetërore është standard i pranuar si nga konventat ndërkombëtare, ashtu edhe nga manualët e UNESCO-s në zbatim të tyre. Për arritjen e një standardi, në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes sa më të mirë të identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, rekomandohet harmonizimi në përputhje me legjislacionin e fushave të kulturës dhe mjedisit. Gjithashtu, edhe zbatimi i detyrimeve ndërkombëtare për territorin e Parkut dhe zonën rreth tij ka nevojë për parashikime ligjore specifike para se të kalohet në formë të reja administrimi, siç parashikon ligji nr. 50/2022. Rekomandohet, gjithashtu, rishikimi e përmirësimi i bazës rregullatore të krijimit të marrëdhënies me fondacionin, me qëllim ofrimin e garancive të plota për përmbushjen e funksioneve dhe detyrimeve themelore të shtetit që rrjedhin nga konventat dhe



Kushtetuta, sikurse edhe mbajtjen nën kontroll të vazhdueshëm të veprimtarisë së fondacionit për verifikimin e respektimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare mjedisore, me qëllim që të mos preket niveli i mbrojtjes mjedisore në këtë pasuri botërore dhe zonë Ramsar. Rekomandohet të saktësohet, gjithashtu, lloji i përgjegjësisë që mbajnë përfaqësuesit e AADF-së në fondacion.

16.3 Në marrëveshjen e miratuar me ligjin nr. 50/2022 konstatohen një sërë çështjesh që nuk janë në harmoni me parashikimet e akteve ndërkombëtare dhe me nenet 3 dhe 59, shkronja “g”, të Kushtetutës, pasi mund të përbëjnë premisa për cenimin e identitetit dhe të trashëgimisë kulturore. Këto konsistojnë në uljen e nivelit të kontrollit për miradministrimin e Parkut dhe mungesën e parashikimit të garancive konkrete dhe masave reale në rast të shkeljes së marrëveshjes. Sipas aktit të themelimit, por edhe Marrëveshjes së Administrimit, të gjitha kontrollat e ushtruara më parë nga Ministria e Kulturës dhe KLSH-ja nuk do të ushtrohen më dhe strukturat e kontrollit që më parë ishin në varësi të Ministrisë së Kulturës do të zëvendësohen me Njësinë e Monitorimit të Fondacionit, ndërsa kontrolli financiar do të kryhet nëpërmjet një shoqërie auditimi të jashtme, çka nuk garanton parimin e parashikuar në nenin 5, shkronja “g”, të Konventës së Parisit.

16.4 Disa parregullsi të tjera, jo të nivelit kushtetues, kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e Ministrisë së Kulturës në FMB, pasi legjislacionet që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe fondacioneve janë të ndryshme. Përfshirja e dy neneve në ligjin nr. 27/2018 dhe nxjerrja e një akti nënligjor të ministrit të Kulturës në zbatim të tyre, janë të pamjaftueshme për të rregulluar pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore publike në fondacione. Kuvendi, në tejkalim të parashikimeve ligjore, ka miratuar një marrëveshje të ndryshme nga ajo që parashikon neni 172, pika 5, i ligjit nr. 27/2018, pra një marrëveshje tjetër nga ajo që kanë nënshkruar palët.

III

Procesi në gjykimin kushtetues

17. Në mbledhjen e datës 22.12.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve mori në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të ligjit nr. 50/2022. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata,

kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e tij. Duke pasur parasysh përmbajtjen e kësaj dispozite, si edhe referuar argumenteve të kërkuarit në mbështetje të këtij kërkit, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar, duke vlerësuar se kërkuari nuk ka arritur të provojë ardhjen e pasojave të rënda ose të pariparueshme nga përmbajtja e aktit të kundërshtuar, çka përbën edhe kriterin thelbësor për të vendosur pezullimin e ekzekutimit të dispozitës/aktit të kundërshtuar.

18. Në datën 12.1.2023 Aleanca për Mbrojtjen e Butrintit ka paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në gjykimin kushtetues, në cilësinë e subjektit të interesuar, kërkesë që në aspektin formal është paraqitur nga disa individë që janë identifikuar si përfaqësues dhe themelues të kësaj shoqate. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi vlerësoi interesin e tyre referuar tri cilësive juridike të prezantuara, pra: *i.* si organizatë; *ii.* si grup interesi; *iii.* si individë, me vendimin e datës 22.2.2023, vendosi rrëzimin e kërkesës.

19. Në datën 23.1.2023, kërkuari ka paraqitur përpara Gjykatës kërkesat për thirrjen në gjykim të disa ekspertëve dhe dëshmitarëve, si edhe për kërkimin, administrimin dhe më pas vënien në dispozicion të dokumentacionit të përcaktuar prej tij nga disa organe shtetërore. Me vendimin e datës 31.1.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e këtyre kërkesave. Sipas saj, referuar natyrës së gjykimit kushtetues dhe fakteve të parashtruara, ato nuk vlerësohet se janë të tilla që të kërkojnë sqarim apo njohuri të posaçme në fusha të caktuara, pra të imponojnë thirrjen në këtë gjykim të dëshmitarëve ose ekspertëve të fushës. Për sa i përket administrimit të dokumentacionit të kërkuar nga kërkuari, u vlerësua se ai mund ta ushtrojë lirisht këtë të drejtë në institucionet përkatëse.

20. Me kërkesën e datës 27.1.2023, kërkuari ka kërkuar thirrjen në gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara, të Presidentit dhe Avokatit të Popullit. Me vendimin e datës 31.1.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se thirrja e këtyre subjekteve është në interes të gjykimit kushtetues.



21. Në datën 16.3.2023, Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona ka paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në gjykim në cilësinë e subjektit të interesuar, kurse me kërkesën e datës 17.3.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për: *“Dhënien e kohës së arsyeshme/mjaftueshme për studimin e parashtresave të palëve të interesuara, si dhe përgatitjen e qëndrimeve dhe/apo kundërshtimeve mbi to, si dhe kërkesa të tjera procedurale”*, duke kërkuar: i. për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe akteve voluminoze të saj, t’i japë kohën e arsyeshme/mjaftueshme për studimin e parashtimeve të palëve të interesuara dhe për përgatitjen e qëndrimeve dhe kundërshtimeve në lidhje me to; ii. kundërshtimin e thirrjes si subjekt të interesuar të FMB-së; iii. thirrjen në gjykim të disa ekspertëve dhe dëshmitarëve. Pas shqyrtimit të kërkesave të mësipërme, me vendimin e datës 5.4.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës së Akademisë Alternative Shkencore Rrënjët Tona, duke vlerësuar se ky subjekt nuk legjitimohet për të ndërhyrë në këtë çështje në cilësinë e subjektit të interesuar. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pranimin e saj pjesërisht, duke i lënë atij kohën e nevojshme për paraqitjen e prapësimeve për parashtimet e subjekteve të interesuara, ndërkohë që vendosi rrëzimin për pjesën tjetër.

22. Në seancën plenare publike të zhvilluar në datën 11.7.2023, kërkuesi ka parashtuar disa kërkesa paraprahe: i. detyrimin e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, për të vendosur në dispozicion informacionin që lidhet me komunikimet zyrtare ndërmjet Këshillit të Ministrave/Ministrit të Kulturës dhe UNESCO-s për menaxhimin e Butrintit, duke filluar nga viti 2019 e në vijim, procesverbalet e takimeve midis përfaqësuesve të UNESCO-s dhe përfaqësuesve të shtetit shqiptar për menaxhimin e Parkut, si dhe procedurën e ndjekur për zgjedhjen e shtetasit R. H., si anëtar i Bordit të Drejtorëve të FMB-së; ii. thirrjen e 5 dëshmitarëve me njohuri specifike që ndihmojnë në gjykimin kushtetues; iii. thirrjen si subjekt të interesuar të AADF-së; iv. përjashtimin si subjekt të interesuar të FMB-së; v. pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 50/2022 deri në vendimarrjen e Gjykatës. Me vendim të po kësaj date, Gjykata vendosi pranimin vetëm të kërkesës për vënien në dispozicion të komunikimeve zyrtare ndërmjet Këshillit të Ministrave/Ministrit të Kulturës dhe UNESCO-s

prej vitit 2019 e në vijim. Gjykata i la kohë kërkuetit deri më 25.7.2023 për t’u njohur me to dhe për t’i bërë me dije nëse ka nevojë për dokumentacion tjetër shtesë për sa i përket këtij kërkimi, ndërkohë që Këshillit të Ministrave i la kohë deri më 25.7.2023 për të vënë në dispozicion të kërkuetit, duke i depozituar pranë Gjykatës, dy shkresat e identifikuar prej tij në seancë plenare. Në lidhje me kërkesat e tjera paraprahe Gjykata vendosi rrëzimin e tyre.

23. Në datën 24.7.2023, Këshilli i Ministrave ka paraqitur në Gjykatë komunikimet e mbajtura mes tij dhe UNESCO-s, materiale të cilat i janë komunikuar kërkuetit me shkresën e datës 25.7.2023. Në datën 28.7.2023, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës, duke pretenduar se materialet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave nuk janë të plota dhe se ky subjekt nuk ka paraqitur asnjë nga materialet e kërkuara në seancën plenare të datës 11.7.2023. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 31.7.2023, bazuar në nenin 42, të ligjit nr. 8577/2000, vlerësoi t’i shqyrtojë këto pretendime në seancën plenare të radhës, më 21.9.2023.

24. Me kërkesën e datës 11.9.2023, kërkuesi ka kërkuar shtyrjen e seancës së radhës, duke kërkuar paraqitjen e kopjeve të përkthyer në gjuhën shqipe e të certifikuara sipas ligjit të disa prej dokumenteve të paraqitura në gjuhën angleze nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e ndërmjetëm të datës 12.9.2023, vendosi rrëzimin e kërkesës dhe detyrimin e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që të paraqesë, në afatin e caktuar, të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe dhe në formën e kërkuar nga ligji, aktet dhe dokumentet e përcaktuara nga kërkuesi.

25. Me shkresën nr. 1177/10 prot., datë 13.9.2023, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtuar para Gjykatës se ai ka zbatuar detyrën e lënë në seancën plenare të datës 11.7.2023, duke paraqitur, në formën që ai gjendet (në gjuhën angleze), dokumentacionin e plotë të cilësuar si “provë” nga kërkuesi. Sipas tij, dokumentacionin e kërkuar nga kërkuesi nuk e konsideron si “provë” dhe element i nevojshëm dhe i domosdoshëm për procesin gjyqësor dhe kërkuesi ka qenë në dijeni të plotë të faktit se dokumentacioni i paraqitur me kërkesën e tij është në gjuhë të huaj, duke pasur kohën e nevojshme për të paraqitur pranë Gjykatës prova që konsideron të vlefshme, në formën e



parashikuar nga ligji. Mbledhja e Gjyqtarëve, duke konstatuar se subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk ka përmbushur, brenda afatit të caktuar, detyrën e caktuar dhe duke vlerësuar se zhvillimi efektiv i seancës plenare të planifikuar për datën 21.9.2023 bëhej i pamundur, me vendimin e datës 18.9.2023, vendosi shtyrjen e saj për në datën 4.10.2023, duke i rikërkuar këtij subjekti të interesuar të përmbushë detyrën e caktuar deri më 27.9.2023.

26. Në seancën plenare publike të datës 4.10.2023, kërkuesi ka kërkuar marrjen e mendimit *amicus curia* nga Komiteti Juridik i UNESCO-s në lidhje me përputhshmërinë e ligjit nr. 50/2022, me Konventën e Parisit dhe në alternativë ose njëkohësisht të kërkohet nga Qendra e Trashëgimisë Botërore e UNESCO-s vënia në dispozicion e Raportit të Misionit të UNESCO-s sapo të finalizohet dhe të jetë e mundur të shpërndalet (*kërkesa e parë*). Në përfundim të kësaj seance, Gjykata u la palëve kohë deri në datën 6.10.2023, për të paraqitur me shkrim edhe kërkesat për marrje të provave, në formën e kërkuar nga ligji.

27. Në datën 6.10.2023, kërkuesi ka paraqitur para Gjykatës kërkesa: për të mos marrë në konsideratë, në cilësinë e provës, dokumentin “Mendim ligjor ekspert”, të dy profesorëve të Universitetit të Gjenevës, i paraqitur nga subjekti i interesuar, FMB-ja (*kërkesa e dytë*); për vënien në dispozicion në cilësinë e provave për të gjitha palët në procesin kushtetues të dokumenteve të referuara gjatë parashtrimeve të tyre nga subjektet e interesuara, si dhe të disa provave të rikërkua, konkretisht: 1. vendimi për ndryshimin e Bordit të Drejtorëve të FMB-së dhe procesi dokumentar i bërë për këtë vendim; 2. dosja përzgjedhëse e kandidatit R. H. nga Ministria e Kulturës; 3. shkresa e znj. Elva Margariti drejtuar KLSH-së, ku shpreh garancitë se ajo mund të auditojë Butrintin; 4. marrëveshja e vitit 2002 ose 2003 midis qeverisë shqiptare dhe AADF-së, që lidhet me përfshirjen e saj në Butrint; 5. kontrata e datës 6.9.2023 midis FMB-së dhe arkitektit japonez për projektin e Qendrës së Vizitorëve; 6. raporti i Misionit të UNESCO-s në Shqipëri i tetorit 2023; 7. procesverbali i takimit të datës 15.2.2023 mes Kryeministrit dhe drejtoreshës së përgjithshme të UNESCO-s që lidhet me Butrintin dhe/ose çdo komunikim tjetër që lidhet me këtë takim; 8. procesverbali i takimit të datës 15.2.2023 mes ministres së Kulturës dhe drejtoreshës së

përgjithshme të UNESCO-s që lidhet me Butrintin dhe/ose çdo komunikim tjetër që lidhet me këtë takim; 9. komunikimet mes organizmave të UNESCO-s, gjegjësisht të Misionit Këshillimor të UNESCO-s për Butrintin, me përfaqësues të shtetit shqiptar gjatë periudhës kohore 20–30 tetor 2022 (Misioni i UNESCO-s për Butrintin i përbërë nga përfaqësues të *World Heritage Center* dhe ICOMOS) (*kërkesa e tretë*); për zbatimin e vendimit të ndërmjetëm të Mbledhjes së Gjyqtarëve të datës 11.7.2023 dhe marrjen e materialeve (provave) të domosdoshme për gjykimin kushtetues, duke argumentuar që të evidentohet nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, se cila shkresë apo *email* zyrtar përmban informacionet e dërguara UNESCO-s dhe komentet e kësaj të fundit për disa pika thelbësore në lidhje me zbatimin e Konventës së Parisit, duke identifikuar edhe informacionin përkatës (*kërkesa e katërt*); për zëvendësimin e subjektit të interesuar, FMB-së, me AADF-në (*kërkesa e pestë*).

28. Në lidhje me këto kërkesa, Gjykata, me vendimin e ndërmjetëm të datës 10.10.2023, në lidhje me kërkesën e parë dhe pikën 6 të kërkesës së tretë, rezervoi të drejtën të shprehet në një moment të mëvonshëm. Gjykata gjeti të bazuar pikën 3 të kërkesës së tretë, duke i kërkuar subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, të vërë në dispozicion të Gjykatës shkresën e znj. Elva Margariti drejtuar KLSH-së, ndërkohë që vendosi rrëzimin për pjesën tjetër. Kurse për t'i dhënë përgjigje kërkesës për marrjen e një opinionit *amicus curia* nga organizmat e UNESCO-s, Gjykata vlerësoi të kërkojë informacion nga UNESCO nëse ky organ jep opinione ligjore *amicus curiae* për gjykatat kushtetuese të shteteve anëtare të Konventës së Parisit në lidhje me pajtueshmërinë e masave/legjislacionit kombëtar me këtë konventë, si dhe informacion në lidhje me kohën kur raporti i UNESCO-së për vitin 2023 do të jetë publik. Me shkresën e datës 25.10.2023 Zyra e Standardeve Ndërkombëtare dhe Çështjeve Ligjore të UNESCO-s ka kthyer përgjigje se Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s do të mbahej në datat 7–22 nëntor 2023 dhe se “Komiteti Ligjor i Konferencës së Përgjithshme nuk është i mandatuar të japë opinione ligjore “*amicus curiae*” për gjykatat kushtetuese të shteteve anëtare të Konventës së Trashëgimisë Botërore”. Për rrjedhojë, me vendimin e datës 30.10.2023, Gjykata vendosi



rrëzimin e kësaj kërkesë për sa kohë që ajo është ligjërish e pamundur.

29. Në datën 27.10.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për vënien në dispozicion nga subjekti i interesuar të shkresës nr. 1827 prot., datë 19.4.2023, të Këshillit të Ministrave drejtuar Ministrisë së Kulturës, duke pretenduar se ka shërbyer si zanafillë e ndryshimit thelbësor të qëndrimit të KLSH-së në seancë plenare dhe se ndodhemi përpara një rrethane të re për të cilën ai nuk ka pasur dijeni. Gjykata, me vendimin e datës 30.10.2023, vendosi pranimin e kërkesës, duke i kërkuar subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që për nevoja të këtij gjykimi kushtetues të paraqesë të gjithë praktikën që lidhet me shkresën nr. 1827 prot., datë 19.4.2023, brenda datës 2.11.2023.

30. Me vendimin e datës 2.11.2023, Gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e paraqitur nga kërkuesi për shtyrjen e seancës plenare të caktuar për t'u zhvilluar në datën 8.11.2023. Në seancën plenare të datës 13.11.2023 kërkuesi paraqiti kërkesë për përjashtimin nga gjykimi të tre anëtarëve të trupit gjykues, për të cilat Gjykata, pasi dëgjoi edhe palët e tjera në gjykim, vendosi rrëzimin e tyre, duke vlerësuar se asnjë nga këta gjyqtarë nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 36 i ligjit nr. 8577/2000. Në vijim Gjykata, pasi mori në shqyrtim edhe disa kërkesa të tjera të paraqitura nga kërkuesi gjatë seancës, vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave, përveç atyre të refuzuara me vendim të ndërmjetëm dhe caktimin e seancës plenare në datën 30.11.2023, për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare dhe për t'i dhënë mundësinë kërkuetit që në rast të miratimit të raportit të UNESCO-s të paraqesë pretendimet e tij në lidhje me të brenda kësaj date.

31. Në datën 22.12.2023 kërkuesi, përmes postës elektronike, i është drejtuar Gjykatës duke e informuar për *email*-in e po kësaj date të Zyrës së UNESCO-s, në përgjigje të informacionit të kërkuar nga ky subjekt dhe në datën 29.12.2023, ka paraqitur kërkesë për të kërkuar Gjykata, zyrtarisht, nga Ministria e Kulturës, si organi përgjegjës i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), raportin e misionit të UNESCO-s dhe ICOMOS-it të tetorit të vitit 2022 dhe vënien e tij në dispozicion të palëve. Për këtë arsye, kërkuesi ka kërkuar riçeljen e seancës plenare në mbështetje të nenit 44, të ligjit nr. 8577/2000.

32. Në përgjigje të shkresës së Gjykatës nr. 133 prot., datë 25.1.2024, IKTK-ja, me shkresën nr. 114/1 prot., datë 26.1.2023, ka informuar se në datat 14.9.2023 dhe 2.10.2023, përmes postës elektronike dhe materialit shkresor, është përcjellë pranë këtij institucioni raporti final i misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS për Qendrën e Pasurisë Botërore Butrint. Në këto kushte, Gjykata, në mbështetje të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, duke vlerësuar se administrimi i këtij raporti është i nevojshëm për sqarimin e aspekteve të kësaj çështjeje dhe shqyrtimin e saj, me vendimin e datës 30.1.2024, vendosi riçeljen e seancës plenare dhe zhvillimin e saj mbi bazë të dokumenteve.

33. Me shkresën e datës 1.2.2024, Gjykata i është drejtuar IKTK-së për vënien në dispozicion të një kopjeje të këtij raporti, i cili i është përcjellë nga kjo e fundit me shkresën e datës 2.2.2024, në gjuhën angleze. Me shkresën e datës 7.2.2024, Gjykata ka informuar palët në gjykim për përcjelljen e raportit dhe se ai është në proces përkthimi, kurse me shkresën e datës 12.2.2024, u ka vënë në dispozicion kopje të tij në gjuhën angleze dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

34. Në datën 13.2.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për marrjen e dokumentacionit të plotë në lidhje me komunikimin e IKTK-së me UNESCO-n. Sipas kërkuetit, nevojitej të administrohej edhe raporti i gjendjes së konservimit të Butrintit që do të shqyrtohet në sesionin e 46 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, i përmendur në seancën e datës 30.11.2023, nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, si me rëndësi dhe i domosdoshëm për gjykimin kushtetues. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 14.2.2024, Gjykata vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar.

35. Me kërkesën e datës 19.2.2024, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës, duke e vënë në dijeni për një dokument të UNESCO-s të datës 4.10.2023, të nënshkruar nga drejtori i Qendrës së Trashëgimisë Botërore, drejtuar Ambasadores së Delegacionit të Përhershëm të Shqipërisë në UNESCO, duke kërkuar nga Gjykata të konfirmojë nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, autenticitetin dhe vërtetësinë e tij dhe nëse kjo konfirmohet, caktimin e një afati kohor të arsyeshëm, në mënyrë që kërkuesi të parashtrojë analizën dhe konkluzionet lidhur me të, si dhe argumentet që sjell ky dokument në mbështetje të



kërkesës. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 20.2.2024, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

36. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: *“1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”*. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes. Megjithatë, Gjykata vendos edhe për çështje që parashikohen shprehimisht në norma të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 1, datë 23.1.2023; nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 36, datë 4.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, po në drejtëm të juridiksionit të saj, Gjykata ka theksuar se natyra e pretendimeve të ngritura është një nga elementet përcaktues të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje konkrete dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren se në datën 24.2.2021, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe AADF-së është lidhur Marrëveshja për Themelimin e Fondacionit dhe, në vijim, mes Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së është lidhur Marrëveshja e Administrimit, me anë të së cilës fondacionit i është dhënë e drejta ekskluzive dhe detyrimi për administrimin indirekt të pasurisë kulturore dhe të të drejtave e detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë marrëveshje, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe marrëveshjen e bashkëpunimit (pika 4.1 e marrëveshjes). Në mbështetje të nenit 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, që parashikon se marrëveshja i nënshtrohet miratimit në Kuvend në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 50/2022, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë

29.7.2022. Ligji nr. 50/2022, në nenin 1 të tij parashikon: *“Miratohet marrëveshja për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji”*, kurse në nenin 2 parashikon hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

38. Gjykata thekson, së pari, se ligji nr. 50/2022, ashtu si edhe çdo ligj tjetër, nuk përjashtohet nga kontrolli kushtetues në kuptim të përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës. Megjithatë, duke pasur parasysh përmbajtjen e ligjit objekt kerkese, edhe pse palët në proces nuk kanë paraqitur pretendime në këtë drejtim, Gjykata vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e juridiksionit të saj për kontrollin e akteve objekt kerkese. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të vërë në diskutim çështjen e juridiksionit të saj për kontrollin e ligjit miratues në aspektin substancial, pra për kontrollin e Marrëveshjes së Administrimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së, bashkëlidhur ligjit nr. 50/2022.

39. I pyetur në seancë plenare në lidhje me natyrën e kësaj kontrate, subjekti i interesuar Kuvendi u përgjigj se marrëveshja e miratuar me ligjin nr. 50/2022, si akt normativ i miratuar nga Kuvendi me procedurë parlamentare, është jashtë sferës së përkufizimeve të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurave Administrative. Sipas këtij subjekti, çfarëdo karakteri të ketë në vetvete Marrëveshja e Administrimit (*sui generis*, hibride apo në sferën e së drejtës publike) fakt i pakundërshtueshëm është se ajo ka marrë fuqinë dhe efektin e ligjit, pra është akt normativ (ligj) i miratuar nga Kuvendi në përputhje me funksionin e tij ligjvënës.

40. Gjykata vëren se sipas jurisprudencës kushtetuese vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt dhe, në këtë kuptim, karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Për këtë qëllim, gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës, Gjykata ndalet, paraprakisht, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin kushtetues për shqyrtimin substancial të tij (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Një akt me karakter normativ vendos norma të përgjithshme sjelljeje me karakter abstrakt, i shtrin efektet mbi një



kategori të pacaktuar subjektesh dhe nuk është shterues në zbatimin e tij (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Natyra normative e aktit është e lidhur me fuqinë e përgjithshme të tij, në pikëpamje të aftësisë për të prekur situatën juridike të personave juridikë apo fizikë me anë të krijimit të të drejtave ose detyrimeve për ta (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata thekson se, në parim, ligjet kanë natyrë të përgjithshme, çka është ndër tiparet tipike dhe thelbësore të akteve me natyrë normative dhe që i dallojnë ato nga aktet me natyrë individuale. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se ajo nuk vë në diskutim natyrën jo normative të vetë Marrëveshjes së Administrimit, palë të së cilës janë një institucion publik me personalitet juridik, Ministria e Kulturës dhe një person juridik privat, FMB-ja. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje, si një akt vullneti mes palëve, është administrimi efektiv, sipas një modeli administrimi indirekt të pasurisë së trashëgimisë kulturore, i parashikuar nga ligji, që synon konservimin, mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të pasurisë kulturore, përmes së cilës, Ministria e Kulturës, si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i jep FMB-së të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për administrimin indirekt të pasurisë kulturore dhe të të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë marrëveshje, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e fondacionit, por pa u kufizuar në to.

42. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i natyrës së akteve normative, ligjvënësi ka zgjedhur të parashikojë në legjislacionin e brendshëm modele të tilla që lejojnë Kuvendin të ndërhyjë për miratimin edhe të akteve që, pavarësisht se nuk normojnë rregulla të përgjithshme sjelljeje, mbartin në vetvete interes publik ose kombëtar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe, kur është e mundur, administrimi i saj, kanë për qëllim, ndër të tjera, kujdesin për burimet historike, kulturore dhe artistike, mbrojtja dhe promovimi i të cilave u përket autoriteteve shtetërore dhe, në këtë drejtim, ato gëzojnë një hapësirë vlerësimi në përcaktimin e interesit të përgjithshëm të shoqërisë (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Në rastin konkret rezulton se neni 53 i ligjit nr. 27/2018 ka bërë klasifikimin e pasurive kulturore të paluajtshme, për sa i përket rëndësisë së tyre

kulturore, kërkimore dhe rëndësisë sociale, ku në kategorinë “me rëndësi universale” bëjnë pjesë vlerat e paluajtshme kulturore që janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Në vijim, në nenin 172, pika 5, të këtij ligji është parashikuar se në rastet kur administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore me rëndësi universale kryhet nga persona juridikë jofitimprurës, marrëveshja e lidhur nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me fondacionin e posaçëm për administrimin i nënshtrohet miratimit në Kuvend.

44. Në kuptim të sa më sipër, Parku Kombëtar i Butrintit përfaqëson një nga zonat e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, mjedisore dhe turistike të vendit. Për shkak të vlerave të tij historiko-kulturore qyteti antik i Butrintit është përfshirë në Listën e Monumenteve të Mbrojtura të Pasurisë Kombëtare dhe në vitin 1992 ai është përfshirë edhe në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Për rrjedhojë, qëllimi i parashikimit përmes ligjit nr. 27/2018 të ndërhyrjes së Kuvendit në këtë rast, si përfaqësues i vullnetit të popullit, lidhet me detyrimin e shtetit, të sanksionuar në Kushtetutë dhe Konventën e Parisit, për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre vlerave të pasurisë universale. Nisur nga kjo premisë, edhe pse në rastin konkret jemi para një përjashtimi nga rregulli i natyrës së përgjithshme të aktit të miratuar nga Kuvendi, natyra e pasurisë kulturore kombëtare në fjalë përcakton edhe interesin publik në rastin konkret, i cili, në vlerësimin e ligjvënësit, është i tillë që nuk mund të vlerësohet apo përcaktohet nga organe të tjera të pushtetit publik. Gjykata vlerëson se edhe pse tipikisht nuk jemi para një akti me karakter të përgjithshëm, që ka normuar rregulla të përgjithshme të sjelljeje, marrëveshja që i bashkëlidhet ligjit nr. 50/2022 ka marrë, për këtë shkak, veshje formale me ligj.

45. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar juridiksionin kushtetues në rastin konkret, për sa kohë që ai nuk aktivizohet automatikisht vetëm sepse një akt i caktuar me natyrë jo normative vishet formalisht me ligj për shkak të miratimit të tij nga Kuvendi, për sa kohë ai është i lidhur ngushtësisht edhe me natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në lidhje me procedurën parlamentare të miratimit të akteve objekt kërkese, pra për anën formale, por pretendimet e parashtruara në kërkesë kanë të bëjnë me anën përmbajtësore të këtyre akteve. Kërkuesi ka



pretenduar se parashikimet e marrëveshjes bien ndesh me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore, si dhe me parimet e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve normative, të ligjshmërisë, të kontrollit të financave publike, të ndarjes e balancimit të pushteteve dhe atë të autonomisë vendore, pretendime këto që, për nga natyra e tyre, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

46. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ajo ka juridiksion për kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve objekt kërkesë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, për sa kohë që jo vetëm që marrëveshja e miratuar me ligjin nr. 50/2022 dhe që i bashkëlidhet atij për këtë shkak ka marrë veshje formale me ligj, por edhe bazuar në natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, që janë elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues.

B. Për legjitimitimin e kërkuarit

B.1. Për legjitimitimin *ratione personae*

47. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në lidhje me subjektin kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, të parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka theksuar se interesi publik i këtyre funksionarëve publikë është i prezumuar, pasi një kërkesë e tyre vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të aktit normativ dhe interesi që kërkohet të mbrohet lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 55, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae* si në aspektin formal, në kushtet kur kërkesa është paraqitur nga një numër prej 36 deputetësh të Kuvendit, ashtu edhe substancial për vënien në lëvizje të kontrollit abstrakt të pajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve objekt kërkesë.

B.2. Për legjitimitimin *ratione temporis*

49. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe FMB-së, në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ligjshmërisë kërkuari nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi argumentet kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 27/2018 dhe VKM-ve nr. 279/2019 e nr. 625/2019, për rrjedhojë

është paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar të përcaktuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

50. Sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën është 2 vjet nga hyrja në fuqi e aktit. Ligji nr. 50/2022 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 29.7.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 14.11.2022, pra brenda afatit ligjor. Për rrjedhojë, kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*.

51. Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe pse nuk janë objekt i kërkesës në shqyrtim, në përmbajtje të saj janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe zbatimin e neneve 171 dhe 172, të ligjit nr. 17/2018. Po kështu, kërkuari ka kundërshtuar edhe përmbajtjen e parashikimeve të VKM-ve nr. 279/2019 dhe nr. 625/2019, pasi në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës i kanë dhënë KKMPK-së, organi që ka vendosur dhënien e statusit “partner strategjik” AADF-së, kompetenca përtej atyre të dhëna me ligj, duke cenuar kështu rezervën ligjore. Gjykata konstaton se ligji nr. 27/2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12.6.2018 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, kurse VKM-të janë botuar në Fletoret Zyrtare nr. 64, datë 6.5.2019 dhe nr. 132, datë 25.9.2019, çka përcakton edhe momentin e hyrjes në fuqi të këtyre akteve dhe nga i cili fillon edhe afati 2-vjeçar për të kërkuar kontrollin abstrakt të pajtueshmërisë me Kushtetutën. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione temporis* për kundërshtimin e këtyre akteve normative, pasi pretendimet e tij janë paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar.

B.3. Për legjitimitimin *ratione materiae*

52. Gjykata, referuar thelbit të kërkesës në shqyrtim, vëren se kërkuari ka pretenduar se ligji nr. 50/2022 ka cenuar identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore, pasi shteti ka hequr dorë nga detyrimi për të ruajtur, administruar e zhvilluar Parkun si përfaqësues i identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, duke ia dhënë me koncesion një personi juridik privat edhe pse këto prerogativa i takojnë si detyrim sovran dhe ekskluziv shtetit shqiptar dhe nuk mund të transferohen te një subjekt privat. Po në këtë drejtim, kërkuari ka pretenduar se statuti dhe Marrëveshja për Themelimin e Fondacionit parashikojnë se shteti do të luajë rolin e tij nëpërmjet



një përfaqësimi të paqenë në Bordin e Drejtorëve, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, të përcaktuar në mënyrë nominale, ku përfaqësuesit e shtetit janë në pakicë dhe ku vetëm ministria paraqitet në cilësi shtetërore, ndërsa përfaqësuesi tjetër nuk ka asnjë funksion shtetëror. Po sipas kërkesit, është cenuar edhe *parimi i shtetit të së drejtës dhe i hierarkisë së akteve normative*, pasi ligji nr. 50/2022 është nxjerrë në kundërshtim me nenin 122 të Kushtetutës, për sa kohë që në Konventën e Parisit nuk ka asnjë dispozitë që lejon menaxhimin ose administrimin e pasurive kulturore kombëtare nga ente/OJF private, ndërkohë që ky është detyrim dhe përgjegjësi ekskluzive dhe e patransferueshme e shtetit palë.

53. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendi dhe Këshillit të Ministrave, pretendimi për cenimin e *identitetit kombëtar* dhe të *trashëgimisë kulturore* lidhet me përbërjen e Bordit të Drejtorëve të FMB-së, parashikime që nuk janë pjesë e Marrëveshjes së Administrimit, por e aktit të themelimit të fondacionit, i cili nuk është objekt i këtij gjykimi. Sipas këtyre subjekteve, shteti nuk zhvishet në asnjë moment nga përgjegjësia e tij për ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kulturore të Butrintit, pasi ai, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, është edhe administrues, edhe kontrollues.

54. Sipas subjektit të interesuar, FMB-së, pretendimet për mënyrën e krijimit, statutin, organizimin e brendshëm, si dhe procedurën e shpalljes së tij partner strategjik i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, për rrjedhojë nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata.

55. Gjykata, duke pasur parasysh thelbin e këtyre pretendimeve të kërkesit, vlerëson se ato kanë të bëjnë në thelb me përmbushjen e detyrimit nga ana e shtetit për respektimin dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore universale e lidhur kjo me identitetin kombëtar, si detyrime që burojnë nga Kushtetuta dhe Konventa e Parisit, e cila si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar që ka epërsi mbi ligjet e vendit, përcakton detyrimin e shtetit që në miratimin e kuadrit ligjor të brendshëm të ruajë dhe mbrojë rolin parësor të shtetit për mbrojtjen dhe konservimin e pasurisë së trashëgimisë kulturore. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto pretendime me natyrë kushtetuese do të shqyrtohen në vijim së bashku, në këndvështrim të parimit të identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve ligjore. Kurse për sa u përket pretendimeve

të kërkesit, po në drejtim të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore, që kanë të bëjnë me raportin e përfaqësimit të shtetit në Bordin e Drejtorëve sipas statutit dhe Marrëveshjes për Themelimin e Fondacionit, Gjykata vlerëson se ato nuk mund të merren në shqyrtim prej saj për sa kohë që aktet e formimit dhe organizimit të brendshëm të FMB-së nuk janë objekt kërkesë dhe nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

56. Kërkesi ka pretenduar cenimin e *parimit të ligjshmërisë* të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës, për shkak të procedurës për dhënien e statusit “partner strategjik” AADF-së. Sipas tij, ligji nr. 27/2018 nuk i ka dhënë kompetenca KKMPK-së që të vlerësojë si të tillë një subjekt që synon të marrë administrimin e një pasurie kulturore me vlera universale dhe ky organ ka kompetencë të miratojë vetëm strategjitë për administrim të qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore. Sipas kërkesit, ky parim cenohet edhe nga përmbajtja e VKM-së nr. 279/2019, me të cilën Këshilli i Ministrave ka autorizuar KKMPK-në me më shumë kompetenca nga ato që i ka dhënë Kuvendi me ligjin nr. 27/2018 dhe VKM-në nr. 625/2019, duke i dhënë KKMPK-së një kompetencë që nuk e ka sipas ligjit dhe as nuk mund ta kryejë, nisur dhe nga kriteret që përcaktojnë emërimin e anëtarëve të këtij organi. Sipas kërkesit, duke qenë se AADF-ja e gëzon statusin në mënyrë antiligjore, ekzistenca e FMB-së është antikushtetuese.

57. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, argumentet e kërkesit në lidhje me parimin e ligjshmërisë lidhen me akte ligjore ose nënligjore që nuk janë objekt i këtij gjykimi kushtetues. Sipas këtij subjekti, vlerësimi i partnerit strategjik është bërë nga KKMPK-ja në bazë të kriterëve të parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 27/2018 dhe aktet e tjera nënligjore dhe kriteret e referuara nga kërkesi si antikushtetuese janë përcaktuar në VKM-të nr. 279/2019 dhe nr. 625/2019, të cilat për sa kohë nuk janë pjesë e objektit të kërkesës nuk mund t'i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues.

58. Gjykata vëren se në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, AADF-ja, një organizatë jofitimprurëse, e organizuar dhe themeluar sipas ligjeve të shtetit të Delaware, SHBA, që vepron përmes degës së saj në Shqipëri, e regjistruar me vendimin nr. 359, datë 18.3.2011, të



Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 15.10.2019 i ka paraqitur ministrisë përgjegjëse shprehjen e interesit për krijimin e fondacionit të posaçëm për administrimin indirekt të pasurisë kulturore në nënzonat A3 të Parkut të Butrintit. Me vendimin nr. 3, datë 6.4.2020, KKMPK-ja ka vendosur vlerësimin si partner strategjik të AADF-së për themelimin e fondacionit të posaçëm. Në datën 24.2.2021, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe AADF-së është lidhur Marrëveshja për Themelimin e Fondacionit dhe, në vijim, mes Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së, është lidhur Marrëveshja e Administrimit, që është objekt i këtij gjykimi.

59. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim kanë të bëjnë me statusin që i është njohur AADF-së si partner strategjik, pra në thelb me përmbajtjen e vendimit të KKMPK-së, i cili, jo vetëm që nuk është pjesë e këtij gjykimi, por për nga natyra e tij është një akt individual, për rrjedhojë Gjykata nuk ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e tij.

60. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të kontrollit të financave publike*, pasi shmanget tërësisht kontrolli i shtetit për të ardhurat që do të gjenerohen nga një pasuri kombëtare. Kërkuari ka pretenduar se duke qenë se objekti i Marrëveshjes së Administrimit është, ndër të tjera, dhënia në administrim e pasurisë publike, me qëllim rritjen e të ardhurave për ta përmirësuar atë, kurrsesi nuk mund të shmanget kontrolli i KLSH-së. Sipas tij, me krijimin e FMB-së i hiqet mundësia KLSH-së të kontrollojë se çfarë bëhet me paratë e pasurisë publike, sepse ajo është subjekt privat dhe nuk auditohet nga ky organ, ndalim ky i shprehur në pikën 26.5 të statutit.

61. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, pretendimi për cenimin e nenit 163 të Kushtetutës është i pabazuar, pasi fondacioni është një OJF, për rrjedhojë mënyra e administrimit të të ardhurave rregullohet sipas ligjit nr. 8788/2001. Sipas këtij subjekti, neni 26 i statutit të FMB-së nuk e pengon KLSH-në të ushtrojë kontroll në pjesën e fondeve që kanë burim buxhetin e shtetit dhe as ligji nr. 50/2022 nuk përmban ndonjë ndalim që fondet e buxhetit të shtetit të kontrollohen nga ky organ.

62. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, ky pretendim i referohet nenit 5, pika 1, shkronja “o”, të aktit të themelimit të FMB-së, që nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues dhe në

asnjë dispozitë të Marrëveshjes së Administrimit ose ligjit nr. 50/2022 nuk është parashikuar përjashtimi i veprimtarisë së FMB-së nga auditimi i KLSH-së. Sipas këtij subjekti, objekt auditimi nga KLSH-ja është përdorimi i fondeve të transferuara në fondacion nga shteti shqiptar, si dhe veprimtaria ekonomike në tërësi e tij në menaxhimin e të ardhurave që vijnë nga Parku, si pasuri publike, por jo fondet që investohen nga AADF-ja.

63. Sipas subjektit të interesuar, FMB-së, Marrëveshja e Administrimit nuk ndalon ushtrimin e kontrollit nga KLSH-ja dhe parashikimet e nenit 26.5 të statutit nuk pengojnë kontrollin e fondeve që kanë burim buxhetin e shtetit. Sipas tij, fondet e financuara nga AADF-ja nuk janë objekt i KLSH-së, pasi ato nuk janë fonde publike të shtetit shqiptar, duke qenë AADF-ja subjekt i kontrollit nga autoritetet përkatëse të përcaktuara në statutin e themelimit.

64. Subjekti i interesuar, KLSH-ja, në prapësimet e tij drejtuar Gjykatës, është shprehur se Marrëveshja e Administrimit bie ndesh me nenin 162 të Kushtetutës, pasi për nga natyra e saj juridike pasuria që jepet në administrim është brenda fushës së kompetencës së KLSH-së, ndërkohë që ligji e pengon këtë organ në ushtrimin e funksionit dhe kompetencave të tij. KLSH-ja ka pretenduar se përmbajtja e pikës 5 të nenit 26 të statutit të FMB-së dhe e nenit 18 të Marrëveshjes për Themelimin e Fondacionit cenojnë sferën e kompetencave dhe pavarësinë e KLSH-së dhe ato janë pjesë integrale e vetë Marrëveshjes së Administrimit, duke cenuar edhe parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve juridike, pasi me një ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë cenohen kompetencat e miratuara me shumicë të cilësuar. Në seancën plenare publike të datës 30.11.2023, përfaqësuesi i KLSH-së ndryshoi qëndrim në lidhje me këtë pretendim, duke kërkuar interpretim pajtues të dispozitave të ligjit nr. 50/2022 dhe të kuadrit ligjor të auditimit të jashtëm në sektorin publik, me qëllim sqarimin e kompetencave që ka KLSH-ja për auditimin e mënyrës së përdorimit, administrimit dhe mbrojtjes së fondeve publike që lidhen me Parkun e Butrintit.

65. Sipas nenit 162, pika 1, të Kushtetutës, KLSH-ja është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ajo u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe sipas nenit 163 të saj, KLSH-ja kontrollon: a) veprimtarinë ekonomike të



institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë; b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti. Në kuptim të këtyre kompetencave, Gjykata, referuar përmbajtjes së akteve të kundërshtuara, vëren se ato nuk përmbajnë parashikime që të mos lejojnë ushtrimin e kompetencës kushtetuese të këtij organi për kontrollin e përdorimit të fondeve publike në kundërshtim me parashikimin kushtetues. Bazuar edhe në aktet e administruara gjatë këtij gjykimi, ashtu si edhe në qëndrimet e vetë palëve, Gjykata konstaton se në rastin konkret nuk vihet në diskutim e drejta e KLSH-së për ushtrimin e kompetencës së saj për kontrollin e fondeve publike të administruara nga FMB-ja, për sa kohë që ushtrimi i kësaj kompetence është i lidhur me natyrën e fondeve (burimin e tyre) dhe jo të entitetit që i administron ato, ndërkohë që nga ky kontroll përjashtohen vetëm kontributet financiare që vijnë nga burime të tjera jopublike dhe që u nënshtrohen parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe të vetë marrëveshjes. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës ky pretendim është haptazi i pabazuar.

66. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe atë të autonomisë vendore*, pasi në momentin e miratimit të ligjit nr. 50/2022, neni 54, shkronja “e”, i ligjit nr. 139/2015 parashikonte kompetencën e këshillit bashkiak që të vendoste me shumicë të cilësuar miratimin e tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të tretëve, ndërkohë që Bashkia Sarandë nuk është konsultuar dhe nuk është shprehur me votim për kalimin në përdorim të sipërfaqeve që administroheshin prej saj. Sipas kërkuesit, shkelja e parashikimeve të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore ka të bëjë me heqjen e rolit të pushtetit vendor për planet zhvillimore të zonës, por edhe për mbledhjen e të ardhurave nga aktivitete të kryera në territorin e asaj bashkie, mungesën e konsultimit paraprakisht me autoritetet vendore, duke munguar një vendimmarrje ose thjesht një diskutim në këshillin bashkiak, si dhe injorimin e opinionit të banorëve të zonës, të cilët kanë protestuar disa herë në hyrje të Parkut të Butrintit dhe kanë qenë pjesëmarrës në tryezat e organizuara nga shoqëria civile. Kërkuesi ka pretenduar se nëpërmjet ligjit nr.

50/2022, Bashkisë së Sarandës po i hiqet ushtrimi i kompetencave të saj për Butrintin dhe zhvillimet rreth tij, siç janë ato të infrastrukturës mbështetëse.

67. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, ky pretendim është i pabazuar, pasi kjo pasuri nuk ka qenë asnjëherë në administrim të pushtetit lokal, por të Ministrisë së Kulturës, për shkak të rëndësisë së saj si pasuri kulturore universale. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, për sa u përket veprimeve me karakter ndërtimor, ato kryhen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, në rastin konkret atij për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në bazë të të cilit organet vendore janë ato që miratojnë aktet në funksion të zhvillimit të territorit. Sipas këtij subjekti, Marrëveshja e Administrimit nuk parashikon heqjen e këtyre kompetencave dhe as shmangien e këtyre organeve, si dhe nuk përmban asnjë dispozitë që të cenojë të drejtën e bashkisë për të arkëtuar taksat dhe tarifatat vendore sipas legjislacionit në fuqi. Po sipas tij, përpara miratimit të marrëveshjes është kryer një proces i gjatë konsultimi, janë zhvilluar një sërë tryezash e takimesh me palë të interesuara, ekspertë, si dhe konsultimi publik sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

68. Sipas subjektit të interesuar, FMB-së, Parku i Butrintit nuk ka qenë asnjëherë në administrim të pushtetit lokal, por në administrim të Ministrisë së Kulturës, për shkak të rëndësisë si pasuri kulturore universale. Sipas tij, duke marrë në konsideratë rekomandimet e UNESCO-s, ministria ka zhvilluar disa seanca konsultimesh në nivel vendor dhe qendror.

69. Gjykata vëren se në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata, Bashkia e Sarandës, me shkresën nr. 4/1 prot., datë 23.1.2023, ka informuar Gjykatën se bazuar në VKM-të nr. 531, datë 31.10.2002, nr. 495, datë 22.7.2014 dhe nr. 82, datë 2.3.2000, Parku Kombëtar i Butrintit është shpallur në mbrojtje të shtetit dhe për administrimin e tij është ngarkuar Zyra e Administrimit dhe Koordinimit (ZAK), njësi nën juridiksionin e Ministrisë së Kulturës. Gjykata vëren, gjithashtu, se sipas VKM-së nr. 450, datë 1.7.1998, “Për administrimin e qytetit antik të Butrintit”, ky i fundit, si pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe asaj botërore, vihet tërësisht në konservimin e Ministrisë së Kulturës (pika 1). Për arsye të administrimit të Parkut Kombëtar të Butrintit është krijuar dhe



ZAK-ja, e cila është në varësinë e Ministrisë së Kulturës (pika 2). Në këtë kuptim, Gjykata evidenton se Parku Kombëtar i Butrintit në momentin e miratimit të ligjit nr. 50/2022 ka qenë në administrim të pushtetit qendror, konkretisht të Ministrisë së Kulturës. Për rrjedhojë, kjo pasuri nuk bën pjesë në atë kategori që kërkon pëlqimin ose vendimmarrjen e organeve të njësisë së qeverisjes vendore për tjetërsimin e administrimit të saj. Gjithsesi Gjykata, bazuar edhe në rekomandimet e raportit të misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS të vitit 2022, thekson se palët gjatë zbatimit të marrëveshjes duhet të zhvillojnë mekanizmat për pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në administrimin e Parkut të Butrintit, brenda parashikimeve të planit strategjik të menaxhimit të integruar.

70. Megjithatë, bazuar në thelbin e këtyre pretendimeve të kërkuarit në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me përplasje mes akteve ligjore në fuqi, konkretisht mes përmbajtjes së ligjit nr. 50/2022 dhe ligjit nr. 139/2015 që parashikon kompetencat e këshillit bashkiak për miratimin e tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave që janë në pronësi të bashkisë për të tretët. Për rrjedhojë, në rastin konkret gjendemi para një konflikti ndërmjet normave ligjore të të njëjtit nivel, çështje që del jashtë juridiksionit kushtetues për sa kohë që nuk është detyrë e kësaj Gjykate shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy akteve normative të të njëjtit nivel dhe as mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të akteve normative dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tyre me akte normative të tjera (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 5, datë 5.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, ky pretendim nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

71. Për sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë në vijim, në lidhje me bazueshmërinë e tij në themel, pretendimin e kërkuarit për cenimin e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve ligjore.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve ligjore

72. Kërkuari ka pretenduar se shteti ka hequr dorë nga detyrimi për të ruajtur, administruar e

zhvilluar Parkun e Butrintit, si përfaqësues i identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, duke ia dhënë atë me koncesion një personi juridik privat, për rrjedhojë FMB-ja ka marrë prerogativa që i takojnë si detyrim sovran dhe ekskluziv shtetit, në kundërshtim me nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës dhe nenet 5 e 29 të Konventës së Parisit. Sipas tij, ligji nr. 50/2022 është nxjerrë në kundërshtim me nenin 122 të Kushtetutës, për sa kohë që në Konventën e Parisit nuk ka asnjë dispozitë që lejon menaxhimin ose administrimin e pasurive kulturore kombëtare nga ente/OJF private. Kurse për sa i takon rolin të fondacioneve, Konventa e Parisit në nenin 17 parashikon se ato kanë si qëllim “vetëm të ftojnë donacione” dhe se duhet të jenë vendase, jo të huaja. Kërkuari ka pretenduar se në relacionin e projektligjit nuk argumentohet arsyeja se përse duhej lidhur patjetër marrëveshja me një subjekt privat dhe përse shteti shqiptar nuk paska fonde të mjaftueshme apo kapacitete të tjera jofinanciare që të menaxhojë vetë një pasuri si Parku i Butrintit, duke pasur në konsideratë se zhvillimi i zonave të caktuara mbart interes publik. Sipas kërkuarit, kriteret e parashikuara në ligjin nr. 50/2022 përbëjnë trajtim favorizues të fondacionit në raport me subjektet e tjera private potencialisht të interesuara për të konkurruar për këtë projekt zhvillimi, pasi kriteret kanë qenë dekurajuese dhe të vështira për t'u përmbushur nga entitete të tjera. Kërkuari ka pretenduar edhe se raporti i misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS mbështet pretendimet e tij se ligji nr. 50/2022 nuk ruan rolin parësor të shtetit palë si garant i mbrojtjes së OUV-ve, por e zhvesh atë nga atributet sovrane të identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transferimit të brezat e ardhshëm të pasurisë.

73. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se FMB-ja merr vetëm administrimin e pasurisë kulturore dhe jo pronësinë e saj, ndërkohë që neni 17 i Konventës së Parisit parashikon krijimin e fondacioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe nuk vendos kufizime për formën, mënyrën ose subjektin të cilit duhet t'i kalojë ose jo në administrim një pasuri e tillë. Sipas tij, modeli i zgjedhur bën të mundur që të ardhurat e realizuara nga administrimi të përdoren ekskluzivisht për mbrojtjen e pasurisë kulturore me vlera universale, duke realizuar qëllimin e rritjes së burimeve financiare në dispozicion të mbrojtjes së saj, Sipas këtij subjekti, neni 4 i Konventës së Parisit nuk



vendos ose imponon asnjë ekskluzivitet të autoriteteve shtetërore për të garantuar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transmetimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, ndërkohë që ministria mbetet përgjegjëse dhe ruan rolin e saj kryesor në menaxhimin e të gjithë trashëgimisë botërore të vendit dhe qenies si pika qendrore për këto çështje dhe raportimin periodik pranë UNESCO-s. Ky rol garantohet përmes monitorimit të vazhdueshëm, kontrollit fizik, kontrollit përmes lejeve, licencave dhe autorizimeve që duhet të marrë fondacioni për çdo aktivitet në administrimin e pasurisë kulturore. Sipas këtij subjekti, raporti i misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS ka fuqi rekomanduese dhe nuk përbën të drejtë ndërkombëtare të detyrueshme dhe ai nuk ka ngritur shqetësime për mënyrën e menaxhimit të nënzonës A3 apo pajtueshmërinë me Konventën e Parisit.

74. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se modeli i administrimit të Parkut të Butrintit përmes administrimit indirekt, ka ardhur si nevojë e gjetjes së vlerave të reja të administrimit në funksion të konservimit, mbrojtjes dhe rritjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, pasi sistemi aktual i menaxhimit nuk garantonte në perspektivë mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre, si dhe nuk siguronte të ardhura sipas pritshmërive që duhet të ketë kjo pasuri me vlera universale. Sipas tij, në asnjë dispozitë të marrëveshjes nuk parashikohet kalimi i pronësisë së Parkut të Butrintit, e cila i mbetet shtetit përgjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, ndërkohë që qëllimi i FMB-së është mirëmenaxhimi i aseteve të pasurisë. Këshilli i Ministrave ka prapësuar se përzgjedhja e formës së administrimit, qoftë të një pasurie që përbën vlerë të trashëgimisë kulturore, është kompetencë që i takon vetë shtetit ndaj nuk mund të klasifikohet si shkelje e të drejtave dhe lirive themelore sipas nenit 17 të Kushtetutës. Sipas tij, Konventa e Parisit nuk trajton mjetet dhe mënyrat se si secili shtet në nivelin e brendshëm do të realizojë detyrimet e tij, ndërkohë që neni 17 i saj nuk ndalon ngritjen, bashkëpunimin dhe përfshirjen e fondacioneve në administrimin e pasurive kulturore dhe as nenet 5, 6 dhe 29 të konventës nuk parashikojnë ndonjë ndalim për modelin e administrimit të pasurisë kulturore nga një fondacion. Sipas këtij subjekti, raporti UNESCO/ICOMOS nuk sjell asnjë ndikim në gjykimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 50/2022.

75. Subjekti i interesuar, FMB-ja, ka prapësuar se ai merr në administrim dhe jo në pronësi pasurinë kulturore dhe qëllimi i tij është mbrojtja, ruajtja, zhvillimi, promovimi dhe menaxhimi më i mirë i pasurisë kulturore. Sipas tij, kërkuksi nuk përmend asnjë të drejtë ose vlerë kushtetuese që të jetë prekur dhe Ministria e Kulturës mbetet përgjegjëse dhe ruan rolin e saj kryesor në menaxhimin e trashëgimisë botërore, si dhe vijon të veprojë si pika qendrore për të gjitha këto çështje dhe raportimin tek UNESCO. Sipas tij, neni 5 i Konventës së Parisit nuk vendos asnjë detyrim menaxherial të autoritetit shtetëror për pasuritë kulturore, por përcakton detyrimet që duhet të ndërmarrë shteti palë, nëpërmjet burimeve të brendshme, për të garantuar mbrojtjen, konservimin dhe ruajtjen e pasurive kulturore, kurse neni 17 i saj inkurajon shtetet palë që të krijojnë fondacione për mbledhjen e donacioneve dhe financimeve në fushën e trashëgimisë kulturore. Po sipas FMB-së, raporti UNESCO/ICOMOS, që ka fuqi rekomanduese, nuk ka shprehur shqetësime për kapërcimin e kufijve të Kushtetutës dhe ligjit ose mospërputhjen me konventat ndërkombëtare.

76. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka parashtruar se përmes Marrëveshjes së Administrimit i janë dhënë FMB-së kompetenca mjaft të gjera, pasi ajo mund të vendosë vetë për kryerjen e kërkimeve arkeologjike, miratimin e të gjitha llojeve të ndërhyrjeve dhe aktiviteteve në pasurinë kulturore ose edhe për kufizime të përkohshme të lejimit të hyrjes në Park të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore. Avokati i Popullit ka rekomanduar harmonizimin në përputhje me legjislacionin e fushave të kulturës dhe mjedisit për arritjen e një standardi në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes sa më të mirë të identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, si dhe rishikimin e përmirësimit të bazës rregullatore të krijimit të marrëdhënies së shtetit me fondacionin, me qëllim ofrimin e garancive të plota për përmbushjen e funksioneve dhe detyrimeve themelore të shtetit që rrjedhin nga konventat dhe Kushtetuta, sikurse edhe mbajtjen nën kontroll të vazhdueshëm të veprimtarisë së fondacionit. Sipas këtij subjekti, në marrëveshje konstatohen një sërë çështjesh që nuk janë në harmoni me parashikimet e akteve ndërkombëtare dhe me nenet 3 dhe 59, shkronja “g”, të Kushtetutës, pasi mund të përbëjnë premisa për cenimin e identitetit dhe të trashëgimisë



kulturore dhe konsistojnë në uljen e nivelit të kontrollit për miradministrimin e Parkut të Butrintit dhe mungesën e parashikimit të garancive konkrete dhe masave reale në rast të shkeljeve.

77. Gjykata konstaton, fillimisht, se pretendimet e kërkuarit shtrihen si në drejtim të respektimit të parimeve dhe vlerave kushtetuese, ashtu edhe në drejtim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme. Gjykata vëren se shteti shqiptar është palë e Konventës së Parisit, e miratuar në vitin 1972 në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s (hyrë në fuqi në vitin 1975). Ajo është ratifikuar nga shteti shqiptar në datën 10.7.1989 dhe ka hyrë në fuqi në datën 10.10.1989, duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm juridik. Për rrjedhojë, Gjykata do të verifikojë pretendimet e kërkuarit si në aspektin kushtetues, ashtu edhe atë konventor.

78. Gjykata ka theksuar se rëndësia dhe roli i *identitetit kombëtar* në rendin juridik rrjedh nga fakti se ai garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, e cila formulon qëllimet e kushtetutëbërësit dhe është shprehje e vullnetit të popullit. Trashëgimia kombëtare përbën një nga bazat e shtetit, respektimi dhe mbrojtja e saj përbëjnë vlerë kushtetuese, ndaj është detyrë e shtetit të miratojë dhe përcaktojë mënyrat e format për garantimin dhe mbrojtjen e saj, si dhe të sigurojë ruajtjen për brezat e ardhshëm. Ajo është pjesë e trashëgimisë së popullit, përbën kujtesën e prekshme dhe të paprekshme të asaj që njeriu ka krijuar (dhe vazhdon të krijojë) për pasardhësit e tij, si dhe një formë të veçantë të shprehjes së kulturës së popullit dhe përfshin çdo gjë që konsiderohet vendimtare për identitetin e një shoqërie ose vendi. Për këtë arsye identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare parashikohen në nenin 3 të Kushtetutës, që përcakton se shteti ka për detyrë të mbrojë dhe të respektojë bazat e përcaktuara në të, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse vlera themelore, pra që qëndrojnë në themel të organizimit shtetëror. Për më tepër që trashëgimia kombëtare dhe kulturore, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, përbën një nga objektivat socialë, që shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon të mbrojë (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

79. Duke mbajtur parasysh se shteti ka për detyrë respektimin dhe mbrojtjen e bazave (vlerave themelore) të përcaktuara shprehimisht në

Kushtetutë, organet shtetërore në aktet që miratojnë dhe në veprimet që kryejnë, nga njëra anë, duhet të frymëzohen nga këto vlera themelore (neni 3), por, nga ana tjetër, ato njëkohësisht duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, pra që veprimtaria e tyre të jetë e bazuar tek e drejta në kuptimin e gjerë (*latu sensu*), e cila përfshin jo vetëm Kushtetutën, por edhe kuadrin ligjor respektiv (neni 4) (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i *shtetit të së drejtës*, i parashikuar në nenin 4, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike (*shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Ai i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Për garantimin e këtij parimi të gjitha organet, të parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t'i nënshtrohen parimit të kushtetutshmërisë dhe atij të ligjshmërisë. Parimi i shtetit të së drejtës shërben për të përvijuar dhe kontrolluar veprimtarinë e organeve shtetërore, ndërsa bazat (vlerat themelore), ku përfshihen edhe identiteti e trashëgimia kombëtare, shërbejnë për të interpretuar normat kushtetuese dhe atë veprimtari (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Në drejtim të parimit të *hierarkisë së akteve ligjore*, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata ka theksuar se normat juridike duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Piramida e akteve normative, e parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 3, datë 20.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lexim të kombinuar të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe kanë epërsi ndaj ligjeve që nuk pajtohen me të.



81. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vëren se Konventa e Parisit përmban parashikime të zbatueshme në rastin konkret, pasi e shtrin fushën e zbatimit dhe mbrojtjes së saj ndaj pasurive kulturore dhe natyrore të një vlere të jashtëzakonshme, çka u jep atyre një rëndësi universale duke i përfshirë në pasurinë e përbashkët të njerëzimit. Kjo nuk ndryshon statusin juridik të këtyre pasurive, të cilat vijojnë të mbeten nën sovranitetin e shtetit në territorin e të cilit ndodhen dhe nuk ndryshon as pronësinë e tyre, por përcakton, përveç interesit kombëtar, një interes të përgjithshëm të komunitetit ndërkombëtar për ruajtjen dhe mbrojtjen jo vetëm të dimensionit material, por edhe të identitetit kombëtar e kulturor që ato mbartin. Konventa e Parisit bazohet në parimin e pasurisë botërore të njerëzimit si një e tërë, pra përdor elementin e universalitetit, në bazë të të cilit ekzistojnë pjesë të pasurisë kulturore dhe natyrore, që për shkak të karakteristikave të tyre të jashtëzakonshme dhe domethënies që mbartin kanë një rëndësi të tillë që shtyn komunitetin ndërkombëtar të bashkëpunojë për të garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen në interes jo vetëm të shtetit palë të cilit i përkasin, por të të gjithë njerëzimit.

82. Përmes nënshkrimit të kësaj konvente shtetet palë marrin përsipër jo vetëm të ruajnë sitet e pasurisë botërore që ndodhen në territorin e tyre, por edhe që të mbrojnë pasurinë kombëtare. Sipas nenit 4 të Konventës së Parisit, cilido shtet palë i saj pranon se detyra e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit të brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të referuar në nenet 1 dhe 2 të saj e që ndodhet në territorin e tij, i përket në radhë të parë atij shteti. Ai do të bëjë gjithçka që mundet për këtë qëllim, në maksimum të burimeve të veta dhe, ku është e përshtatshme, me çdo ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në veçanti, financiar, artistik, shkencor dhe teknik, që mund të jetë në gjendje të marrë. Në kuptim të kësaj dispozite detyrimi i shtetit është në thelb mbrojtja dhe konservimi i kësaj pasurie, pa përcaktuar konventa mekanizmat dhe mënyrat se si zbatohet nga shtetet palë ky detyrim. Për këtë arsye, në nenin 29 parashikohet se shtetet palë, në raportet që i paraqesin Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s, do të japin informacion për dispozitat ligjore dhe administrative që kanë miratuar dhe për veprime të tjera që kanë marrë për zbatimin e kësaj konvente, së bashku me

detajet e përvojës së fituar në këtë fushë, raporte që i vihen në vëmendje Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

83. Në nenin 5 të Konventës së Parisit janë përcaktuar veprimet që shtetet palë duhet të kryejnë për të garantuar marrjen e masave efikase dhe aktive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tyre dhe që përfshijnë: miratimin e një politike të përgjithshme, e cila ka si synim t'i japë trashëgimisë kulturore dhe natyrore një funksion në jetën e komunitetit; ngritjen, brenda territorit, të shërbimeve për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të pajisura me stafin dhe mjetet e përshtatshme; zhvillimin e studimeve dhe kërkimeve shkencore që lejojnë përmirësimin e metodave dhe teknikave të ndërhyrjes së shtetit për të përballuar rreziqet që kërcënojnë pasurinë kulturore ose natyrore; marrjen e masave ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të nevojshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin; themelimin ose zhvillimin e qendrave kombëtare dhe rajonale për kërkime shkencore dhe trajnim në mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

84. Ndërsa Konventa e Parisit respekton plotësisht sovranitetin e shteteve në territorin e të cilave ndodhet trashëgimia kulturore dhe natyrore e përmendur në nenet 1 dhe 2 të saj, dhe pa paragjykim ndaj së drejtës së pronësisë e garantuar edhe nga legjislacioni kombëtar, shtetet palë pranojnë se kjo trashëgimi përbën një trashëgimi botërore për mbrojtjen e së cilës është detyrë e komunitetit ndërkombëtar si një i tërë që të bashkëpunojë (neni 6 i konventës). Kurse në kreun IV të Konventës së Parisit, që parashikon krijimin e fondit për mbrojtjen e pasurisë botërore kulturore dhe natyrore, përfshihet edhe neni 17, sipas të cilit shtetet palë marrin në konsideratë ose inkurajojnë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose shoqatave, qëllimi i të cilave është të ftojnë donacionet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore siç përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të saj.

85. Detyrimet e shteteve palë sipas Konventës së Parisit kanë gjetur trajtim edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Italisë, e cila ka vlerësuar se nenet 4 dhe 5 të kësaj konvente vendosin detyrime për shtetet palë, mes të cilave për të garantuar



“identifikimin, mbrojtjen, ruajtjen, përmirësimin dhe kalimin te brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore”, që ndodhen në territorin e tyre, por edhe i lënë shtetet të lira që të identifikojnë “masat juridike, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të përshtatshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, vlerësimin dhe ringjalljen e kësaj trashëgimie”. Në këtë kuptim, i rezervohet ligjvënësit vlerësimi i mundësisë së një mbrojtjeje më bindëse dhe më specifike të pasurive në fjalë dhe të mënyrave të artikullimit të kësaj mbrojtjeje (*shih vendimin nr. 22, të vitit 2016, të Gjykatës Kushtetuese të Italisë*).

86. Gjykata vlerëson të theksojë sërish qëndrimin e saj se detyrimi kushtetues i shtetit për mbrojtjen dhe respektimin e identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kombëtare, i parë i lidhur me parimin e shtetit të së drejtës, ka të bëjë si me marrjen e masave nga ana e ligjvënësit, ashtu dhe me zbatimin në praktikë nga institucionet përkatëse të procedurave ligjore për këtë qëllim (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, ligjvënësi ka lirinë dhe hapësirën e veprimit, brenda kornizës kushtetuese dhe asaj konventore dhe me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi, që të vlerësojë dhe të përcaktojë me ligj masat që janë të nevojshme dhe që sigurojnë respektimin e vlerave kushtetuese, ashtu edhe formën e tyre, duke garantuar rolin ruajtës dhe mbrojtës të shtetit.

87. Në zbatim të këtyre parashikimeve, me ligjin nr. 27/2018 ligjvënësi ka përkufizuar “trashëgiminë kulturore” si tërësinë e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen për t’u përçuar brezave në të ardhmen si pjesë të pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit (neni 5, pika 59). Në kuptim të këtij ligji pasuritë kulturore përbëjnë pronë shtetërore publike (neni 4), mbrojtja e të cilave konsiston në ndërmarrjen e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit (neni 5, pika 31). Ligji nr. 27/2018 ka parashikuar edhe disa modele të administrimit të pasurive kulturore në pronësi publike, që mund të jenë direkte dhe indirekte (neni 171). Administrimi direkt realizohet nëpërmjet strukturave organizative të specializuara në varësi të institucioneve shtetërore

ose subjekteve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative, financiare dhe me personel të specializuar tekniko-shkencor, ose edhe në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike, kurse ai indirekt realizohet nëpërmjet: a) fondacioneve të posaçme; b) fondacioneve të krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore; c) personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, të cilëve pasuria kulturore u jepet në administrim. Kurse sipas nenit 172, administrimi mund të kryhet edhe nga persona juridikë jofitimprurës, të krijuar në formën e fondacionit, të bashkëthemeluar ndërmjet institucioneve shtetërore, të përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, dhe personave fizikë ose juridikë privatë, vendas apo të huaj, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin civil në fuqi. Sipas pikës 9 të këtij neni, edhe pse pasuria i kalon në administrim fondacionit sipas marrëveshjes përkatëse, titulli i pronësisë në çdo rast i mbetet shtetit.

88. Gjykata, bazuar në dispozitat e mësipërme kushtetuese dhe konventore, si dhe jurisprudencën e gjykatave kushtetuese homologe, vëren se ato kanë në themel të tyre garantimin e *rolit parësor të shtetit* në mbrojtjen dhe konservimin e pasurive kulturore dhe natyrore që ndodhen në territorin e tij. Nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës, ashtu si edhe parashikimet e Konventës së Parisit, kanë përcaktuar detyrimin e shtetit për të garantuar mbrojtjen dhe konservimin e pasurisë kulturore duke ruajtur ai rolin parësor në këtë drejtim, pra duke ruajtur atributet sovranë mbi këto pasuri që përbëjnë bazat dhe vlerat e vetë shtetit. Mbështetur në rekomandimet e raportit të misionit të përbashkët UNESCO/ICOMOS të vitit 2022, si dhe në vlerësimin e bërë pas rishikimit të vitit 2019 nga ICOMOS, i cili ka dalë në përfundimin se plani i menaxhimit të integruar është një bazë e shkëlqyer për menaxhimin e ardhshëm të Parkut Kombëtar të Butrintit (*shih faqen 16 të raportit në gjuhën angleze*), Ministria e Kulturës, në kuadër në administrimit, mbetet përgjegjësjë kryesore për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe në këtë kuadër, në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjes, përfshihet në përgatitjen e planeve të investimit, të konservimit, të inventarit kulturor të objekteve të trashëgimisë kulturore, ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive të listuara në të, si dhe në ngritjen e grupit kërkimor të Butrintit me personalitete shkencore nga fusha e kërkimeve



arkeologjike, me qëllim miratimin e çdo veprimi me natyrë zbuluese, kërkimore dhe konservuese për çdo objekt të pasurisë kulturore të zbuluar dhe ekspozuar në Parkun e Butrintit.

89. Në analizë të dispozitave kushtetuese dhe konventore Gjykata konstaton se, ndonëse në thelb ato ndalojnë zhveshjen e shtetit nga këtotribute, nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur formën se si ato ushtrohen, pra nuk parashikojnë ndonjë formë ekskluziviteti në administrimin e pasurive kulturore dhe natyrore dhe as nuk ndalojnë forma të ndryshme të mbrojtjes dhe konservimit. Konventa e Parisit ka identifikuar se masat e nevojshme për këtë qëllim kanë natyrë juridike, shkencore, teknike, administrative dhe financiare, por ajo ka lënë në vlerësimin e shteteve palë formën dhe mënyrën në të cilën do të ushtrohet kjo mbrojtje dhe masat e nevojshme për përmbushjen e rolit të shtetit. Nga ana tjetër, edhe pse neni 17 i Konventës së Parisit parashikon se shtetet palë mund të inkurajojnë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose organizatave me qëllim ftimin e donacioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, kjo në vetvete është tregues se përfshirja e të tilla fondacioneve jo vetëm nuk përjashtohet, por inkurajohet në administrimin e pasurisë, për sa kohë që ruhet në çdo rast roli parësor i shtetit sipas kësaj konvente.

90. Gjykata vlerëson të theksojë se ajo nuk vë në dyshim natyrën e pasurisë kulturore objekt i Marrëveshjes së Administrimit (Parku Kombëtar i Butrintit) dhe vlerat që ka kjo pasuri në drejtëm të identitetit dhe trashëgimisë kulturore, ashtu edhe vlerat e jashtëzakonshme universale të saj, dhe as detyrimin e shtetit për të garantuar dhe mbrojtur këto vlera të jashtëzakonshme, si në kuptim të nenit 3 të Kushtetutës, për sa kohë që ato përfaqësojnë bazat e shtetit, ashtu edhe në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare. Po kështu, bazuar në sa më sipër, Gjykata nuk vë në dyshim as skemën e administrimit indirekt të miratuar nga ligji nr. 27/2018, për sa kohë që ky model rezulton të jetë i lejueshëm nga neni 3 i Kushtetutës dhe parashikimet e Konventës së Parisit, pasi në përmbushje të delegimit kushtetues ligjvënësi ka ndërhyrë për parashikimin e regjimeve të posaçme për përdorimin dhe shfrytëzimin e këtyre pasurive, me qëllimin që të sigurohen format më të mira të realizimit të synimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre, duke përcaktuar si një nga format e administrimit edhe atë indirekt. Kjo formë

administrimi nënkupton mostransferimin e përgjegjësisë dhe detyrimeve kushtetuese të shtetit, pra të atyre kompetencave sovrane që nuk mund të delegohen ose zëvendësohen. Në këtë kuptim, miratimi i Marrëveshjes së Administrimit është bërë në zbatim të modelit të administrimit indirekt të parashikuar nga dispozitat e ligjit nr. 27/2018.

91. Në këto kushte, Gjykata do të ndalet në vijim në verifikimin nëse mënyra se si është zbatuar ky model administrimi dhe/ose mënyra se si është zbërthyer koncepti i administrimit indirekt në aktet objekt gjykimi dhe nëse vetë Marrëveshja e Administrimit respekton rolin parësor të shtetit në këtë administrim. Për këtë qëllim Gjykata, për të verifikuar nëse në rastin në shqyrtim është garantuar roli parësor i shtetit, do e shqyrtojë çështjen në dy drejtime. *Së pari*, ajo do të verifikojë natyrën e të drejtave dhe detyrimeve që ka FMB-ja sipas Marrëveshjes së Administrimit, si dhe të drejtave, detyrimeve dhe kompetencave që ka shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, çka do e ndihmojë Gjykatën për të verifikuar vetë natyrën e administrimit që është synuar të rregullohet nga marrëveshja objekt kërkese. *Së dyti*, Gjykata do të verifikojë nëse parashikimet e Marrëveshjes së Administrimit i kanë njohur FMB-së një status të ndryshëm, më të privilegjuar në krahasim me subjekte të tjera të së drejtës, në kuptim të përjashtimit ose jo të ndjekjes së procedurave ligjore dhe atyre administrative apo të kontrollit shtetëror në kuadër të realizimit dhe zbatimit të administrimit indirekt. Nëpërmjet këtij verifikimi, Gjykata do të analizojë nëse shteti vazhdon të ruajë funksionet e tij në lidhje me identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transferimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

92. Për sa u përket të drejtave dhe detyrimeve të FMB-së sipas Marrëveshjes së Administrimit, Gjykata vëren se fondacioni merr të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për administrimin indirekt të pasurisë kulturore (pika 4.1) që ka të bëjë me posedimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe gëzimin (por jo pronësinë) dhe të drejtën e administrimit pa asnjë barrë, detyrim ose kufizim, përveç atyre të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm, marrëveshja dhe protokollit i bashkëpunimit; të drejtën për kalim mbi dhe nën, si dhe hyrjen dhe daljen nga dhe në çdo vend të pasurisë kulturore, pa ndërhyrje të panevojshme nga ndonjë palë e tretë për qëllimin e zbatimit të marrëveshjes (pika 7.1,



shkronjat “a” dhe “b”). FMB-ja harton aktet dhe rregulloret e brendshme për administrimin dhe operimin e saj, si dhe planet e konservimit e të investimit, kryen procedurat për rekrutimin e stafit, si dhe përcakton tarifatat për shërbimet e ofruara sipas planit të biznesit (pika 6.5); harton dhe zbaton strategjitë, politikat, programet dhe/ose planet e zhvillimit, procedurat dhe rregulloret e saj të brendshme për kryerjen e veprimtarive për zhvillimin, mirëmbajtjen, koordinimin, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të pasurisë kulturore në përputhje me planin e menaxhimit dhe planin e zbatueshëm; miraton planet vjetore të veprimtarisë ekonomike dhe/ose kulturore, artistike, turistike, edukative dhe kërkimore, në përputhje me planin e menaxhimit dhe ua komunikon ministrive përgjegjëse sipas fushës së kompetencës; siguron ekspertizën e nevojshme për mbarëvajtjen e administrimit të pasurisë; siguron qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e pasurisë kulturore; mbështet, nxit, koordinon dhe mbikëqyr kërkimet shkencore në bashkëpunim me institucionet e tjera për promovimin, ruajtjen, pasurimin dhe ekspozimin e trashëgimisë kulturore për menaxhimin e mirë të pasurisë kulturore; bashkëpunon dhe informon autoritetet kompetente nëse vihet në dijeni për zhvillime të ndryshme që kryen jashtë territorit, por që mund të kenë ndikim në të; bashkëpunon me autoritetet kompetente rajonale të zonave të mbrojtura; bashkëpunon me persona të tretë për njohjen, publikimin dhe tërheqjen e financimeve dhe donacioneve për ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe përmirësimin e vlerave të pasurisë kulturore; informon autoritetet kompetente për planet e sipërpërmendura, në bazë të kërkesës së tyre, në përputhje me fushën e përgjegjësisë (pika 9).

93. Po sipas Marrëveshjes së Administrimit, FMB-ja do të financojë studime, kërkime dhe analiza për mjedisin, infrastrukturën dhe shërbime të ndryshme që do të ofrohen në kuadër të administrimit; do të kryejë vetë ose nëpërmjet nënkontraktorëve, studime, kërkime dhe monitorime periodike për qëllime të ndryshme (pikat 12.1 dhe 12.2). Në kuadër të funksioneve ruajtëse, FMB-ja harton dhe miraton planin e detajuar të konservimit; merr vendim për projektin e ndërhyrjeve ruajtëse dhe preventivin përkatës që kryhet nga subjektet e licencuara; kryen vetë ose kontraktin persona të licencuar për kryerjen e

punimeve të konservimit dhe ndërhyrjeve të tjera ruajtëse; informon institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për çdo dëmtim, zbulim ose çdo veprim të parashikuar në ligjin nr. 27/2018; koordinon punën me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore dhe mbulon shpenzimet për projektimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërhyrjes ruajtëse; mban informacion për pasurinë kulturore (pika 13.4). Kurse në kuadër të ndërhyrjeve mbrojtëse, FMB-ja kontraktin subjekte të licencuara për kryerjen e restaurimeve ose ndërhyrjeve mbrojtëse dhe kryen procedurat për marrjen e miratimeve ose lejeve për këtë qëllim, si dhe garanton sigurinë fizike të pasurisë (pika 13.5).

94. Gjykata vëren se Marrëveshja e Administrimit përcakton edhe detyrimet e FMB-së për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë, promovimin e saj, si edhe raportimin në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së administrimit dhe gjendjen e pasurisë kulturore, pra mënyrën e ushtrimit dhe hapësirën brenda së cilës ajo ushtron tagrat e dhëna përmes kësaj marrëveshjeje, në kuptim dhe në kufij të parashikimeve të ligjit nr. 27/2018. Sipas marrëveshjes, pasuria kulturore e paluajtshme nuk do të përdoret nga fondacioni për ndonjë qëllim tjetër, të ndryshëm nga sa parashikohet në të (pika 7.5) dhe ai është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e kësaj pasurie (pika 13.1), si dhe nuk mund ta transferojë administrimin në palë të treta, edhe pse mund të kontrakttojë të tilla për kryerjen e punëve dhe shërbimeve në kuadër të administrimit (pika 26.2). FMB-ja garanton sigurinë dhe ruajtjen fizike të pasurisë kulturore, duke marrë masa konkrete dhe duke lidhur marrëveshje e protokolle bashkëpunimi për këtë qëllim (pika 15), si dhe mban e përditëson rregullisht inventarin e saj (22.1). FMB-ja do të ndërmarrë veprimtari për vlerësimin dhe promovimin e pasurisë kulturore (pika 18) dhe do të krijojë grupin shkencor të Butrintit, si një organ këshillimor për çështjet tekniko-shkencore, që do të përfshijë ekspertë të fushave të ndryshme që mbulojnë veprimtaritë e administrimit të pasurisë kulturore (pika 21.1).

95. Për sa u përket të drejtave dhe detyrimeve të shtetit, të përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, sipas Marrëveshjes së Administrimit rezulton se ajo ngre njësinë e monitorimit dhe brenda muajit qershor të çdo viti FMB-ja dorëzon pranë saj raportin për administrimin e pasurisë kulturore gjatë vitit



kalendari të mëparshëm. Ministria vlerëson dhe monitoron administrimin e pasurisë kulturore në bazë të këtij raportimi dhe ajo mund të ushtrojë kontroll në vend për vlerësimin e gjendjes së konservimit të raportuar nga fondacioni (pika 24). Ministria jep miratimin për lëvizjen me qëllim ekspozimin e pasurive kulturore të luajtshme jashtë pasurisë kulturore (pika 8.1), si dhe për kryerjen nga FMB-ja dhe/ose subjektet e përzgjedhura prej saj të veprimtarive ekonomike në pasuritë kulturore në kuptim të neneve 100 dhe 102, të ligjit nr. 27/1018, që kanë të bëjnë me organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve artistike, kulturore dhe tregtare në ambientet e pasurive kulturore ose zonat e mbrojtura si pasuri kulturore (pikat 14.9 dhe 14.15). Për sa u përket hulumtimeve arkeologjike, mes FMB-së dhe Institutit të Arkeologjisë lidhet protokoli i bashkëpunimit dhe pa cenuar të drejtat e këtij instituti, FMB-ja ka të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me persona të tretë të licencuar ose me institute ndërkombëtare me qëllim ruajtjen, konservimin dhe promovimin me qëllim edukativ të Parkut të Butrintit (pikat 16.1–16.3). Po kështu, për ndërtimin e qendrës së vizitorëve FMB-ja i dorëzon ministrisë draftin e planit të zbatimit, ku kjo e fundit ka të drejtë të bëjë komentet ose ndryshimet dhe gjatë ndërtimit i dorëzon ministrisë në mënyrë periodike raporte progresi për punimet, ndërkohë që ministria ka të drejtë të mbikëqyrë ndërtimin e kësaj qendre (pika 20). Marrëveshja e Administrimit parashikon edhe masat që mund të merren nga ministria në rast mospërbushjeje nga ana e FMB-së, siç janë ushtrimi i së drejtës së ndërhyrjes duke marrë pjesërisht ose plotësisht administrimin apo njoftimin për zgjidhjen e marrëveshjes në rast se mospërbushja nuk korrigjohet brenda periudhës së njoftuar (pika 28). Gjykata mban në konsideratë në këtë drejtim se pavarësisht pretendimeve të kërkuarit në drejtim të përfaqësimit të shtetit në Bordin e Drejtorëve dhe pavarësisht se jemi para një entiteti të së drejtës private, ky përfaqësim i jep mundësinë atij të kontrollojë edhe në këtë aspekt mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë në drejtim të administrimit indirekt.

96. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se parashikimet e Marrëveshjes së Administrimit, që vijnë në zbatim të modelit të administrimit indirekt, garantojnë rolin parësor të shtetit, pasi ato nuk parashikojnë dhe nuk lejojnë kalimin e pronësisë mbi pasurinë universale, duke

mos e zhveshur shtetin nga pronësia dhe tagrat e saj, pra nga çdo e drejtë që i lind atij si pronari i vetëm i kësaj pasurie. Të drejtat dhe kompetencat që i janë dhënë FMB-së nga shteti përmes Marrëveshjes së Administrimit në zbatim të kësaj skeme administrimi, në çdo rast nuk tejkalojnë ato të një administrimi të zakonshëm të pasurisë dhe nuk përmbajnë elemente të kompetencave sovraane të shtetit në ushtrimin e funksionit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurisë. Për më tepër, Gjykata vëren se kjo mënyrë administrimi përmes një fondacioni të së drejtës private, respekton edhe kërkesën e Konventës së Parisit për mbledhjen e donacioneve, për sa kohë sipas Marrëveshjes së Administrimit FMB-ja financohet nga partneri strategjik nëpërmjet grantit në vlerën 4,985,000 dollarë (pika 23.3). Nga ana tjetër, po sipas Marrëveshjes së Administrimit, FMB-ja ka të drejtën të ndërmarrë nisma dhe zbatojë projekte me synim vlerësimin dhe promovimin e pasurisë kulturore, duke përfshirë çdo formë reklamimi dhe/ose sponsorizimi, si dhe të lidhë marrëveshje sponsorizimi në formën e kontributeve financiare të drejtpërdrejta ose në natyrë (pika 18.2).

97. Kurse për sa i takon *statusit të FMB-së*, e lidhur kjo me privilegjet dhe funksionet e kontrollit të shtetit mbi veprimtarinë e saj sipas Marrëveshjes së Administrimit, Gjykata vëren se çdo akt i FMB-së është subjekt i kontrollit të drejtpërdrejtë të organeve shtetërore sipas fushës së kompetencës të përcaktuar me ligj. Në këtë drejtim Gjykata, siç theksoi më sipër, vëren se çdo fond dhe e ardhur e krijuar me natyrë publike nuk përjashtohet nga kontrolli i KLSH-së, ndërkohë që FMB-ja nuk përjashtohet as nga marrja e lejeve ose licencave përkatëse nga autoritetet kompetente për fillimin e punimeve ndërtimore apo ndërhyrjet ruajtëse dhe mbrojtëse në këtë pasuri, sipas marrëveshjes. Gjykata vëren se FMB-ja deklaron dhe garanton se do të ketë, mbajë dhe përmbushë kërkesat e të gjitha lejeve dhe licencave për të cilat ka përgjegjësinë për t'i siguruar dhe mbajtur dhe se do të administrojë pasurinë kulturore në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe këtë marrëveshje (pika 5.3). Po kështu, FMB-ja do të aplikojë dhe marrë lejet dhe licencat përkatëse për punime dhe veprimtari që lidhen me, por pa u kufizuar në: leje zhvillimore; leje ndërtimi; vlerësim të ndikimit në mjedis; leje të peizazhit kulturor; leje për ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme; licencë



për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale (projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim); licencë për qarkullimin e përkohshëm të pasurive të luajshmë kulturore; licencë importi të pasurive kulturore; çdo leje, licencë ose miratim të nevojshëm sipas legjislacionit të zbatueshëm (pika 19).

98. Bazuar në sa më sipër, në vlerësimin e të drejtave, detyrimeve dhe kompetencave të secilës palë, në kuptim të termave të administrimit që përcaktohen në Marrëveshjen e Administrimit objekt gjykimi, Gjykata arrin në përfundimin se, nga njëra anë, për nga natyra e tyre, të drejtat e FMB-së nuk tejkalojnë ato të një administrimi të zakonshëm dhe, nga ana tjetër, marrëveshja nuk e zhvesh shtetin nga roli i tij parësor në drejtim të identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transferimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, por ruan dhe garanton këtë rol, i cili ushtrohet përmes formave të ndryshme të kontrollit të veprimtarisë së administrimit indirekt, për sa kohë që FMB-së nuk i është njohur ndonjë status i privilegjuar ligjor, duke iu nënshtruar ky entitet parashikimeve ligjore të zbatueshme, ashtu si çdo entitet tjetër i së drejtës.

99. Edhe pse pasuria objekt i Marrëveshjes së Administrimit i ka kaluar në administrim fondacionit të posaçëm, titulli i pronësisë i mbetet shtetit, ndërkohë që termat e administrimit dhe përdorimit të pasurisë në administrim janë në përputhje me destinacionin e tyre dhe përcaktohen brenda kufijve dhe qëllimit të marrëveshjes së lidhur mes palëve. Forma e kalimit në administrim indirekt të Parkut të Butrintit një subjekti të së drejtës private, FMB-së, e cila është e lejueshme nga parashikimet kushtetuese dhe ato konventore, është realizuar në përputhje me parashikimet ligjore të miratuara në zbatim të atyre dispozitave dhe nuk prek ose nuk cenon rolin parësor të shtetit në këtë administrim.

100. Gjykata thekson se, në kuptim të standardeve kushtetuese dhe konventore, roli i shtetit për mbrojtjen dhe garantimin e pasurive kombëtare dhe atyre universale nuk ushtrohet përmes administrimit të tyre vetëm nga institucione/organe shtetërore, por edhe përmes gjetjes së atyre formave dhe modeleve të administrimit që garantojnë ruajtjen e konservimin dhe ndalojnë degradimin ose dëmtimin e këtyre pasurive. Parashikimet e Marrëveshjes së Administrimit, në vlerësimin e Gjykatës, garantojnë ushtrimin e rolit parësor të shtetit dhe mbështesin

qëndrimin se veprimtaria e FMB-së dhe kompetencat e saj lidhen me funksionin e administrimit të pasurisë kulturore, pa tejkaluar dhe pa ndryshuar këto kompetenca, për sa kohë që FMB-ja nuk përjashtohet nga përmbushja e çdo detyrimi ligjor që ka sipas legjislacionit çdo entitet tjetër, qoftë ai shtetëror ose publik. Nga ana tjetër, në vlerësimin e Gjykatës, FMB-ja, në këndvështrim të nenit 17 të Konventës së Parisit, ushtron edhe rolin për mbledhjen e donacioneve, me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

101. Për sa më sipër, Gjykata, referuar standardeve kushtetuese dhe konventore, si dhe parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, të miratuar në zbatim të tyre, arrin në përfundimin se të drejtat dhe kompetencat që i transferohen FMB-së janë me natyrë administrative (menaxhuese) dhe se shteti vijon të ruajë atributet e tij sovranë për sa kohë që jo vetëm ruan pronësinë mbi këtë pasuri, por ushtron edhe të drejtat dhe kompetencat e tij përmes administrimit indirekt të Parkut të Butrintit.

102. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuar për cenimin e identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve ligjore është i pabazuar, sipas arsytimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 24.4.2024.

Shpallur, më 30.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Elsa Toska, Sonila Bejtja



MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga 36 deputetë të Kuvendit (jo më pak se një e pesta), me objekt: “*Shfuqizimi i ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, ‘Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit’, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi çmoj se kërkesa duhej të ishte pranuar, duke u shfuqizuar ky ligj si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën e Parisit. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Në vlerësimin tim, ligji i kundërshtuar bie ndesh me Kushtetutën dhe Konventën e Parisit (e ratifikuar dhe pjesë e sistemit të brendshëm juridik) për këto dy arsye kryesore: i. *nga ana formale*, ai nuk respekton parimet kushtetuese që lidhen me funksionet e Kuvendit dhe sistemin normativ; ii. *nga ana substanciale*, ai nuk garanton vlerën themelore të identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, pasi organet shtetërore nuk ruajnë rolin parësor në administrimin e Parkut të Butrintit.

i. Për cenimin e funksioneve të Kuvendit dhe të sistemit normativ

3. Lidhur me rolin dhe funksionet e Kuvendit, Gjykata ka pohuar se demokracia kushtetuese e vendosur në Kushtetutë, bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është një nga organet e autoritetit të shtetit, kompetencat e të cilit dhe, për pasojë, sfera e veprimtarisë së tij, është përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Kuvendi gëzon, brenda këtyre limiteve, një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien. Brenda kësaj sfere, shkalla e autonomisë së Kuvendit është më e madhe se në sfera të tjera të kompetencave të tij, për shkak të faktit, se ai është organi ligjvënës i shtetit (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese Kuvendi kryen funksione legislative, kontrolluese,

emëruese dhe buxhetore. Në rastin në gjykim, është e nevojshme analiza e funksionit legjislativ, që ka të bëjë me miratimin e ligjeve dhe i funksionit kontrollues. Ky i fundit, siç ka theksuar jurisprudenca kushtetuese, është i rëndësishëm në një shoqëri demokratike sepse ai materializohet pikërisht në rolin e deputetëve, që, nga njëra anë, miratojnë ligjet dhe, nga ana tjetër, ushtrojnë kontrollin mbi pushtetet e tjera deri në atë masë që ky pushtet zbatohet. Në këtë drejtim, *kontrolli parlamentar* nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t’u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, sipas rasteve konkrete. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kontrolli, krijohet mundësia e kontrollit publik të funksionimit të administratës shtetërore (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Kuvendi me ligjin nr. 50/2022 ka miratuar Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Ligji, në pjesën hyrëse, tregon si bazë juridike të miratimit nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018.

6. Neni 83, pika 1, i Kushtetutës është pjesë e kreut IV, që i dedikohet procesit ligjvënës. Në zbatim të kësaj dispozite, rezulton se ligji nr. 50/2022 është votuar në Kuvend tre herë: në parim, nën për nen dhe në tërësi. Duke iu referuar dokumenteve parlamentare, ligji është miratuar në Kuvend në datën 23.5.2022, pasi ishte diskutuar më parë në katër komisione parlamentare (Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, si dhe Komisioni i Ligjeve, Komisioni për Edukimin dhe Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e komisioneve për dhënie mendimi). Pas miratimit të tij, Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13703, datë 20.6.2022, ka ushtruar veton pezulluese ndaj ligjit nr. 50/2022, por Kuvendi në datën 14.7.2022, ka vendosur rrëzimin e dekretit, duke e miratuar përfundimisht ligjin. Në vijim, ligji është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 29.7.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë më pas.

7. Ndërsa neni 172, pika 5, i ligjit nr. 27/2018, që gjithashtu ka shërbyer si bazë juridike për miratimin



e ligjit nr. 55/2022, parashikon se “*Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin, sipas këtij neni. Kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale, dhe miratimit të saj në Kuvend, në rastet e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale, sipas parashikimeve të këtij ligji...*”. Miratimi në Kuvend i marrëveshjeve të administrimit të pasurive kulturore me rëndësi universale është tregues i qartë i rëndësisë publike që këto lloj pasurish paraqesin, të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me identitetin dhe trashëgiminë kulturore, të klasifikuara nga neni 3 i Kushtetutës ndër vlerat themelore që shteti ka për detyrë t’i respektojë dhe mbrojtë. Megjithatë, detyrimi ligjor për miratimin e këtyre lloj marrëveshjeve në Kuvend nuk duhet interpretuar, siç ka ndodhur në rastin konkret, se Kuvendi duhet të vërë në lëvizje procesin legjislativ dhe në përfundim të nxjerrë një ligj, pra të ushtrojë funksion legjislativ. Ky përfundim bazohet në tri arsytet themelore, të shpjeguara në vijim.

8. *Së pari*, në rastin e miratimit të kontratave administrative të tilla, Kuvendi duhet të ndërhyjë për të ushtruar funksionin kontrollues ndaj pushtetit ekzekutiv, për shkak të interesit të lartë publik që vihet në diskutim në procesin e respektimit dhe mbrojtjes së pasurive të identitetit dhe trashëgimisë kombëtare. Pa u zhveshur nga funksioni i tij kryesor, ai i ligjbërjes, Kuvendi ka të drejtën, gjithashtu, të miratojë edhe akte të tjera me natyrë juridike që ndjekin qëllime të ndryshme nga ai i rregullimit normativ, siç janë vendimet, të cilat janë të përshtatshme për të realizuar funksionin kontrollues. Në të kundërt, praktika e nxjerrjes së ligjeve përmes procedurës parlamentare ligjvënëse, siç ka ndodhur në rastin konkret, për të ushtruar funksion kontrollues, jo vetëm që deformon funksionin ligjvënës të Kuvendit, por e largon atë nga funksioni kontrollues në një republikë parlamentare.

9. *Së dyti*, miratimi i kontratave administrative me ligj, që duket se është një praktikë që po përdoret nga Kuvendi edhe në raste të tjera, në fakt denatyrton sistemin normativ të vendit, sepse një ligj i tillë merr tiparet e aktit individual, ai zbatohet për një marrëdhënie juridike të caktuar, ndaj subjekteve të individualizuara dhe shtron në zbatimin e tij. Një ligj i tillë i mungojnë karakteristikat e aktit normativ – ai është pa përmbajtje, nuk rregullon

situata dhe sjellje në mënyrë të përgjithshme. Në këtë mënyrë, ky lloj ligji nuk lejon as interpretimin e normave të tij, proces që kryhet gjatë zbatimit të normave me karakter të përgjithshëm. Për këtë arsye, një akt miratues i Kuvendit, që emërtohet ligj dhe që vjen si rezultat i procedurës parlamentare ligjvënëse, është e pamundur që, për nga natyra e tij, të bëhet pjesë e sistemit normativ dhe të renditet në piramidën e akteve normative, sipas neneve 4 dhe 116 të Kushtetutës, duke u shndërruar, për pasojë, në një akt të pushtetit publik jashtë nomenklature.

10. *Së treti*, qasja e Kuvendit për miratimin me ligj të Marrëveshjes së Administrimit, përmes procedurës parlamentare ligjvënëse, deformon edhe procedurat e kontrollit gjyqësor të saj, si një akt të vullnetit të palëve. Kështu, për sa kohë që marrëveshja nuk përbën akt normativ, veshja e saj me ligj e përjashton nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ndërsa Gjykatën e vendos në situatën që të pranojë në juridiksionin e saj kontrollin e akteve me natyrë individuale. Një qasje e tillë nuk përputhet me parimin e shtetit të së drejtës, i cili imponon kërkesën që rendi juridik të ketë një sistem të plotë dhe të qartë ankimesh dhe procedurash gjyqësore, të cilat bëjnë të mundur që aktet e nxjerra nga organet e pushtetit publik t’i nënshtrohen kontrollit të përpunshmërisë me Kushtetutën dhe aktet e tjera të sistemit normativ.

11. Në përmbledhje të arsyeve të mësipërme dhe bazuar në nenet 3, 4, 81–85, 116 dhe 131, shkronja “a”, të Kushtetutës, vlerësoj se ligji nr. 50/2022 është i papajtueshëm me Kushtetutën në aspektin formal, për sa kohë që Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me kompetencat dhe procedurën parlamentare ligjvënëse.

ii. Për cenimin e identitetit dhe të trashëgimisë kombëtare

12. Identiteti kombëtar dhe kultura janë përmendur shprehimisht në Preambulën e Kushtetutës, ku përcaktohet: “*Ne, populli i Shqipërisë (...) me zotimin për (...) prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën (...) me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar...*”. Gjithashtu, ai, së bashku me trashëgiminë kombëtare, garantohet edhe në nenin 3 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet, ndër të tjera se *identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojtë*. Gjykata ka pohuar se identiteti kombëtar ka të bëjë me veçoritë ose tiparet dhe përkatësinë në to të një bashkimi njerëzish në një komb ose në një shtet,



ashtu edhe simbolet dalluese të një shteti apo kombi (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përcakton një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkella e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues (*shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se bazat (vlerat themelore) e përcaktuara në nenin 3 të Kushtetutës, ku përfshihen edhe identiteti, edhe trashëgimia kombëtare, shërbejnë për të interpretuar normat kushtetuese dhe veprimtarinë e organeve shtetërore, ndërsa parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të saj, shërben për të përvijuar dhe kontrolluar veprimtarinë e këtyre organeve (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kushtetuta në nenin 3 ka përcaktuar se identiteti dhe trashëgimia kombëtare përbën një prej vlerave themelore, të cilën shteti ka detyrë ta respektojë dhe mbrojë. Po në të njëjtën linjë, edhe Konventa e Parisit, që është pjesë e rendit të brendshëm juridik, në nenin 4 të saj parashikon se detyra e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit të brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të referuar në nenet 1 dhe 2 të saj, që ndodhet në territorin e një shteti palë, i përket, në radhë të parë, atij shteti. Neni 5 i konventës përcakton veprimet që shtetet duhet të marrin për të garantuar marrjen e masave efektive dhe aktive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tyre.

15. Shumica pasi ka vlerësuar, fillimisht, se skema e administrimit indirekt sipas ligjit nr. 27/2018 është e lejueshme nga neni 3 i Kushtetutës dhe parashikimet e Konventës së Parisit, ka arritur në përfundimin se Marrëveshja e Administrimit garanton rolin parësor të shtetit, pasi nuk lejon kalimin e pronësisë mbi pasurinë universale. Sipas shumicës, të drejtat dhe kompetencat që i janë dhënë

FMB-së nuk tejkalojnë ato të një administrimi të zakonshëm të pasurisë dhe janë me natyrë administrative (menaxhuese), ndërkohë që shteti vijon të ruajë atributet e tij sovranë, për sa kohë që jo vetëm ruan pronësinë mbi këtë pasuri, por ushtron edhe të drejtat dhe kompetencat e tij përmes administrimit indirekt të Parkut të Butrintit (*shih paragrafët 90, 96 dhe 101 të vendimit*). Në thelb, shumica ka vlerësuar se thjesht dhe vetëm kalimi i një pasurie kombëtare me vlera universale në administrim të një treti, nuk është i mjaftueshëm, në aspektin kushtetues, për të vënë në dyshim rolin parësor të shtetit.

16. Ndaj qëndrim të ndryshëm me shumicën, pasi vlerësoj se roli parësor i shtetit nuk është garantuar në rastin konkret për këto dy arsye: *së pari*, administrimi i pasurisë kombëtare me vlera universale është fragmentarizuar, që sjell rrezik të qenësishëm në konservimin e integruar të saj; *së dyti*, për një pjesë ai është lejuar të kryhet nga një entitet i së drejtës private.

17. Është e qartë se fragmentarizimi i administrimit të pasurisë krijon pasiguri në përmbushjen e përgjegjësisë dhe të roleve në procesin e konservimit, që prek cilësinë dhe eficientësinë e procesit të konservimit. Nga pikëpamja faktike, fragmentarizimi i administrimit të Parkut Kombëtar të Butrintit u vërtetua gjatë këtij gjykimi kushtetues nga gjetjet dhe rekomandimet e raportit të misionit të përbashkët këshillimor UNESCO/ICOMOS të vitit 2022. Në parantezë, më duhet të theksoj shqetësimin për vështirësinë e Gjykatës për marrjen në shqyrtim të këtij raporti, në kushtet kur ai jo vetëm që nuk u paraqit nga Këshilli i Ministrave edhe pse u kërkuar disa herë nga kërkuesi, por madje u pengua paraqitja e tij nga subjektet e interesuara duke u bërë shkak për shtyrjen disa herë të seancës plenare. Kjo sjellje, në vlerësimin tim, krijon dyshimin e arsyeshëm se autoritetet publike, të cilat u provua se ishin informuar dhe u ishte komunikuar ky dokument në kohën e duhur, jo vetëm që kanë qenë në dijeni të problematikave të modelit të administrimit të Parkut të Butrintit, por edhe se ato kanë kuptuar pasojat antikushtetuese të tyre.

18. Për sa i përket përmbajtjes së këtij raporti, ai ka evidentuar një sërë problematikash referuar modelit të administrimit të Parkut të Butrintit, duke ngritur shqetësime edhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të misioneve të



UNESCO/ICOMOS, duke evidentuar dhe theksuar rolin që duhet të kryejë shteti përmes ministrisë përgjegjëse për administrimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit. Në mënyrë të përmbledhur, këto problematika, që paraqesin rëndësi për gjykimin kushtetues për sa kohë lidhen me rolin parësor të shtetit, janë: i. parcelizimi i pasurisë së trashëgimisë botërore dhe nevoja që Ministria e Kulturës të mbajë në mbikëqyrje të gjithë pasurinë dhe jo një pjesë të saj (*faqet 9 dhe 107*), modifikimet e kufijve të pasurisë dhe dobësimi i funksionit të zonës buferike (*faqe 69*) dhe mungesa e arsyeve për të mos marrë në konsideratë menaxhimin e të gjithë pasurisë nga një autoritet i vetëm (*faqet 32–33*); ii. mungesa e garancive për zbatimin e një plani të integruar menaxhimi (*faqe 8*); iii. vulnerabiliteti i Vlerave të Jashtëzakonshme Universale, mungesa e menaxhimit të fokusuar në terren dhe mostrajtimi i çështjeve urgjente të konservimit, përfshirë paqartësinë e Bordit të Drejtorëve për kërkesat për menaxhimin dhe mbrojtjen në kontekstin e trashëgimisë botërore (*faqet 37–39*); dhe iv. nevoja për një ekip menaxhimi të integruar të natyrës/kulturës që të punojë në nivel vendor për të mbikëqyrur të gjitha aspektet e menaxhimit të zonës dhe mbrojtjes së Vlerave të Jashtëzakonshme Universale së pasurisë (*faqe 107*), si dhe për një mekanizëm për bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit dhe planifikimin e menaxhimit në terren (*faqe 57*).

19. Për sa i takon administrimit të pasurisë kombëtare nga një entitet i së drejtës private, duhet vënë në dukje se edhe pse shteti merr pjesë në të përmes përfaqësimit në Bordin e Drejtorëve, kjo nuk ndryshon as statusin, as të drejtat e FMB-së. Administrimi i një pasurie kombëtare përmes krijimit të një subjekti të së drejtës private nuk garanton urdhërimin kushtetues dhe as detyrimet e marra përsipër ndërkombëtarisht nga shteti shqiptar. Jo pa qëllim, në nenin 17 të saj, Konventa e Parisit ka parashikuar krijimin e fondacioneve vetëm me qëllimin e mbledhjes së donacioneve dhe financimeve, duke pasur në vëmendje jo vetëm shpenzimet dhe kostot e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e ruajtjen e këtyre pasurive por edhe me synimin për të thithur të ardhura edhe nga burime të tjera përveç atyre shtetërore. Në vlerësimin tim, modeli i zgjedhur në rastin konkret ka zhveshur shtetin nga kompetencat dhe tagrat e tij, duke i kaluar një subjekti të së drejtës

private ushtrimin e një funksioni publik siç është ai për mbrojtjen dhe konservimin e pasurive të trashëgimisë kulturore me vlerë universale pjesë e identitetit tonë kombëtar. Fondacioni i krijuar sipas Marrëveshjes së Administrimit ushtron veprimtarinë sipas së drejtës private ndërkohë që as ligji nr. 27/2018, as marrëveshja nuk i njohin ndonjë kompetencë, procedurë ose të drejtë sipas së drejtës publike.

20. Në këtë drejtim, më duhet të theksoj se nisma dhe përgjegjësia private luan rol thelbësor në sistemin e ekonomisë së tregut që ka vendosur Kushtetuta, ndaj sipas nenit 11 të saj prona private dhe publike mbrohen njëllëj. Rëndësia e nismës dhe përgjegjësisë private konfirmohet edhe nga neni 59 i Kushtetutës, ku parashikohet se ajo është burim plotësues i kompetencave dhe mjeteve që disponon shteti në përmbushjen e objektivave sociale. Megjithatë kur flitet për identitetin dhe trashëgiminë kombëtare, bëhet i zbatueshëm neni 3 i Kushtetutës, i cili përgjegjësinë për respektimin dhe mbrojtjen e vlerave themelore ia ngarkon shtetit. Kështu, duke iu referuar pikërisht vlerave të tjera themelore të listuara shprehimisht në këtë dispozitë kushtetuese, siç janë pavarësia, tërësia territoriale, dinjiteti, të drejtat dhe liritë themelore, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa e mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat, është e pamundur të mendohet që përgjegjësia e shtetit për mbrojtjen e tyre t'i kalojë nismës dhe përgjegjësisë private. Në këtë pikëpamje, respektimi dhe mbrojtja e identitetit dhe trashëgimisë kombëtare është dhe duhet të jetë përgjegjësi publike, që përmbushet nga organet e pushtetit publik. Ky i fundit, në ndryshim nga nisma dhe përgjegjësia private, e merr legjitimitetin e tij nga mekanizmat e demokracisë përfaqësuese dhe njëkohësisht është subjekt kontrolli i vazhdueshëm nga qytetarët, të cilëve iu përket sovraniteti në Republikën e Shqipërisë.

21. Në vlerësimin tim asnjë konsideratë nuk është e mjaftueshme për delegimin e këtij funksioni të shtetit sipas të drejtës publike në një entitet që vepron sipas të drejtës private, duke mos përmbushur rolin parësor të shtetit. Gjykata ka theksuar se mungesa e fondeve financiare nuk përlligj interesin publik të miratimit të një ligji (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Konventa e Parisit parashikon në nenin 4 të saj se shteti duhet të bëjë të gjitha



përpjekjet për përmbushjen e detyrimit për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transmetimin të brezave të ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, deri në fund të burimeve të tij dhe, atje ku është e përshtatshme, me ndonjë ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në veçanti, financiare, artistike, shkencore dhe teknike.

22. Në këtë kuptim mungesa e fondeve buxhetore nuk përlligj këtë model administrimi për sa kohë që nuk u arrit të provohej nga subjektet e interesuara se forma direkte e administrimit nuk do të sillte pasojat e pritshme dhe të dëshiruara dhe se krijimi i FMB-së vetëm me qëllimin e mbledhjes së fondeve dhe donacioneve, sipas nenit 17 të Konventës së Parisit, nuk do të ishte një model i suksesshëm në drejtim të rezultatit të pritshëm.

23. Në përmbledhje të arsyeve të mësipërme, çmohet se ligji nr. 50/2022 është i papajtuështëm me Kushtetutën në aspektin formal, për sa kohë ka cenuar funksionet e Kuvendit dhe të sistemit normativ dhe atë substancial, për sa kohë nuk ruan dhe garanton rolin parësor të shtetit në mbrojtjen e pasurisë kombëtare, Parkut Kombëtar të Butrintit. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të kishte pranuar kërkesën dhe të vendoste shfuqizimin e ligjit objekt kërkesë.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Elsa Toska, në çështjen me kërkesë jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit dhe objekt: “*Shfuqizimi i ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, ‘Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit’, si i papajtuështëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, kam votuar për pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe shfuqizimin e nenit 1, të ligjit nr. 50/2022, ndaj në vijim do të paraqes argumentet e detajuara për këtë qëndrim, duke filluar me juridiksionin kushtetues.

A. Për juridiksionin kushtetues të lidhur me ligjin nr. 50/2022

2. Në lidhje me juridiksionin kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje, Gjykata është vënë në lëvizje për ushtrimin e kompetencës së parashikuar

në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës që është zbërthyer në nenin 51, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit ajo shqyrton përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative, formën e tyre, si dhe procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.

3. Kërkuesi ka kundërshtuar ligjin nr. 50/2022, me të cilin Kuvendi ka miratuar marrëveshjen për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit. Po kështu nga përmbajtja e kërkesës rezulton se kërkuesi kundërshton edhe marrëveshjen e administrimit, duke e konsideruar si pjesë përmbajtësore të ligjit nr. 50/2022.

4. Konkretisht, ligji objekt kundërshtimi ka vetëm dy nene, nenin 1, i cili parashikon miratimin e marrëveshjes dhe nenin 2, i cili parashikon hyrjen në fuqi të ligjit (*referuar në këtë MENDIM PAKICE si “ligj miratues”*). Ndërsa, teksti i marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, i është bashkëlidhur ligjit.

5. Shumica, për të argumentuar qëndrimin e saj për juridiksionin dhe mbi marrëveshjen e administrimit ka analizuar se: “(...) edhe pse në rastin konkret jemi para një përjashtimi nga rregulli i natyrës së përgjithshme të aktit të miratuar nga Kuvendi, natyra e pasurisë kulturore kombëtare në fjalë përcakton edhe interesin publik në rastin konkret, i cili në vlerësimin e ligjvënës, është i tillë që nuk mund të vlerësohet apo përcaktohet nga organe të tjera të pushtetit publik. Sipas saj, edhe pse tipikisht nuk jemi para një akti me karakter të përgjithshëm, që ka normuar rregulla të përgjithshme të sjelljeve, marrëveshja që i bashkëlidhet ligjit nr. 50/2022 ka marrë, për këtë shkak, veshje formale me ligj” (*shih paragrafin 44 të vendimit*). Shumica ka arritur në përfundimin se gjykata ka juridiksion për kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve objekt kërkesë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, për sa kohë që jo vetëm që marrëveshja e miratuar me ligjin nr. 50/2022 dhe që i bashkëlidhet atij për këtë shkak ka marrë veshje formale me ligj, por edhe bazuar në natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në



kërkesë, që janë elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues (*shih paragrafin 46 të vendimit*). Në vijim, me qëllim analizën e themelit të pretendimeve, shumica ka ushtruar kontroll kushtetues edhe mbi marrëveshjen bashkëlidhur ligjit, për të vlerësuar nëse vetë Marrëveshja e Administrimit respekton rolin parësor të shtetit në këtë administrim indirekt të trashëgimisë kulturore, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit (*shih paragrafët 91 e vijues të vendimit*).

6. Për sa më lart, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se shumica edhe pse është shprehur se gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e pretendimeve të parashtruara në kërkesë në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, duke shqyrtuar parashikimet e marrëveshjes në fakt ka ushtruar kontroll ndaj një kontrate *tipike* administrative dhe duket se ka konsideruar përmbajtjen e marrëveshjes së administrimit si përmbajtje të ligjit.

7. Në vlerësimin tim, në ndryshim nga sa ka arsyetuar shumica, ligji miratues nuk përthith edhe përmbajtjen e neneve të kontratës, duke i konsideruar këto të fundit si pjesë përmbajtësore të ligjit, ndaj në këtë kuptim nuk mund të konsiderohet kontrolli kushtetues ndaj neneve të marrëveshjes si kontroll ndaj ligjit miratues nr. 50/2022. Pavarësisht se marrëveshja e lidhur mes palëve është miratuar me ligj, ajo nuk bëhet pjesë e ligjit, për rrjedhojë nuk mund të përfshihet në juridiksionin kushtetues vetëm për shkak të formës me të cilën ajo hyn në fuqi dhe fillon të prodhojë efekte mes palëve kontraktuese. Shqyrtimi i marrëveshjes së administrimit, si pjesë përmbajtësore e ligjit, nga Gjykata Kushtetuese, krijon një denatyalizim të kontrollit kushtetues mbi kontratat të cilat në thelb janë marrëveshje mes palëve kontraktuese, dhe për shqyrtimin e të cilave ekzistojnë tre shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, sipas nenit 135, pika 1 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, as vetë Gjykata Kushtetuese nuk përjashtohet nga respektimi i ndarjes së juridiksioneve. Po në këtë drejtim, ruajtja e balancës mes kreativitetit gjyqësor dhe qëllimit të parashikimeve kushtetuese është detyrim i Gjykatës Kushtetuese, të cilin ajo e ka shprehur edhe përmes *parimit të vetëpërmbajtjes gjyqësore, (judicial self restraint)*.

8. Për rrjedhojë, objekt i kontrollit kushtetues në rastin konkret është ligji miratues nr. 50/2022, pra forma dhe përmbajtja e dispozitave të tij, dhe jo marrëveshja për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë

e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës.

9. Për sa i përket legjitimitit, kërkuesi legjitimohet *ratione personae* vetëm për ligjin nr. 50/2022, ndryshe nga shumica, e cila e legjitimon për aktet objekt kërkesë, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar për kundërshtimin e ligjit. Ndërsa, për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi, edhe pse nuk i ka ngritur pretendimet në kontekst të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, për shkak të miratimit të marrëveshjes së administrimit me ligj miratues, nisur nga qëndrimi që kam mbajtur lidhur me juridiksionin e Gjykatës vetëm për ligjin nr. 50/2022, do të analizoj në themel cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve e për rrjedhojë edhe shtetin e së drejtës.

B. Për pajtueshmërinë e ligjit nr. 50/2022, me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe shtetit të së drejtës

10. Parimi i shtetit të së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës sonë, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues (*shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, ndërvepron edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të përcaktuar nga neni 7 i Kushtetutës, që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve dhe synon të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi ose të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Nëpërmjet këtij parimi kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që u përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 24, datë 9.6.2011; nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Po sipas nenit 4, pika 1, të Kushtetutës, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë



kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2011; nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Piramida e akteve normative, e parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 3, datë 20.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nën dritën e këtyre standardeve kushtetuese të sipërpërmendura, do të ndalem në analizën e rastit konkret, duke iu përgjigjur pyetjes kryesore kushtetuese, nëse Kuvendi duhej ta miratonte me ligj marrëveshjen objekt kundërshtimi, pra nëse kjo formë e përzgjedhur, bie ndesh me parimet dhe parashikimet kushtetuese.

13. Ligji nr. 50/2022 në thelb ka miratuar një kontratë administrative mes dy palëve, nga njëra anë një organ publik (Ministria e Kulturës) dhe nga ana tjetër një subjekt i së drejtës private (FMB-ja). Kjo kontratë, si shprehje e vullnetit të dy palëve të saj, ka për objekt dhënien e shërbimeve publike që lidhen me administrimin e pasurisë kulturore të Parkut të Butrintit. Përmes kësaj kontrate shteti transferon disa të drejta një subjekti privat (fondacioni), ndërkohë që ky i fundit ushtron disa kompetenca në kuptim të modelit të administrimit indirekt të pasurisë në fjalë. Për rrjedhojë, kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet konkrete të secilës palë dhe ka për objekt rregullimin e situatës juridike të një pasurie të identifikuar, Parkut Kombëtar të Butrintit. Nisur nga objekti i kësaj marrëveshjeje, ajo përfshihet në ato akte që kanë të bëjnë me menaxhimin e një pasurie publike, përcaktimin e modelit të përzgjedhur dhe modalitetet specifike të dakordësuara mes palëve.

14. Për sa më lart, qëllimi thelbësor i një marrëveshjeje (kontrate) është të vendosë raporte juridike mes palëve, të drejta dhe detyrime, si dhe synon të prodhojë efekte vetëm për sa u takon këtyre palëve, ndërsa qëllimi i ligjëbërjes, në çfarëdo rendi kushtetues, nuk është të bëjë të vlefshme marrëveshje të lidhura mes organeve publike dhe personave juridikë të së drejtës private. Nga kjo perspektivë, miratimi i një marrëveshjeje (kontrate) me ligj nuk i korrespondon qëllimit kushtetues të veprimtarisë ligjëbërëse si veprimtari nëpërmjet së cilës ushtrohet pushteti legjislativ i shtetit.

15. Në këtë mënyrë, me miratimin me ligj të kësaj kontrate, Kuvendi ka tejkaluar kompetencat e tij në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës, duke cenuar parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Nga ana tjetër, pikërisht për këtë shkak, pra se marrëveshja është miratuar me ligj, duket se ky instrument i miratimit pengon edhe ushtrimin e plotë të kontrollit nga gjykatat administrative mbi (pa) vlefshmërinë e saj. Edhe nga seanca plenare rezultoi se për shkak të veshjes me ligj, këto lloj kontratash nuk kontrollohen në gjykata administrative. Subjekti i interesuar, Kuvendi, nuk arriti të sjellë asnjë rast para kësaj gjykate, shembuj ku kontrata administrative të miratuara me ligj të kontrolloheshin për (pa) vlefshmëri prej gjykatave të zakonshme, ndryshe nga kontratat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave për të cilat ka tashmë praktikë gjyqësore (*shih procesverbalet e seancës gjyqësore*). Në këtë aspekt, Kuvendi nuk provoi se praktika gjyqësore e gjykatave administrative kishte qëndrime të tilla, ku këto kontrata, edhe pse të miratuara me ligj, i nënshtroheshin kontrollit gjyqësor administrativ.

16. Në vlerësimin tim, natyra e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi nuk përjashton dhe nuk zhvendos juridiksionin gjyqësor për kontrollin e kontratave nga gjykatat e zakonshme në Gjykatën Kushtetuese, për sa kohë që në rastin konkret kontrolli i plotë i kontratës, edhe në lidhje me ato pretendime që kanë natyrë kushtetuese, pra identiteti kombëtar dhe trashëgimia kulturore, si dhe respektimi i detyrimeve që vijnë nga Konventa e Parisit, i përket juridiksionit gjyqësor administrativ, që bazuar në parimin e kushtetutshmërisë dhe hierarkisë së normave juridike, ka pushtetin kushtetues për të verifikuar dhe kontrolluar pajtueshmërinë e marrëveshjes me këto parime kushtetuese dhe konventore, për të vendosur për



(pa) vlefshmërinë e saj. Në kuptim të nenit 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, gjykata administrative ka në kompetencë lëndore shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga (...) kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik.

17. Në vështrim të sa më sipër, nëse një ligj miratues ka efekt dhe synim kufizimin e kontrollit gjyqësor të aktit të miratuar, kjo do të passillte cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe të së drejtës për ankim efektiv nga kushdo palë e interesuar për ankimin gjyqësor.

18. Në këtë kontekst, referuar çështjes konkrete, edhe pse në nenin 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018 është parashikuar se në rastet kur administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore me rëndësi universale kryhet nga persona juridikë jofitimprurës, marrëveshja e lidhur nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me fondacionin e posaçëm për administrimin, i nënshtrohet miratimit në Kuvend, kjo dispozitë vë në diskutim mënyrën e ushtrimit të kompetencave legjislative nga Kuvendi për një kategori të caktuar marrëveshjesh ose kontratash, ku referuar legjislacionit përkatës Kuvendi mund të ushtrojë kompetenca administrative me ligj miratues, duke e shndërruar këtë *modus operandi* në model legjislativ. Ashtu sikundër Gjykata ka theksuar, nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse (*shih vendimet nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 29, datë 30.6.2011; nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës*). Ndaj, në vlerësimin tim, kjo çështje do të duhej të shërbente edhe me qëllimin që praktika legjislative të rishikohej për të ardhmen, në mënyrë që të ndryshohet modeli i miratimit të marrëveshjeve/kontratave me ligj.

19. Po në këtë drejtim, nuk pajtohem me shumicën për sa i përket argumentit se qëllimi i parashikimit përmes ligjit nr. 27/2018 të ndërhyrjes së Kuvendit në këtë rast, si përfaqësues i vullnetit të popullit, lidhet me detyrimin e shtetit, të sanksionuar në Kushtetutë dhe Konventën e Parisit, për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre vlerave të pasurisë universale (*shih paragrafin 44 të vendimit*). Ky qëndrim

i shumicës duket se nuk merr në konsideratë parimin kushtetues të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Për më tepër, në vështrim të nenit 48/2, të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar, ku parashikohet se përjashtimisht kur ka lidhje midis objekti të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese, për sa kohë që neni 172, pika 5, i ligjit nr. 27/2018 ka lidhje me ligjin nr. 50/2022, atëherë dhe kjo dispozitë do duhej të vlerësohej në këtë kontekst.

20. Në përfundim, për të gjitha argumentet e lartpërmendura, vlerësoj se neni 1, i ligjit nr. 50/2022 që ka miratuar marrëveshjen e administrimit të nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit (kontratën e lidhur mes Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së) duhej shfuqizuar, për rrjedhojë kërkesa duhej pranuar pjesërisht.

Anëtare: Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes nr. 8 (Nj) 2022 që i përket kërkesës së subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 50/2022, datë 23.5.2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes. Në vlerësimin tim kërkesa është e bazuar, për shkak se ligji i kundërshtuar nuk garanton rolin parësor të shtetit në mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë kombëtare, ndaj duhej të ishte vendosur pranimi i saj dhe shfuqizimi i ligjit nr. 50/2022, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën e Parisit, ndaj, në vijim do të parashtoj argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

2. Kushtetuta në Preambulën e saj deklaron vetëdijen për historinë tonë, përgjegjësinë për të ardhmen ashtu edhe aspiratën e popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar. Në nenin 3 të saj Kushtetuta përcakton bazat e këtij shteti, të cilat



ai ka detyrën t'i respektojë dhe mbrojtë, ku përfshihen edhe identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, ndërsa në nenin 4 të saj sanksionon parimin e shtetit të së drejtës, një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

3. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se trashëgimia kulturore është pjesë e trashëgimisë së popullit, si dhe përbën kujtesën e prekshme dhe të paprekshme të asaj që njeriu ka krijuar (dhe vazhdon të krijojë) për pasardhësit e tij. Gjithashtu, ajo mund të quhet edhe dëshmi materiale që ka vlerën e civilizimit dhe bën pjesë në trashëgiminë kombëtare të një shteti, duke reflektuar jetën e komunitetit, historinë dhe identitetin e tij, si dhe lidhjen e së shkuarës me të tashmen e të ardhmen, si dhe konsiston në manifestime të jetës njerëzore, që dëshmojnë për vlerat, besimet, historinë dhe traditat e vendit dhe u japin qytetarëve ndjesinë e përkatësisë në një popull, që lidhet më pas me identitetin kombëtar. Trashëgimia kulturore përbën një formë të veçantë të shprehjes së kulturës së popullit dhe përfshin çdo gjë që konsiderohet vendimtare për identitetin e një shoqërie ose vendi. Prandaj çdo ankesë ndaj cenimit të këtyre të drejtave duhet të zgjidhet duke vendosur në balancë interesat e palëve të prekura me interesin e përgjithshëm të shoqërisë, duke marrë gjithmonë në konsideratë aspektet morale, historike, kulturore, kombëtare, financiare dhe ligjore të përfshira. Gjetja e këtyre zgjidhjeve duhet të konsistojë në shkëmbim informacioni, konsultim, dialog dhe bashkëpunim mes palëve të përfshira (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Detyrimi kushtetues për mbrojtjen dhe respektimin e identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare e kulturore ka të bëjë me marrjen e masave nga ana e ligjvënësit për mbrojtjen e tyre, ashtu dhe me zbatimin në praktikë nga institucionet përkatëse të procedurave ligjore (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Për garantimin e këtij parimi të gjitha organet, të parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t'i nënshtrohen parimit të

kushtetutshmërisë dhe atij të ligjshmërisë. Parimi i shtetit të së drejtës shërben për të përvijuar dhe kontrolluar veprimtarinë e organeve shtetërore, ndërsa bazat (vlerat themelore), ku përfshihen edhe identiteti e trashëgimia kombëtare, shërbejnë për të interpretuar normat kushtetuese dhe atë veprimtari (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Duke iu referuar përmbajtjes së Konventës së Parisit, të ratifikuar nga shteti shqiptar, që në kuptim të neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës renditet në hierarkinë e akteve normative pas Kushtetutës dhe përbën jo vetëm një akt të detyrueshëm për zbatim, por edhe parametër të kushtetutshmërisë së akteve të zakonshme ligjore, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, ajo ka përcaktuar në nenin 4 se i takon vetëm shtetit detyra e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit të brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij. Në këtë kuptim, i takon shtetit, që, për përmbushjen e këtij detyrimi, të bëjë gjithçka që mundet deri në fund të burimeve të tij dhe, atje ku është e përshtatshme, me ndonjë ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në veçanti, financiare, artistike, shkencore dhe teknike, të cilat mund të jetë në gjendje për t'i përfituar. Në vijim, neni 5 i Konventës parashikon se çfarë konsiderohen masa efikase dhe aktive që merren nga shtetet anëtare për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe konkretisht shteti duhet: a) të përshtatë një politikë të përgjithshme, e cila ka si synim t'i japë trashëgimisë kulturore dhe natyrore një funksion në jetën e komunitetit dhe të integrojë mbrojtjen e kësaj trashëgimie në programe të përgjithshme planifikuese; b) të ngrejë brenda territorit të tij, atje ku këto shërbime nuk ekzistojnë, një ose më shumë shërbime për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me një staf të përshtatshëm dhe që ka mundësitë për të kryer funksionet e veta; c) të zhvillojë studime shkencore dhe teknike, kërkime, si dhe të përgatisë metoda operative të atilla që do ta bënë shtetin të aftë për t'i u kundërvënë rreziqeve që kërcënojnë trashëgiminë e tij kulturore ose natyrore; d) të marrë masat e duhura ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të nevojshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e kësaj trashëgimie; e) të nxisë themelimin ose zhvillimin e qendrave kombëtare



dhe rajonale për trajnim në mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe të inkurajojë kërkime shkencore në këtë fushë.

6. Gjithashtu, në linjë me sa më sipër, edhe sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe, kur është e mundur, administrimi i saj kanë për qëllim, përveç ruajtjes së cilësisë së jetës, edhe kujdesin për burimet historike, kulturore dhe artistike të rajonit dhe banorëve të tij. Për rrjedhojë, ato kanë vlera thelbësore, mbrojtja dhe promovimi i të cilave u përket autoriteteve shtetërore (*shih Kozaciogly kundër Turqisë, 19 shkurt 2009, § 54 dhe Kristiana LTD kundër Lituanisë, 6 shkurt 2008, § 104*). Në këtë drejtim, autoritetet kombëtare gëzojnë një hapësirë vlerësimi në përcaktimin e interesit të përgjithshëm të shoqërisë (*shih Beyeler kundër Italisë, 5 janar 2000, § 112; Ruspoli Morenes kundër Spanjës, 28 nëntor 2001, § 39*).

7. Referuar analizës së mësipërme të përmbajtjes së neneve 3 dhe 4 të Kushtetutës dhe neneve 4 dhe 5 të Konventës së Parisit, detyra për mbrojtjen e identitetit dhe trashëgimisë kombëtare e kulturore, për identifikimin, konservimin, prezantimin dhe transmetimin e saj në të ardhmen, i takon në mënyrë të qartë dhe pa asnjë ekuivok vetëm shtetit. Për rrjedhojë, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën se këto parashikime “nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur formën se si ato ushtrohen, pra nuk parashikojnë ndonjë formë ekskluziviteti në administrimin e pasurive kulturore dhe natyrore dhe as nuk ndalojnë forma të ndryshme të mbrojtjes dhe konservimit... Edhe pse neni 17 i Konventës së Parisit parashikon se shtetet palë mund të inkurajojnë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose organizatave me qëllim fitimin e donacioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, kjo në vetvete është tregues se përfshirja e të tilla fondacioneve jo vetëm nuk përjashtohet, por inkurajohet në administrimin e pasurisë, për sa kohë që ruhet në çdo rast roli parësor i shtetit sipas kësaj konvente.” (*shih paragrafin 89 të vendimit*). Përkundër sa referon shumica, në vlerësimin tim këto parashikime kushtetuese dhe konventore kanë përcaktuar se ky rol parësor mund të ushtrohet vetëm nga shteti, edhe pse në forma të ndryshme dhe se është e palejueshme nga pikëpamja kushtetuese tjetërsimi ose delegimi i tyre në entitete jopublike që i përkasin së drejtës private. Për më tepër që Konventa e Parisit ka përcaktuar detyrimin e çdo shteti anëtare që për përmbushjen e këtij detyrimi të bëjë gjithçka që

mundet, madje deri në fund të burimeve të tij, të cilat janë njerëzore, materiale dhe financiare.

8. Në frymën dhe në përputhje me këto parashikime duket se është forma e administrimit direkt, e cila realizohet nëpërmjet strukturave organizative të specializuara në varësi të institucioneve shtetërore ose subjekteve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative, financiare dhe me personel të specializuar tekniko-shkencor, ose edhe në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike. Për rrjedhojë, qasja ime ndryshon nga ajo e shumicës edhe në lidhje me mënyrën se si shumica vlerëson jo vetëm formën e administrimit indirekt sipas ligjit nr. 27/2018 por edhe vetë rangun e të drejtave dhe kompetencave që i janë dhënë sipas Marrëveshjes së Administrimit subjektivit privat FMB-së.

9. Shumica, pasi ka analizuar të drejtat dhe kompetencat e FMB-së sipas Marrëveshjes së Administrimit ka arritur në përfundimin se “në çdo rast nuk tejkalojnë ato të një administrimi të zakonshëm të pasurisë dhe nuk përmbajnë elemente të kompetencave sovraane të shtetit në ushtrimin e funksionit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurisë dhe se marrëveshja nuk e zhvesh shtetin nga roli i tij parësor në drejtim të identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transferimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, por ruan dhe garanton këtë rol, i cili ushtrohet përmes formave të ndryshme të kontrollit të veprimtarisë së administrimit indirekt, për sa kohë që FMB-së nuk i është njohur ndonjë status i privilegjuar ligjor, duke iu nënshtuar ky entitet parashikimeve ligjore të zbatueshme, ashtu si çdo entitet tjetër i së drejtës.” (*shih paragrafët 96 dhe 98 të vendimit*).

10. Në ndryshim nga shumica, në vlerësimin tim të drejtat dhe kompetencat që i janë njohur FMB-së në Marrëveshjen e Administrimit të Parkut të Butrintit në thelb kanë zhveshur shtetin nga atributet e tij sovraane në drejtim të administrimit të pasurive me vlerë kombëtare dhe universale. Edhe pse Kuvendi ia ka nënshtuar një procesi parlamentar dhe debati politik këtë marrëveshje, ai nuk ka luajtur rolin e tij si sovran të përcaktuar nga Kushtetuta. Nuk përbën synimin tim në këtë rast që të ndalem në vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, për sa kohë ai është në rang hierarkik më poshtë se Kushtetuta dhe Konventa e Parisit dhe për sa kohë që parashikon forma të ndryshme administrimi që në rastin e pasurive universale kontrollohen nga Kuvendi. I takonte këtij të fundit të kryente rolin e



tij jo vetëm si garant i kushtetutshmërisë, që në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës është detyrim i çdo organi që i përket secilit prej tre pushteteve të shtetit, por edhe si garant i mbrojtjes së rolit parësor të shtetit në ushtrimin e këtyre kompetencave sovrane. Ky është qëllimi se përse ligji nr. 27/2018 ka parashikuar Kuvendin në këtë proces dhe rol. Në këtë kuptim, Kuvendi kishte detyrimin që të zbatonte drejtpërdrejt Kushtetutën dhe parashikimet konventore, duke zbatuar në çdo rast aktet me fuqi më të lartë ligjore.

11. Siç vërehet edhe nga aktet e paraqitura nga palët, si dhe nga deklaratimet e tyre në seancë plenare, i vetmi justifikim i sjellë para Gjykatës për miratimin e këtij modeli administrimi të Parkut të Butrintit (administrimi indirekt) ka qenë se sistemi aktual i menaxhimit nuk ishte fleksibël. I pyetur në seancë plenare se përse nuk është arritur në konkluzionin se kjo nismë ishte e vetmja e mundshme dhe nëse ka pasur një studim paraprak të kryer nga vetë shteti ose rekomandime nga institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore botërore, përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave u përgjigj se kjo formë nuk ishte mënyra e vetme, por është zgjedhur për shkak të problematikave në menaxhim, e evidentuar edhe në të gjitha raportet e UNESCO-s ndër vite. Ndërkohë që nga subjektet e interesuara nuk u arrit të provohej, dhe kjo nuk rezultoi as nga aktet bashkëlidhur projektligjit, se kjo formë administrimi ishte e vetmja mënyrë e mundshme për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë kombëtare dhe se asnjë formë tjetër nuk do të realizonte qëllimin dhe detyrimin kushtetues.

12. Edhe sipas raportit të vitit 2022 të misionit të përbashkët të UNECSO/ICOMOS, përveç krijimit të FMB-së nuk janë paraqitur propozime të tjera për të garantuar zbatimin e PMI-së dhe po ashtu as që krijimi i fondacionit është forma e vetme për të përmbushur rekomandimet e misionëve të mëparshme të Komitetit të Trashëgimisë Botërore. Po sipas raportit, nga autoritetet kombëtare nuk është dhënë asnjë justifikim për të mos marrë në konsideratë një autoritet/fondacion të vetëm për të menaxhuar si pasurinë e trashëgimisë botërore, ashtu edhe zonën buferike *de facto*/Parkun Kombëtar (shih faqet 8, 32 dhe 33 të raportit).

13. Po kështu, edhe pse subjektet e interesuara paraqitën para Gjykatës disa modele të tjera menaxhimi të pasurive universale, duke i referuar ato si modele të ngjashme menaxhimi, në të vërtetë

në asnjërin prej tyre nuk ishte e mundur të identifikoheshin pika të njëjta apo të ngjashme. Referuar edhe modelit të Pallatit të Versajës, organi përgjegjës sipas atij modeli është nën mbikëqyrjen e Ministrisë franceze të Kulturës dhe Ministrisë së Buxhetit dhe referuar përbërjes së bordit ekzekutiv dhe komisioneve përkatëse, ato kanë në përbërje të tyre, në shumicë, funksionarë publikë, përfaqësues të ministrive dhe drejtorive përkatëse përgjegjëse, të muzeve, kuratorë, përfaqësues të organeve lokale, departamenteve të artit, kulturës etj.

14. Vlen gjithashtu të theksoj se subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, nuk argumentuan se përse modeli dhe organizimi i mëparshëm i Parkut të Butrintit nuk mund të përshtatej me modelin e administrimit direkt sipas ligjit nr. 27/2018 dhe se përse ai model nuk mund të ofronte ato garanci që janë konsideruar se mund t'i ofrojnë vetëm FMB-ja. Kjo, për më tepër, kur si në drejtim të “formulës” së partnerit strategjik të zgjedhur, si në drejtim të përbërjes së organeve të FMB-së, nuk provohet asnjë ekspertizë e atij niveli që mund të zbehte sadopak dyshimet në lidhje me mënyrën se si do të realizohet mbrojtja dhe konservimi i Parkut të Butrintit.

15. Referuar nenit 17 të Konventës së Parisit inkurajohet themelimi i fondacioneve kombëtare publike dhe private ose i organizatave me qëllim që të ftojnë donacione për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Sipas shumicës “edhe pse neni 17 i Konventës së Parisit parashikon se shtetet palë mund të inkurajojnë themelimin e fondacioneve kombëtare publike dhe private ose organizatave me qëllim ftimin e donacioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, kjo në vetvete është tregues se përfshirja e të tilla fondacioneve jo vetëm nuk përjashtohet, por inkurajohet në administrimin e pasurisë, për sa kohë që ruhet në çdo rast roli parësor i shtetit sipas kësaj konvente” (shih paragrafin 88 të vendimit). Në vlerësimin tim, në ndryshim nga shumica, edhe kjo dispozitë, ashtu si edhe nenet 4 dhe 5 të saj, në mënyrë të qartë dhe pa asnjë ekuivok përcakton se qëllimi i vetëm për ngritjen e fondacioneve publike ose private është ai për mbledhjen e fondeve, të cilat do të përdoren nga shteti, në shtesë të burimeve të tij, për administrimin e pasurisë.

16. Po sipas shumicës, “titulli i pronësisë i mbetet shtetit, ndërkohë që termat e administrimit dhe përdorimit të pasurisë në administrim janë në përputhje me destinacionin e tyre dhe përcaktohen brenda kufijve dhe qëllimit të marrëveshjes së lidhur mes palëve. Forma e kalimit në



administrim indirekt të Parkut të Butrintit një subjekti të së drejtës private, FMB-së, e cila është e lejueshme nga parashikimet kushtetuese dhe ato konventore, është realizuar në përputhje me parashikimet ligjore të miratuara në zbatim të atyre dispozitave dhe nuk prek ose nuk cenon rolin parësor të shtetit në këtë administrim.” (shih paragrafin 99 të vendimit).

17. Nën këtë analizë vërej se pika 4.1 e Marrëveshjes së Administrimit përcakton se Ministria e Kulturës i jep fondacionit të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për administrimin indirekt të pasurisë kulturore dhe të të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë marrëveshje. Ndërsa pika 4.5 e saj parashikon se ministria nuk do të mbartë ose do t'i cedojë ndonjë personi të tretë, në çfarëdo forme, me ose pa shpërblim, të drejtat e fondacionit ose ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje, përveç nëse në marrëveshje është përcaktuar ndryshe, madje pika 4.6 parashikon se ministria i jep FMB-së të drejtën reale për pasurinë kulturore të paluajtshme. Më tej, pika 5.2 e Marrëveshjes së Administrimit parashikon se ministria deklaron dhe garanton gëzimin e plotë dhe të qetë të pasurisë nga FMB-ja ndaj pretendimeve të palëve të treta, si dhe të pengojë çfarëdolloj tjetërsimi, apo dhënie në përdorim, apo administrim gjatë afatit të marrëveshjes dhe se nuk do të miratojë apo në çdo formë të pranojë ushtrimin e veprimtarive artistike, kulturore, tregtare apo çdo lloj aksesit të palëve të treta pa miratimin paraprak të FMB-së. Referuar pikës 7.1. ministria i jep FMB-së nga data e transferimit deri në përfundimin e afatit të zgjidhjes së parakohshme të marrëveshjes, këto të drejta për pasurinë: a) të drejtën për posedimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe gëzimin (por jo pronësinë) dhe të drejtën e administrimit pa asnjë barrë, detyrim apo kufizim, përveç atyre të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm, kjo marrëveshje dhe Protokoll i Bashkëpunimit; b) të drejtën për kalim mbi dhe nën, si edhe hyrjen dhe daljen nga dhe çdo vend të pasurisë kulturore të paluajtshme, pa ndërhyrje të panevojshme nga ndonjë palë e tretë për qëllimin e zbatimit të marrëveshjes.

18. Bazuar në parashikimet e mësipërme, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se titulli i pronësisë mbi pasurinë në fjalë është i vetmi tagër pronësie që i ka mbetur shtetit si pronar, pasi, në fakt, ai është zhveshur nga çdo tagër tjetër si i tillë dhe nuk ka asnjë të drejtë tjetër përveç titullit të kësaj pronësie

mbi pasurinë universale, ndërkohë që as Kushtetuta, as Konventa nuk e lejojnë një formë të tillë administrimi. Dhënia e të drejtave ekskluzive dhe reale për pasurinë kulturore të paluajtshme, që përfshijnë të drejtën e posedimit, gëzimit të qetë dhe të plotë nga FMB-ja, jo vetëm që shkojnë tej kufijve të administrimit për qëllime të ruajtjes dhe mbrojtjes, por në thelb përbëjnë zhveshje të shtetit jo vetëm nga tagrat e gëzimit të pronësisë, por edhe nga atributet e tij si sovran, duke mos lejuar asnjë ndërhyrje prej tij gjatë kohës që kjo marrëveshje do të jetë në fuqi dhe duke pasur FMB-ja të drejta të plota dhe ekskluzive që të veprojë dhe të vendosë në lidhje me çdo ndërhyrje nën veshjen e “tagrave të administrimit”.

19. Sipas marrëveshjes, “administrim” nënkupton të drejtat e fondacionit, përfshirë, por *pa u kufizuar në* përdorimin, shfrytëzimin, promovimin, të drejtën për të caktuar dhe mbledhur tarifat, çmimin e biletave, dhënien në përdorim në të gjitha format, në kuptim të KC-së dhe/ose të ligjit nr. 27/2018 të pasurisë kulturore, si dhe detyrimet, përfshirë, *por pa u kufizuar në*, mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e pasurisë kulturore, në përputhje me ligjin nr. 27/2018, planin e menaxhimit dhe këtë marrëveshje. Po sipas saj, “hulumtime arkeologjike” nënkupton vlerësimin e potencialit arkeologjik, vëzhgimin sipërfaqësor (sipas nocionit klasik, si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si p.sh. studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjeoradar etj.), sondazhet arkeologjike, gërmimin arkeologjik, monitorimin, konservimin, administrimin arkeologjik, si dhe përpilimin e dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimtarie, raporteve paraprake dhe përfundimtare deri në botimin e rezultateve. Kurse “punime” nënkupton të gjitha aktivitetet për planifikimin inxhinierik, ndërtimin dhe kolaudimin e qendrës së vizitorëve në përputhje me planin e zbatimit, ndërkohë që qendra e vizitorëve” nënkupton tërësinë e infrastrukturës së përbërë nga një ndërtesë për ofrimin e shërbimeve, informacionit dhe orientimeve për vizitorët, duke përfshirë *pa u kufizuar në*, rrethimet, parkimet dhe zyrat e stafit të parashikuara për t'u ndërtuar sipas planit të menaxhimit dhe planit të biznesit, me fonde të financuara nga fondacioni.

20. Referuar këtyre parashikimeve të Marrëveshjes së Administrimit është e qartë se kompetencat e FMB-së nuk ndalen në vetëm ato tagra që parashikohen në marrëveshje, madje nuk



kufizohen në to, por mund të shtrihen edhe në të drejta të tjera që as nuk përcaktohen dhe as nuk qartësohet se çfarë përfshijnë apo nënkuptojnë. Ky parashikim “*pa u kufizuar në*”, që e gjejmë në tekstin e marrëveshjes, përveçse i paqartë në lidhje me hapësirën në të cilën shtrihen këto të drejta dhe marzhet ku vepron FMB-ja, krijon premisa për veprime abuzive të fondacionit, për sa kohë që është lënë në diskrecionin e tij të vlerësorë e të kryejë edhe veprime të tjera nën justifikimin e gëzimit të tagrave të administrimit.

21. Edhe parashikimet e marrëveshjes për marrjen e lejeve dhe autorizimeve përkatëse nuk mund të qëndrojnë si argument kushtetues i shumicës, për sa kohë ato kanë të bëjnë me plotësimin e dokumentacionit sipas legjislacionit në fuqi, por nuk japin asnjë garanci në drejtim të kontrollit të vendimmarrjes së veprimtarisë së FMB-së në administrimin e pasurisë kombëtare. Asnjë autoritet shtetëror i autorizuar për dhënien e lejeve/licencave nuk ka ndonjë tagër në vlerësimin e administrimit dhe mënyrës së ushtrimit të të drejtave nga FMB-ja, por vetëm në drejtim të verifikimit të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur për këtë qëllim.

22. Nga ana tjetër, roli kontrollues i shtetit nuk garantohet as në drejtim të pjesëmarrjes së tij në fondacion dhe as në drejtim të rolit të Ministrisë së Kulturës sipas marrëveshjes. Përbërja e organeve drejtuese të FMB-së ka zhveshur tërësisht përfaqësimin e shtetit në këtë entitet. Jo vetëm që pjesëmarrja e shtetit është në numër të vogël (dy përfaqësues nga pesë të tillë, pra në pakicë edhe në vendimmarrje), duke e bërë rolin e tij të dobët dhe pa asnjë të drejtë vetoje, ku, për më tepër, vetëm njëri nga anëtarët përfaqësues në bord është me veshje publike, por ajo çka është më e rëndësishme, në organet e këtij fondacioni mungojnë tërësisht kapacitetet dhe ekspertët e fushës, profesorë ose studiues, çka minimalisht mund të kishte garantuar një lloj kontrolli të këtyre ekspertëve ndaj vendimmarrjes së FMB-së. Në thelb, kjo e fundit do të ushtrojë një veprimtari tregtare që nuk ka lidhje me administrimin dhe menaxhimin e vetë pasurisë kombëtare. Anëtarësia aktuale e FMB-së, për shkak të raportit të përfaqësimit, ka të drejtë të vendosë për çështjet e administrimit dhe menaxhimit edhe pa votat e përfaqësuesve të shtetit, ndaj ata e kanë të pamundur të përcaktojnë politikën e drejtimit ose administrimit të pasurisë kombëtare.

23. Neni 59 i Kushtetutës parashikon se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon edhe mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore. Ndërsa edhe ky parashikim kushtetues përcakton detyrimin e shtetit mbi sa më lart, në rastin konkret vlerësoj se shteti është “dorëzuar”, duke pranuar se nuk përmbush dot detyrimet e veta dhe duke i deleguar ato tek një entitet i së drejtës private, ku shteti edhe pse pjesëmarrës, nuk ka aspak rol dominues.

24. Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe konventore përgjegjësia e administrimit të pasurive të trashëgimisë kulturore i përket vetëm shtetit, i cili nuk ka asnjë të drejtë të kalojë administrimin e tyre fondacioneve ose OJF-ve, për sa kohë që sovranin nuk ia ka njohur dhe dhënë një të drejtë të tillë. Shtetit i takon marrja e të gjitha masave brenda burimeve të tij, duke kërkuar edhe ekspertizë e ndihmë ndërkombëtare apo duke përfshirë edhe fondacione publike ose private vetëm për mbledhjen e fondeve (*charity*), për të ruajtur dhe zhvilluar pasurinë kulturore. Parku i Butrintit është një pasuri kulturore e paluajtshme me vlera universale, që bën pjesë në listën e trashëgimisë kulturore të UNESCO-s dhe shteti duhet ta menaxhojë dhe administrojë duke siguruar ruajtjen e vlerave universale, përfshirë ruajtjen e kushteve të integritetit dhe autenticitetit të kësaj pasurie.

25. Sipas pikës 19.1 të Marrëveshjes së Administrimit “*fondacioni merr leje zhvillimore në zonat e rëndësishme kombëtare të trashëgimisë; lejen e ndërtimit; leje përfaqëse; leje për ndërhyrje në pasuritë kulturore, licenca për projektim, zbatim dhe qarkullim të pasurive të paluajtshme*”, pra FMB-ja ka edhe të drejtën për të ndërhyrë në pasuritë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme. Po kështu, parashikimet e marrëveshjes mbartin risk të shtuar edhe lidhur me nxjerrjen jashtë shtetit të pasurive kombëtare shqiptare (për shembull artefakte), çka rrezikon tjetërsimin (humbjen) e tyre dhe pse jo shitjen, në kushtet kur garant nuk është më shteti shqiptar. Sipas pikës 9.2 të marrëveshjes FMB-ja “*miraton planet vjetore të veprimtarive ekonomike, artistike, turistike dhe kërkimore*” dhe “*vendos veprimtari kërkimore*”, çka nënkupton, rrjedhimisht, se FMB-ja vendos dhe përcakton edhe qasjen për gërmimet e zbulimet që lidhen drejtpërdrejt për nga natyra dhe vlera që mbart pasuria Parku i Butrintit me identitetin kombëtar dhe territorin e Shqipërisë.



26. Në vlerësimin tim, në thelb, Marrëveshja e Administrimit e miratuar me ligjin nr. 50/2022 ka pasur për qëllim dhënien me koncesion të së drejtës së administrimit dhe menaxhimit të pasurive kulturore dhe natyrore ndaj një subjekti privat vetëm për përfitime ekonomiko-financiare. Parashikimet e saj e kanë vënë në pamundësi shtetin shqiptar të ushtrojë detyrimet dhe përgjegjësitë e tij sipas Kushtetutës dhe Konventës së Parisit, duke mbartur rrezikun që Parku i Butrintit, nënzonat e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e tij, të mos administrohet, ruhet, zhvillohet, konservohet, përmirësohet dhe shfrytëzohet, ndërkohë që për sa kam shprehur më sipër, qëllimi për të cilin është krijuar FMB-ja dhe mungesa e ekspertizës së anëtarëve të saj ngre dyshime edhe për ardhjen e pasojave të dëmshme dhe të parikthyeshme e të pariparueshme për shkak të vendimmarrjes në drejtim të administrimit dhe menaxhimit që do të kryhet sipas planeve të menaxhimit dhe të biznesit.

27. Thënë sa më sipër, në përfundim vlerësoj se ligji nr. 50/2022, për rrjedhojë Marrëveshja e Administrimit që është pjesë e tij, janë miratuar në kundërshtim me nenet 3, 4, 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, si dhe nenet 4, 5 dhe 17 të Konventës së Parisit për sa kohë që kanë deleguar të drejtat sovrane të shtetit ndaj një subjekti privat, edhe pse ato janë të padelegueshme dhe të patjetërsueshme, duke qenë kompetencë vetëm e shtetit menaxhimi dhe administrimi i pasurive kulturore kombëtare me vlerë universale dhe detyrë ekskluzive e tij ruajtja dhe mbrojtja e tyre, në rastin konkret Parku i Butrintit dhe zonat arkeologjike pjesë të tij.

28. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, vlerësoj se kërkesa duhej të ishte pranuar nga Gjykata duke shfuqizuar ligjin nr. 50/2022, për rrjedhojë Marrëveshjen e Administrimit që i bashkëlidhet atij, si në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën e Parisit.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes nr. 8 (Nj) 2022 që i përket kërkesës së subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 50/2022, datë

23.5.2022, “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, si të pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica si në drejtim të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje, ashtu edhe për sa i përket themelit të saj. Në vijim do të parashtroj edhe argumentet e mia mbi të cilat mbështes qëndrimin si gjyqtar në pakicë.

A. Për juridiksionin e Gjykatës

2. Për sa u përket akteve me natyrë normative, ashtu siç ka theksuar edhe shumica, natyra e përgjithshme e tyre është ndër tiparet tipike dhe thelbësore që i dallon nga aktet me natyrë individuale. Shumica, edhe pse nuk ka vënë në diskutim natyrën jonormative të vetë Marrëveshjes së Administrimit, palë të së cilës janë një institucion publik me personalitet juridik (Ministria e Kulturës) dhe një person juridik privat (FMB-ja), është shprehur se si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i natyrës së akteve normative, ligjvënësi ka zgjedhur të parashikojë në legjislationin e brendshëm modele të tilla që lejojnë Kuvendin të ndërhyjë për miratimin edhe të akteve që, pavarësisht se nuk normojnë rregulla të përgjithshme sjelljeje, mbartin në vetvete interes publik ose kombëtar. Nisur nga kjo premisë, ajo ka vlerësuar se edhe pse jemi para një përjashtimi nga rregulli i natyrës së përgjithshme të aktit të miratuar nga Kuvendi, natyra e pasurisë kulturore kombëtare në fjalë përcakton edhe interesin publik në rastin konkret, i cili, në vlerësimin e ligjvënësit, është i tillë që nuk mund të vlerësohet ose përcaktohet nga organe të tjera të pushtetit publik. Sipas shumicës, pavarësisht se tipikisht nuk jemi para një akti me karakter të përgjithshëm, që ka normuar rregulla të përgjithshme të sjelljeje, marrëveshja që i bashkëlidhet ligjit nr. 50/2022 ka marrë, për këtë shkak, veshje formale me ligj (*shih paragrafët 42 dhe 44 të vendimit*).

3. Më tej, shumica është ndalur edhe në natyrën e pretendimeve të parashtuara, duke i konsideruar ato si përcaktuese të juridiksionit të saj, edhe pse në rastin konkret kjo nuk ka asnjë relevancë, për sa kohë qëndrimi im kundër lidhet me aspektin formal dhe jo përmbajtësor të çështjes, pra vetëm me njohjen formalisht të natyrës normative të një akti siç është Marrëveshja e Administrimit.



4. Në rastin konkret, në vlerësimin tim, Gjykata duhej të kishte mbajtur të njëjtën qasje që ka mbajtur në rastin e shqyrtimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020, “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”. Në atë rast Gjykata ka vlerësuar se ligji ratifikues përmban vetëm një nen, ku shprehet për marrëveshjen që ratifikon dhe hyrjen e saj në fuqi, ndërkohë që teksti i marrëveshjes i bashkëlidhet dhe bëhet pjesë përbërëse e tij. Për rrjedhojë, statusi i marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nuk barazohet me atë të aktit juridik që i jep asaj efektivitet në rendin e brendshëm ligjor. Për sa kohë që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara për nga renditja e tyre në sistemin e brendshëm ligjor nuk barazohen me ligjet e zakonshme, për rrjedhojë edhe vetë ligji ratifikues është një akt juridik i mëvetshëm. Pavarësisht se marrëveshja ndërkombëtare i bashkëlidhet ligjit ratifikues dhe është pjesë përbërëse e tij, kjo nuk u jep dispozitave të saj karakterin juridik të normave të ligjit ratifikues. Anasjelltas, vetëm për shkak se akti ratifikues përmban bashkëlidhur edhe tekstin e marrëveshjes, duke e bërë pjesë të tij, ai nuk merr vlerën juridike të marrëveshjes ndërkombëtare. Ndaj akti për ratifikimin dhe vetë marrëveshja ndërkombëtare, miratimi i së cilës konfirmohet nga i pari, nuk janë i njëjti akt juridik (*shih vendimin nr. 36, datë 16.6.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Qasja e Gjykatës në atë rast nuk lidhet vetëm me natyrën e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe vendin që ajo zë në rendin juridik pas miratimit me ligj. Gjykata vlerësoi fillimisht se ajo ndodhej para dy akteve të ndryshme ligjore dhe për këtë shkak ato nuk merrnin natyrën dhe vlerën juridike të njëri-tjetrit. Në vijim, nisur nga kjo premisë, në atë çështje Gjykata arriti në përfundimin se ajo nuk shqyrton marrëveshjen ndërkombëtare, si akt i ndarë nga ligji, për shkak të ndalimit kushtetues që lejon ushtrimin e këtij kontrolli vetëm përpara ratifikimit të këtyre akteve me ligj.

6. Edhe referuar jurisprudencës kushtetuese për ushtrimin e kompetencës legjislativë nga Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve normative me fuqinë e ligjit, Gjykata ka vlerësuar se dispozitat e ligjit të konvertimit vlerësohen, në aspektin e kushtetutshmërisë së tyre, bashkë me ato të aktit

normativ. Gjykata nuk i ka konsideruar këto akte si një të vetëm, që përthithin njëri-tjetrin, por si akte të ndara, duke vlerësuar për secilin prej tyre respektimin e kriterëve të nenit 101 të Kushtetutës. Kjo qasje e Gjykatës lidhet me natyrën e aktit normativ me fuqinë e ligjit, i cili është ligj në kuptimin material të termit dhe në rast të miratimit nga ligjvënësi ai kthehet në ligj edhe në kuptimin formal. Ky është elementi përcaktues i juridiksionit kushtetues për kontrollin e kushtetutshmërisë të aktit normativ me fuqinë e ligjit, ashtu edhe të ligjit miratues të Kuvendit.

7. Po kështu, dua të sjell në vëmendje edhe rastin e ligjit nr. 37/2018, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””, ku juridiksioni kushtetues u vu në lëvizje në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës për sa kohë që parashikimet e kundërshtuara kishin të bënin me përmbajtjen e vetë ligjit, pra me vetë tekstin e atij ligji dhe jo ndonjë akti bashkëlidhur, pra të miratuar prej tij (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Edhe pse sipas nenit 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, miratimi i këtyre lloj marrëveshesh i përket Kuvendit, për shkak të rëndësisë universale të pasurisë, akti miratues ka si qëllim të vetëm bërjen efektive të marrëveshjes, duke përcaktuar momentin nga i cili fillojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Kuvendi, pavarësisht se ka kompetencën të miratojë ose jo marrëveshjen, nuk merr cilësinë e palës në të dhe, si i tillë, nuk është i autorizuar të ndërhyjë për të ndryshuar ose shuar këtë marrëdhënie. Dhënia e pëlqimit dhe shfaqja e vullnetit të Kuvendit nuk ndryshojnë natyrën e kësaj kontrate, për rrjedhojë nuk e bëjnë atë pjesë të rendit juridik normativ të brendshëm. Miratimi i marrëveshjes me ligj nga Kuvendi nuk sjell asnjë efekt në përmbajtjen e saj apo të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe efektet që prodhon për to. Ligji miratues nuk është gjë tjetër përveçse një formë ligjore e përcaktuar në mënyrë të posaçme për njohjen dhe dhënien e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara, që përfshihen në fushën e së drejtës publike, por edhe asaj private. Pavarësisht miratimit të saj me ligj, ky i fundit nuk i jep dispozitave të marrëveshjes karakter normativ, që është kriteri që përcakton juridiksionin kushtetues për kontrollin abstrakt të aktit.



9. Edhe referuar Marrëveshjes së Administrimit, sipas pikës 37.4 të saj ajo ose dispozita të saj mund të ndryshohen vetëm pas miratimit me shkrim të të dyja palëve dhe duke nënshkruar instrumentin përkatës (aneksin), që bëhet pjesë e pandarë dhe përbërëse vetëm pas miratimit dhe nënshkrimit prej tyre. Po kështu, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre, në rast se ato nuk zgjidhen me pajtim, palët kanë përcaktuar si kompetente juridiksionin gjyqësor të zakonshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, kurse në rastin e konflikteve që kanë për objekt të drejtat reale, kompetente është gjykata ku ndodhet pasuria kulturore e paluajtshme (pika 33.2). Edhe në këtë aspekt, vetë marrëveshja ka përcaktuar qartësisht juridiksionin e zakonshëm gjyqësor për kontrollin e saj, ndërkohë që qëndrimi i Gjykatës në rastin konkret ka bërë që ajo vetë, në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të marrë prerogativa të organeve gjyqësore, duke përjashtuar juridiksionin gjyqësor të zakonshëm për kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit dhe interpretimit të ligjit në rastin konkret, ashtu edhe të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga dispozitat e marrëveshjes ose çdo akti tjetër me natyrë individuale të dalë në zbatim apo të lidhur me të.

10. Për sa më sipër, në vlerësimin tim në rastin konkret jemi para dy akteve juridike të ndryshme, ndaj, për rrjedhojë, juridiksioni kushtetues vlerësohet dhe përcaktohet në lidhje me secilin nga këto akte. Ndërsa ligji miratues, ashtu si edhe çdo ligj tjetër, nga pikëpamja formale, përbën objekt të kontrollit të kësaj Gjykate, aktet bashkëlidhur atij, për sa kohë që nuk kanë natyrë normative, përjashtohen nga juridiksioni kushtetues. Fakti se akte me natyrë jonormative, siç është marrëveshja në fjalë, një akt vullneti mes palëve të saj, pra me natyrë të pastër individuale, miratohen me ligj të Kuvendit, nuk mjafton në aspektin kushtetues për t'u dhënë atyre karakter normativ. Vetëm ndërhyrja e Kuvendit përmes ligjit për miratimin e një akti individual nuk i transformon parashikimet e këtij të fundit në norma me natyrë abstrakte dhe të përgjithshme që, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, është elementi përcaktues i juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, në vlerësimin tim, qëndrimi i shumicës se një akt me natyrë individuale është veshur formalisht me ligj vetëm për shkak se është miratuar me ligj nga Kuvendi, është i papranueshëm në aspektin kushtetues. Në këto kushte, mendoj se nuk ka asnjë

relevancë për çështjen konkrete natyra e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, për sa kohë që Gjykata investohet në drejtim të natyrës së pretendimeve në çdo rast kur ajo vihet në lëvizje për shqyrtimin e një çështjeje që bën pjesë në juridiksionin kushtetues në kuptim të nenit 131, pika 1, të Kushtetutës.

11. Për sa më sipër, vlerësoj se vetëm ligji nr. 50/2022 i nënshtrohet kontrollit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, kurse Marrëveshja e Administrimit, për sa kohë nuk bëhet pjesë e instrumentit që e ka miratuar atë, pra e ligjit të Kuvendit, si dhe në kushtet kur është një akt që ka natyrë thelbësisht individuale, nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, por vetëm juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.

B. Për themelin e çështjes

12. Një akt juridik i Kuvendit synon të rregullojë marrëdhënie sociale të përgjithshme, pra një sferë më të gjerë raportesh juridike në kuadër dhe interes të shoqërisë, për rrjedhojë për nga qëllimi kushtetues është një akt me zbatim të përgjithshëm. Në këtë kuptim, nëse qëllimi i lidhjes së një marrëveshjeje/kontrate synon interesin e palëve të saj, qëllimi i ligjbërjes synon interesin e përgjithshëm të shoqërisë. Ndërsa ligji ka natyrë unilaterale, duke i dhënë shprehje vullnetit të ligjvënës, përmbajtja dhe forma e të cilit përcaktohen nga nevoja për të rregulluar një fushë të caktuar të marrëdhënieve sociale, marrëveshja/kontrata është një akt që përcakton një marrëdhënie bilaterale, ku secila nga palët ka shprehur vullnetin e saj nëpërmjet paraqitjes së ofertës nga njëra palë dhe pranimit të saj nga pala tjetër.

13. Në vlerësimin tim, ligji nr. 50/2022 për nga natyra e tij, për shkak të çështjes që ka synuar të rregullojë, bie ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve, të parashikuar në nenin 7, të Kushtetutës, pasi ka ndërhyrë në rregullimin e një çështjeje që nuk bën pjesë në ato që i përkasin pushtetit ligjvënës. Po kështu, vlerësoj se në rastin konkret nuk vihet në diskutim as parashikimi i nenit 172 të ligjit nr. 27/2018, që ka njohur të drejtën e miratimit të këtyre lloj marrëveshjesh nga Kuvendi, as natyra e pasurisë në fjalë apo rëndësia e mbrojtjes dhe ruajtjes së saj. Mendoj se ndërhyrja e Kuvendit përmes miratimit të Marrëveshjes së Administrimit me ligj, pra me një akt me natyrë të përgjithshme, e bën këtë veprimtari jokushtetuese, për sa kohë që në



këtë mënyrë ai ka ndërhyrë për rregullimin e një çështjeje konkrete dhe të veçantë.

14. *Së pari*, pika 5, e nenit 172, të ligjit nr. 27/2018, i referohet miratimit nga ana e Kuvendit, çka nuk nënkupton se ky miratim kërkon në çdo rast miratimin me ligj, për sa kohë që Kuvendi ka të drejtë të miratojë edhe akte të tjera (vendime) që janë me natyrë të pastër individuale. Kjo është arsyeja për të cilën nuk vlerësoj se ka vend për vënien në diskutim të përmbajtjes së kësaj dispozite në aspektin e kushtetutshmërisë së saj, duke u ndalur vetëm te veprimtaria konkrete e ushtruar nga Kuvendi në miratimin e ligjit nr. 50/2022.

15. *Së dyti*, çështja e rregulluar përmes ligjit nr. 50/2022 është e tillë që i përket vlerësimit dhe miratimit të saj nga pushteti ekzekutiv, për sa kohë ka të bëjë me përcaktimin e kufijve të administrimit të një pasurie publike në pronësi të shtetit, pra është një çështje me natyrë të pastër ekzekutive dhe jo normative. Rregullimi me ligj i një çështjeje unike/të veçantë/të vetme bën që edhe vetë akti i Kuvendit të kthehet *de facto* në një akt me natyrë individuale, për sa kohë i mungojnë, në aspektin material, ato tipare karakteristike të një akti me natyrë të përgjithshme normuese, duke ndërhyrë kështu Kuvendi në kompetencat e pushtetit ekzekutiv. Marrëveshja në fjalë e lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe FMB-së, për nga natyra dhe përmbajtja e saj, është një kontratë administrative që përmban edhe elemente të së drejtës private. Vullneti i ligjvënësit në këtë rast nuk është i shprehur në cilësinë e organit përfaqësues të vullnetit të popullit, por me synimin për t'i dhënë vlerë juridike dispozitave të një marrëveshjeje që është detyruese dhe sjell pasoja vetëm ndaj palëve të saj.

16. Karakteri normativ dhe natyra e rregullave që përmban një ligj i Kuvendit nuk pajtohet me zbatimin e tyre për një rast ose raste individuale, që është një çështje që i takon kompetencës së pushtetit ekzekutiv. Ligji nr. 50/2022, për nga titulli dhe përmbajtja ka si objekt miratimin e një marrëveshjeje të lidhur mes dy palëve, e identifikuar dhe e specifikuar në mënyrë të qartë, çka bën që fusha e veprimit të tij të jetë qartësisht e përcaktuar me natyrë individuale, duke rregulluar kështu një fushë që bie në kompetencën rregulluese të pushtetit ekzekutiv. Nuk është në kompetencën e pushtetit legjislativ që të miratojë përmes ligjit një akt vullneti të lidhur mes palëve, proces ky që kërkon jo vetëm vlerësimin e interesit në atë rast konkret, por edhe të

marrëveshjes konkrete mes palëve që japin dhe marrin të drejta nga njëra-tjetra.

17. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, miratimi i Marrëveshjes së Administrimit nga Kuvendi përmes ligjit nr. 50/2022, e veson procedurën parlamentare dhe vetë aktin nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, për sa kohë bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve. Nisur nga kjo, mbajta qëndrimin se ligji në fjalë duhej të shfuqizohej si i papajtueshëm me Kushtetutën, duke theksuar se ky shfuqizim i ligjit, ndërsa nuk prek Marrëveshjen e Administrimit, do të mundësonte kontrollin e kësaj të fundit nga sistemi gjyqësor i zakonshëm, si një akt juridik me natyrë individuale i mëvetësishëm nga ligji.

Anëtar: Ilir Toska

VENDIM **Nr. 36, datë 30.4.2024**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare
Marsida Xhaferllari	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare
Sonila Bejtja	anëtare
Sandër Beci	anëtar
Ilir Toska	anëtar
Genti Ibrahim	anëtar
Marjana Semini	anëtare
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 16.4.2024 dhe 30.4.2024 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 38 (A) 2023, që u përket:

KËRKUESE: Gjyste Nikolli, përfaqësuar nga avokatët Luan Gega dhe Ndre Molla.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Luçe Basha, Françesk Basha, Pjerin Basha, i përfaqësuar nga avokat Sokol Gjini.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1071 (236), datë 10.6.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



Kthimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 16, 42, 43, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1 dhe 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar Pjerin Basha, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Luçe Basha e Françesk Basha, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Gjyste Nikolli është trashëgimtare ligjore e shtetasit P.N. (bashkëshortit të saj), i cili ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor objekt shqyrtimi. Rezulton që ky shtetas i ka dhënë shtetasit K.B., trashëgimlënësi i subjekteve të interesuara Luçe Basha, Françesk Basha dhe Pjerin Basha, letra me vlerë në shumën 2,416,146 lekë, të cilat, sipas deklaratës noteriale nr. 643 rep., nr. 386., datë 9.2.1995, ka marrë përsipër që t’ia kthente brenda një viti përkundrejt vlerës së këmbimit 100%. Duke qenë se ky detyrim nuk është përmbushur, më datë 7.11.2012 shtetasi P.N. ka paraqitur në gjykatë kërkesëpadi me objekt kthimin e shumës sipas këtij akti noterial. Në gjykim, në cilësinë e palës së paditur, janë thirrur shtetasit Luçe Basha, Francesk Basha dhe Pjerin Basha, në cilësinë e trashëgimtarëve të shtetasit të ndjerë K.B.

2. Me vendimin nr. 563-392, datë 17.6.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se ajo është parashkuar dhe e drejta e saj është shuar. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, për sa kohë që

trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët takuese deri në vlerën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë, pala paditëse nuk ka arritur të provojë vlefshërinë e pasurisë trashëgimore që ka marrë secili prej të paditurve, fakt i cili do t’i legjitimonte pasivisht këta shtetas. Po sipas gjykatës, paditësi e ka konceptuar padinë si një marrëdhënie huaje me shtetasin K.B. Gjatë gjyimit të kësaj çështjeje, gjykata në seancën gjyqësore të datës 5.3.2013 ka pranuar kërkesën e palës paditëse për pakësimin e objektit të padisë, duke arsyetuar sipas nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) se është në tagrin e kësaj pale disponimi mbi objektin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi P.N., duke kërkuar ndryshimin e vendimit gjyqësor dhe pranimin e padisë. Po ashtu, pala e paditur ka paraqitur kundërankim duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

3. Me vendimin nr. 3734, datë 12.11.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 563-392, datë 17.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe kthimin e çështjes pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka hetuar në lidhje me legjitimitimin pasiv të palëve të paditura, pasi në dosjen gjyqësore nuk ndodhet dëshmia e trashëgimisë së të ndjerit K.B. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar nenin 185 të KPC-së, pasi fletëthirrjes për komunikimin e palëve të paditura nuk i është bashkëlidhur kërkesa e paraqitur nga paditësi për pakësimin e objektit të padisë. Për sa u përket pretendimeve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes në themel, ajo gjykatë ka vlerësuar të mos i vërë në diskutim, përderisa ka konkluduar që çështja për shkelje të rënda procedurale të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs pala e paditur në procesin gjyqësor, duke pretenduar se gjykata e apelit ka zbatuar gabim ligjin material, pasi e drejta e padisë është shuar dhe se ajo nuk është shprehur në lidhje me pretendimet e paraqitura në kundërankim, duke mos i marrë ato në konsideratë.

4. Mbi bazën e kërkesës së paraqitur në seancën gjyqësore të datës 23.6.2015 të përfaqësuesit të palës paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 629-431-37, datë 23.6.2015, ka vendosur të pezullojë gjykimin e kësaj çështjeje deri në përfundimin e gjyimit të saj në Gjykatën e Lartë.



5. Me vendimin e datës 20.1.2021, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, ndërsa me vendimin e datës 29.4.2022 ka vendosur revokimin e këtij vendimi dhe kthimin e saj për shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë të dokumenteve.

6. Në lidhje me rekursin, me vendimin nr. 00-2022-1071 (236), datë 10.6.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3734, datë 12.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 536–392, datë 17.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Kurbin, duke arsyetuar se ky vendim është marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit procedural civil dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi, ndërsa vendimi i gjykatës së apelit është i cenueshëm në mungesë të ekzistencës së kriterëve ligjore siç parashikon neni 467 i KPC-së.

7. Më datë 23.8.2023, përmes shërbimit postar, kërkesja Gjyste Nikolli, në cilësinë e trashëgimtares së paditësit P.K., i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 15.9.2023. Në lidhje me këtë ankim kushtetues, me vendimin e datës 23.11.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, në kërkesën e saj ka parashtruar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të:

8.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk mund të verifikojë as afatin prekluziv, as parashkrimin e së drejtës së padisë nëse palët nuk janë legjitimuar në proces. Ajo nuk është gjykatë fakti dhe nuk mund ta zgjidhë çështjen për sa kohë që gjykata e apelit nuk është shprehur në lidhje me mosmarrëveshjen civile.

8.2 *Së drejtës për t'u mbrojtur të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve dhe pa i njoftuar ato. Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkesën për vendimin e datës 29.4.2022, me të cilin ka revokuar vendimin për

shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit. Kërkesja nuk ka pasur dijeni dhe nuk është njoftuar në lidhje me ecurinë e këtij procesi, për shkak të largimit të avokatit jashtë shtetit, i cili nuk e ka vënë në dijeni, me qëllim që të caktonte një mbrojtës tjetër dhe të paraqiste pretendimet e saj përpara se të zhvillohej seanca në dhomën e këshillimit. Gjykata e apelit nuk e ka gjykuar çështjen në themel, por është marrë vetëm me legjitimitimin pasiv të palëve në proces, arsye për të cilën Kolegji Civil duhet ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore.

9. **Subjekti i interesuar**, Pjerin Basha, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1 Kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor, i cili është i përcaktuar në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës pas 14 muajve nga dhënia e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pa dhënë argumente ligjore në këtë drejtim.

9.2 Kërkesja me dëshminë e trashëgimisë testamentare të datës 19.12.2019 është shpallur trashëgimtare testamentare e testatorit P.N. në 100% të pasurisë trashëgimore, duke pranuar në të njëjtën kohë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pasuri trashëgimore. Që nga data 19.12.2019 kërkesja ka pasur të drejtën ligjore të interesohej për fatin e pasurisë trashëgimore, të ndiqte ose jo vullnetin e testatorit në kërkesëpadinë me objekt “kthim shume”, si dhe të verifikonte në çdo institucion shtetëror ose gjykatë nëse kishte çështje në shqyrtim përfshirë edhe Gjykatën e Lartë.

9.3 Ashtu siç kanë pranuar të gjitha gjykatat, padia objekt gjykimi është parashkruar referuar neneve 112, 113 dhe 114 të Kodit Civil (KC) dhe kërkesa e kërkeses nuk është gjë tjetër vetëm cenim i së drejtës për një gjykim të shpejtë dhe të drejtë të çështjes.

10. **Subjektet e interesuara**, Luçe Basha dhe Françesk Basha, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një



procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Edhe pse në rastin konkret objekt rekursi në Gjykatën e Lartë është bërë vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe kthimin e çështjes pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjykues, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë e ka shfuqizuar atë vendim, duke lënë në fuqi vendimin nr. 563–392, datë 17.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë, për shkak të parashkrimit të saj. Për rrjedhojë, ky vendim konsiderohet përfundimtar për qëllime të gjykimit kushtetues.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

15. Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 10.6.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë

Gjykatë më datë 23.8.2023 përmes shërbimit postar. Sipas kërkeses, ajo nuk është njoftuar për vendimin e Gjykatës së Lartë dhe është njohur me të vetëm më datë 25.4.2023, nëpërmjet shkresës nr. 1948/1 prot., datë 24.4.2023 të asaj gjykate, në përgjigje të kërkesës së saj për informacion të datës 30.3.2023.

16. Sipas subjektit të interesuar, kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis* për shkak të mosrespektimit të afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2020, pasi ajo i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues pas 14 muajve nga dhënia e vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nuk ka dhënë argumente ligjore në këtë drejtim.

17. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për qëllime të këtij gjykimi, me shkresën nr. 938/12 prot., datë 24.10.2023, është kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë në lidhje me momentin në të cilin vendimi i kundërshtuar është bërë i disponueshëm për palët. Në përgjigje, me shkresën nr. 5543/1 prot., datë 1.11.2023, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi nr. 00-2022-1071 (236), datë 10.6.2022 i Kolegjit Civil është publikuar në faqen e saj zyrtare më datë 14.4.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin atë. Po kështu, kërkesja, bashkëlidhur kërkesës, ka paraqitur shkresën nr. 1948/1 prot., datë 24.4.2023 të kancelarit



të Gjykatës së Lartë, me të cilën, në përgjigje të kërkesës së kërkuësës të datës 30.3.2023, i ka vënë në dispozicion kopje të vendimit të asaj gjykate.

19. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, faktin që kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Lartë përpara se vendimi të publikohej në faqen zyrtare të internetit, pasi kërkesa është e datës 30.3.2023, ndërsa vendimi është publikuar më datë 14.4.2023, si dhe kohën e gjatë që ka kaluar nga dhënia deri në zbardhjen e tij, Gjykata vlerëson të konsiderojë si moment të marrjes dijeni efektivisht datën 25.4.2023, ku kërkuësja është njohur përmes shërbimit postar. Duke iu referuar këtij momenti, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë prapësimi i subjektit të interesuar në këtë drejtim është i pabazuar.

20. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae* kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së mbrojtjes të lidhur me të drejtën e aksesit, për shkak të mosnjohimit të palëve nga Gjykata e Lartë për revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, si edhe për shkak të gjyqimit të çështjes së saj në dhomën e këshillimit. Kërkuësja, në kuptim të së drejtës për proces të rregullt, ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë nuk mund të verifikojë as afatin prekluziv, as parashkrimin e së drejtës së padisë, nëse palët nuk janë legjitimuar në proces, duke mos qenë gjykatë fakti dhe për sa kohë që gjykata e apelit nuk është shprehur në lidhje me mosmarrëveshjen civile. Këto pretendime të kërkuësës, për nga natyra e tyre, hyjnë në juridiksionin kushtetues, prandaj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata, në vijim, do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

21. Kërkuësja ka pretenduar, në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, se Gjykata e Lartë nuk mund të verifikojë as afatin prekluziv, as parashkrimin e së drejtës së padisë nëse palët nuk janë legjitimuar në proces dhe ajo, si gjykatë e ligjit, nuk mund të zgjidhë çështjen për sa kohë që gjykata

e apelit nuk është shprehur në lidhje me mosmarrëveshjen civile.

22. Subjekti i interesuar, Pjerin Basha, ka prapësuar se, siç kanë pranuar edhe gjykatat e zakonshme, padia objekt gjykimi është parashkruar referuar neneve 112, 113 dhe 114 të KC-së dhe kërkesa e kërkuësës, në thelb, nuk është gjë tjetër vetëm pretendim për cenimin e së drejtës për gjykim të shpejtë dhe të drejtë të çështjes.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Referuar natyrës së gjyqimit kushtetues të kërkesave individuale, tashmë Gjykata ka qëndrim të konsoliduar se, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë. Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se Gjykata e Lartë ka në kompetencën e saj kontrollin e mënyrës së zbatimit të ligjit dhe interpretimin përfundimtar të tij si gjykatë e ligjit, me kusht që ky interpretim të jetë realizuar fillimisht nga dy gjykatat më të ulëta (*shih vendimin nr. 26, datë 9.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është iniciuar nga trashëgimlënësi i kërkuësës për përmbushjen e detyrimit nga trashëgimtarët e paditur të shtetasit K.B. Në



përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenet 112, 113 dhe 114 të KC-së ka arritur në përfundimin se e drejta e padisë është shuar dhe ajo nuk mund të realizohet nëpërmjet gjykatës. Sipas saj, duke mos qenë përpara një padie që nuk parashkruhet, zbatohet afati i përgjithshëm 10-vjeçar i parashkrimit, i cili ka filluar nga dita e caktuar për ekzekutimin e detyrimit, pra në vitin 1996 (*shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin*).

26. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim. Sipas asaj gjykate, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, nuk janë administruar fletëthirrjet e palës së paditur, ndaj gjykata e shkallës së parë duhet të ftojë palët të reflektojnë lidhur me objektin e padisë, afatin e parashkrimit të padisë apo ndërprerjen e tij dhe vetëm pasi të ketë marrë disponimet e tyre të vlerësojë bazueshmërinë ose jo të padisë, pra të zgjidhë mosmarrëveshjen, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve, pa u lidhur me përcaktimin që propozojnë palët (*shih faqet 3 dhe 4 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

27. Mbi bazën e rekursit të palës së paditur në procesin gjyqësor, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Sipas tij, ligji, duke u njohur personave të drejtën subjektive për t'iu drejtuar gjykatës me anën e padisë, njëkohësisht, e kufizon ushtrimin e kësaj të drejte me afate të caktuara kohore, të gjykuara të arsyeshme dhe të mjaftueshme nga ligjvënësi për ushtrimin e kësaj të drejte ndaj mosushtrimi i së drejtës brenda këtyre afateve bën që subjekti të humbasë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, pra të humbasë të drejtën për të detyruar palën tjetër të përmbushë detyrimin e saj. Në këtë kuptim, Kolegji Civil ka vlerësuar se pala paditëse ka pretenduar të drejta të lindura në vitin 1996, ndërsa kërkesëpadia kundër të paditurve është paraqitur më datë 7.11.2012, pra në tejkalim të afatit 10-vjeçar (*shih paragrafët 25–27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

28. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se gjykata e apelit ka konstatuar shkelje të rënda procedurale në gjykimin e çështjes në shkallë të parë duke e prishur vendimin e kësaj gjykate pa e gjykuar çështjen në themel, pra pa u shprehur për bazueshmërinë e kërtimeve të palëve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes, përfshirë zbatimin e

dispozitave materiale civile që rregullojnë institutin e parashkrimit të padisë.

29. Gjykata, duke pasur parasysh funksionin rishikues dhe kompetencat e Gjykatës së Lartë në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës, vlerëson se kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej saj janë diktuar në rastin konkret nga objekti i rekursit që e ka vënë në lëvizje, pra nga vendimarrja dhe disponimet e vendimit të kundërshtuar të gjykatës së apelit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për kundërshtimin e disponimit të gjykatës së apelit në lidhje me parregullsitë procedurale të konstatuara prej saj gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë, që kanë të bëjnë me respektimin e njoftimit të palëve të paditura për kërkesëpadinë dhe aktet bashkëlidhur, si dhe njoftimin e palëve në mungesë për ndryshimin e objektit. Kolegji Civil, në përfundim të gjykimit, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit gjykatës së rrethit, duke u shprehur jo për këto aspekte procedurale të procesit, por në lidhje me shuarjen e së drejtës së padisë, sipas parashikimeve të KC-së.

30. Në rastin konkret, në thelb të vendimarrjes së gjykatës së apelit nuk ka qëndruar interpretimi i dispozitave të KC-së në lidhje me parashkrimin e padisë, por kthimi i çështjes së kërkuësës për rigjykim është bazuar mbi shkaqe që nuk kishin të bënin me interpretimin e ligjit të zbatueshëm. Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim, vetëm gjykata e shkallës së parë është shprehur në lidhje me shuarjen e së drejtës së padisë për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të parashkrimit sipas KC-së. Kjo çështje nuk është bërë objekt vlerësimi nga gjykata e apelit, për sa kohë që ajo gjykatë nuk është ndalur në mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave të KC-së, në kushtet kur ajo ka konstatuar shkelje të dispozitave procedurale që lidhen me njoftimin e palëve. Për rrjedhojë, gjykata e apelit nuk ka vënë në diskutim ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së parë në këtë drejtim, pra nuk ka dhënë asnjë vlerësimin në lidhje me të drejtën e ushtrimit të padisë nga ana e paditësit.

31. Gjykata vlerëson se edhe pse interpretimi i ligjit në lidhje me të drejtën e ushtrimit të padisë dhe parashkrimin e saj përbën çështje me natyrë ligjore, Gjykata e Lartë, brenda funksionit të saj, nuk duhej t'i jepte fund procesit gjyqësor me një vendimarrje përfundimtare, në kushtet kur gjykata e apelit nuk është shprehur për parashkrimin e padisë, si çështje e interpretimit të ligjit të zbatueshëm, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të palëve. Duke



vepruar në këtë mënyrë Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkuueses një shkallë gjykimi, konkretisht gjykimin në gjykatën e apelit. Për këto arsye, pretendimi i kërkuueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i bazuar, për rrjedhojë procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë konsiderohet i parregullt në kuptimin kushtetues.

32. Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuueses, që ka të bëjë me cenimin e të drejtës së mbrojtjes të lidhur me të drejtën e aksesit substancial në Gjykatën e Lartë për shkak të mosnjohimit për revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, për rrjedhojë edhe për shqyrtimin e çështjes së saj në dhomën e këshillimit, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin e tij, për sa kohë që çështja e kërkuueses do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

33. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtëm të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1071 (236), datë 10.6.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 30.4.2024.

Shpallur, më 29.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë (kundër): Marsida Xhaferllari, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuueses Gjyste Nikolli, me objekt shfuqizimin e vendimit të datës 10.6.2022 të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për shqyrtim pranë saj, jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se ankimi kushtetues individual ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues më datë 23.8.2023, duke kundërshtuar procesin gjyqësor, i cili është përmbyllur me vendimin e datës 10.6.2022 të Gjykatës së Lartë. Vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë më datë 14.4.2023, moment në të cilën palët mund ta dispononin atë. Kërkuësja, bashkëlidhur ankimit, ka paraqitur shkresën e datës 24.4.2023 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, me të cilën, në përgjigje të kërkesës së saj të datës 30.3.2023, i ka vënë në dispozicion kopje të vendimit të asaj gjykate.

3. Mbi këto rrethana, shumica ka çmuar se duke pasur parasysh që çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, faktin që kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Lartë përpara se vendimi të publikohej në faqen zyrtare të internetit, pasi kërkesa është e datës 30.3.2023 ndërsa vendimi është publikuar më datë 14.4.2023, si dhe kohën e gjatë që ka kaluar nga dhënia dhe deri në zbardhjen e tij, momenti i marrjes dijeni efektivisht konsiderohet data 25.4.2023, kur ajo është njohur përmes shërbimit postar, ndaj legjitimohet *ratione temporis* (shih paragrafin 19 të vendimit).

4. Ne gjyqtarët në pakicë nuk pajtohemi me këtë qëndrim të shumicës, pasi në vlerësimin tonë zgjidhja e saj në mënyrë joproporcionale i jep përparësi aksesit të kërkuueses në Gjykatë përkundërt të drejtave të subjekteve të interesuara, pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, lidhur me sigurinë juridike që ato kanë pasur se vendimi gjyqësor i disponuar në favor të tyre nuk do të vihej më në dyshim. Ky vlerësim mban në konsideratë qëllimin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me shqyrtimin paraprak të ankimeve kushtetuese individuale.



5. Konkretisht, në kuptim të nenit 133, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 8577/2000, çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohen kriteret ligjore për pranueshmërinë e tij për shqyrtim në seancë plenare, të cilat janë kumulative. Një prej tyre është afati ligjor i paraqitjes së ankimit, i cili, sipas nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, është 4 muaj nga konstatimi i cenimit. Afati për paraqitjen e ankimit është i prerë, që do të thotë se nuk mund të zgjatet nga Gjykata dhe se kalimi i tij shkakton humbjen e së drejtës së individit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Duke mbajtur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të pranueshmërisë, duhet evidentuar se mosrespektimi i afatit ligjor passjell moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

6. Gjykata, në jurisprudencën ka pranuar se në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ajo e llogarit afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme. Kështu, në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Rregulli ligjor i afatit dhe standardet kushtetuese të mësipërme garantojnë parimin e sigurisë juridike, duke parandaluar zgjatjen në kohë të gjendjes së pasigurisë së subjekteve të tjera të interesuara, në kuptimin që çështja merret në shqyrtim nga Gjykata brenda një kohe të arsyeshme. Po ashtu, Gjykata përmes standardeve të qëndrueshme për vlerësimin e afatit garanton qartësinë e rregullit ligjor për çdo individ që çmon të paraqesë ankim kushtetues individual, në kuptimin që ligji është i barabartë për të gjithë. Afati ligjor 4-mujor përcakton kufirin kohor të kontrollit që ushtron Gjykata dhe u tregon të gjitha palëve të interesuara periudhën përtej së cilës një kontroll i tillë nuk është i mundur. Thënë ndryshe, afati parandalon situatat ku vendimet gjyqësore vihen në dyshim në mënyrë të vazhdueshme, si dhe çdo

shqetësim legjitim, duke synuar sigurimin e stabilitetit të marrëdhënieve juridike dhe eliminimin e mosmarrëveshjeve. Kjo është edhe arsyeja pse rregulli i afatit ligjor 4-mujor merret në shqyrtim edhe me nismë të vetë Gjykatës.

8. Nën dritën e kësaj analize, ne gjyqtarët në pakicë konstatojmë se edhe sikur në përllogaritjen e afatit të konsiderohej data kur vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët (14.4.2023), sërisht rezulton se kërkuësja e ka paraqitur ankimin kushtetues individual (23.8.2023) tej afatit ligjor 4-mujor. Në këtë pikë vëmë në dukje se gjykimi kushtetues vihet në lëvizje nga vetë individi, që do të thotë se ai prezumohet se është në dijeni të kriterëve paraprake dhe jurisprudencës së Gjykatës mbi to. Në këtë kontekst, disiplinimi i procesit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues merr rëndësi të posaçme për të rritur dhe ndërgjegjësuar kërkuësin/t, për të forcuar efektivitetin e vetë Gjykatës, si dhe për të dëshmuar transparencën dhe besimin te veprimtaria uniforme e saj. Ky vlerësim mbështetet edhe në qëndrimin e konsoliduar të vetë kësaj Gjykate, e cila ka theksuar se ndonëse aksesin në gjykatë është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit, ai mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në përfundim, çmojmë se shumica nuk duhej ta kishte pranuar kërkesën e kërkuëses, në kushtet kur ajo nuk legjitimohej *ratione temporis* për të vënë në lëvizje Gjykatën me ankim kushtetues individual të paraqitur në tejkalim të afatit ligjor 4-mujor, nga data kur vendimi ishte bërë i disponueshëm për palët.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci



VENDIM

Nr. 95, datë 20.5.2024

**MBI MIRATIMIN E “KONTRATËS TIP
PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK,
AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI, ‘KESH’ SHA
DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR
FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË
FURNIZOHEN NGA ‘FSHU’ SHA”**

Në zbatim të neneve 16, 20 germa “h”, 47, 56, germa “f”, si dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pjesës I, nenit 5, pika 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 987/1 prot., datë 14.5.2024, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”,

konstatoi se:

- Shoqëritë “KESH” sh.a., me shkresën e përbashkët me nr. 1889/2 prot., datë 23.4.2024, dhe “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 2859/2 prot., datë 24.4.2024, protokolluar me tonën me nr. 987 prot., datë 24.4.2024, dërguan në ERE, për miratim, “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit

publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a., dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”.

- Me marrjen e kësaj kontrate u realizua publikimi i saj në faqen e internetit të ERE-s, në *link*-un: <https://www.ere.gov.al/sq/publikime/konsultime/kontrata-ndermjet-kesh-sh-a-dhe-ftl-sh-a-per-shitje-blekje-depozitimin-shkembimin-e-energji-e-elektrike-per-periudhen-01-01-2024-31-12-2024>

- Kontrata e propozuar nga palët është e përbërë nga 21 nene: shtojca 1: programet e livrimit sipas neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate; shtojca 2: sipas nenit 19, të kësaj kontrate, pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të palëve për regjistrimet telefonike; aneksi nr. 1: parashikimi i sasisë së plotë vjetore të konsumit të “FSHU” sh.a. për vitin 2024; aneksi 2 për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, “KESH” sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”, ky aneks është i përbërë nga 5 nene dhe nga shtojca 1 rakordim ditor “KESH” sh.a.–“FSHU” sh.a.

- Struktura e propozuar e kontratës së dakordësuar nga palët është thujtë e njëjtë me strukturën e kontratës së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 278, datë 25.9.2023.

- Në ndryshim nga kontrata e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 278, datë 25.9.2023, e cila ka 22 nene, kontrata e dakordësuar nga palët për vitin 2024 ka 21 nene, pasi neni 22 është bërë pjesë integrale si pikë 4, e nenit 21, me të njëjtën përmbajtje si më poshtë vijon: “Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë”.

- Baza ligjore e referuar në kontratë për nënshkrimin e saj nga palët është:

- Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 20, germa “h”;

- Vendimi nr. 456, datë 29.6.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit,



transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar;

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;

- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 347, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit e klerimit dhe e shlyerjes);

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë ‘KESH’ sh.a.”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 271, datë 19.9.2023, i Bordit të ERE-s, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Korporata Elektroenergjitike Shqiptare’ (KESH) sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;

- Vendimi nr. 164, datë 4.11.2019, i Bordit të ERE-s, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;

- Urdhri nr. 217, datë 29.12.2023, i ministrit përgjegjës për energjinë, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 28, datë 18.1.2021, ‘Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”;

- Vendimi i ministrit përgjegjës për energjinë nr. 936/1 prot., datë 14.2.2024 (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për vitin 2024.

- Nga vlerësimet e bëra të bazës ligjore të përdorur në kontratën e propozuar nga palët (KESH sh.a. dhe FSHU sh.a.) rezulton e plotë dhe në të njëjtën kohë ka reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur përgjatë vitit 2024. Respektivisht që prej 1 janarit 2024 është hequr gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike e shpallur në

vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se pjesë integrale e kontratës së propozuar është dhe aneksi II “Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”, ky aneks ka rregulluar të gjithë marrëdhënien financiare të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024. Marrëdhënien e shitjes dhe të blerjes së energjisë fizike ndërmjet palëve, për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e rolit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF) që do të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë “ALPEX” sh.a., në tregun e ditës në avancë.

- Për rrjedhojë, në bazën ligjore të kësaj kontrate një element i rëndësishëm është dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, e klerimit dhe e shlyerjes).

- Lidhur me ndryshimet e evidentuara, në kontratën e propozuar nga palët “KESH” sh.a. dhe “FSHU” sh.a. për vitin 2024, nëpërmjet *email*-it të datës 7.5.2024, ERE iu drejtua shoqërisë “FSHU” sh.a., e cila solli shpjegimet për këto raste respektivisht:

- Në nenin 3 është shtuar përkufizimi “Instrument financiar”, “FSHU” sh.a. sqaron si më poshtë: kemi bërë përditësim të përkufizimeve sipas VKM-së nr. 46/2024, konkretisht “1. Në nenin 3, të pjesës I, shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje: ‘5. Në këtë vendim, fjalët “instrument financiar” nënkuptojnë marrëveshje për faturimin reciprok të diferencës midis çmimit klerues për njësi kohore të tregut (të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë) për ditën e lëvrimit me çmimin e parashikuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve, të cilat sigurojnë pjesëmarrësit ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg”. Ky term është i nevojshëm në mënyrë të veçantë për aneksin II, i cili është pjesë e kontratës së shitblerjes së



energjisë elektrike dhe rregullon të gjithë marrëdhënien financiare të shitjes dhe të blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024.

- Në nenin 9 është evidentuar një ndryshim nga kontrata e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 278, datë 25.9.2023, respektivisht në këtë nen, në pikën 2/a është ndryshuar dhe në pikën 2/b fatura sistemuese është parashikuar të bëhet vjetore, ka qenë parashikuar në kontratën e vjetshme 6-mujore dhe pagesa është brenda 45 ditëve nga data e fundit e lëvrimit, dhe ka qenë se pagesat sipas faturave sistemuese mes palëve do të bëhen brenda datës 30 janar të vitit pasardhës. “FSHU” sh.a., lidhur me këtë ndryshim ka dhënë sqarimin e mëposhtëm: “Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të bëra me VKM-në nr. 46/2024 në VKM-në nr. 456/2022, në të cilën përcaktohet se: sasia e depozituar e Shoqërisë Publike të Prodhimit, për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universal është sasia e mbetur nga prodhimi i burimeve të rinovueshme pas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe plotësimit të nevojave të furnizimit të klientëve të Shoqërisë Publike të Furnizimit në Tregun e Lirë. Sasitë rakordohen me bazë mujore dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe nevojave të Shoqërisë Publike të Furnizimit në Tregun e Lirë, bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga Furnizuesi i Tregut të Lirë, për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve”.

- Lidhur me këtë ndryshim, palët kanë dakordësuar të reflektojnë ndryshimet e dala me VKM-në nr. 46/2024, por edhe në të njëjtën kohë të rregullojnë procesin e rakordimit duke marrë në konsideratë edhe kontrata të tjera të cilat janë të lidhura palët respektivisht, kontratën që “KESH” sh.a. lidh me “FTL” sh.a., ky element synon unifikimin e procesit të rakordimit të kontratave dhe në të njëjtën kohë unifikimin e detyrimit që lind për pagesat. “FSHU” sh.a., sikurse evidentuar më sipër, bën me dije se procesi i rakordimit për muajin e fundit të vitit realizohet deri në 25 janar dhe nuk është e mundur që të ketë një detyrim për pagesë për një periudhë kaq të shkurtër deri në 30 janar, në këtë mënyrë palët kanë dakordësuar që kjo pagesë të unifikohet 45 ditë nga data e fundit të lëvrimit. Në kontratën e dakordësuar nga palët nuk rezulton që

të lindin detyrime financiare shtesë lidhur me këtë proces që pagesa e faturës sistemuese të realizohet 45 ditë nga data e fundit e lëvrimit.

- Në nenin 14 është evidentuar një ndryshim nga kontrata e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 278, datë 25.9.2023, respektivisht në këtë nen ndryshon germa “e”, duke futur konceptin faturë sistemuese 12-mujore, ndërkohë që ka qenë 6-mujore. “FSHU” sh.a., lidhur me këtë ndryshim, ka dhënë sqarimin e mëposhtëm: “Për të njëjtat arsye të sqaruara më sipër”. Në këto kushte, duke qenë se koncepti i faturës sistemuese është dhënë dhe në nenin 9 të kontratës vlerësojmë se qëndrimi i dhënë në shpjegimet e nenit 9 më sipër vlejné edhe për këtë rast.

- Bazuar në nenin 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, palët kanë përcjellë nëpërmjet shkresës së përbashkët me nr. 1889/2 prot., datë 23.4.2024, dhe të “FSHU” sh.a. me nr. 2859/2 prot., datë 24.4.2024, protokolluar me tonën me nr. 987 prot., datë 24.4.2024, kontratën TIP për “Shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, ‘FSHU’ sh.a., për furnizimin e klientëve universalë për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”, vlerësojmë se periudha duhet të shënohet në këtë mënyrë: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në bazën ligjore, vendimi i ministrit përgjegjës për energjinë, vlerësohet që nr. prot., dhe data të vendosen në këtë mënyrë: nr. __ prot., datë dd.mm.vvvv (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal.

- Në nenin 1 “Qëllimi i kontratës” vlerësohet që periudha kohore të shënohet: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në nenin 2, pika 3 vlerësohet të shënohet: “Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin vvvv është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. __ prot., datë dd/mm/vvvv”.



- Neni 12 vlerësohet të shënohet: “Kontrata është e vlefshme për periudhën dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Neni 18 të rishkruhet në kuadër të miratimit të një kontrate tip, pa cilësuar emrat e personave të kontaktit.

- Neni 21, pika 1 vlerësohet të rishkruhet duke hequr periudhën kohore dhe zëvendësuar si në vijim: “Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën kohore dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv”.

- Në emërtimin e aneksit nr. 1, viti 2024, të zëvendësohet me vvvv.

- Në emërtimin e aneksit nr. 2, periudha kohore 1.1.2024–31.12.2024, vlerësohet të zëvendësohet me: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në nenin 1, pikën 1.1, të aneksit nr. 2, periudha kohore vlerësohet të zëvendësohet me: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në shtojcën nr. 1, viti 2024 vlerësohet të zëvendësohet me: viti [vvvv].

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës tip “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a.” (bashkëlidhur).

2. Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet

e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, “KESH” sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., të rishikojnë periudhën kohore, bazën ligjore, nenet 1, 2, pika 3; 12, 18, 21 pika 1, emërtimin e aneksit nr. 1, emërtimin e aneksit nr. 2 dhe pikën 1.1, të nenit 1, të aneksit nr. 1, të kontratës së dërguar në ERE sipas konstatimeve të këtij vendimi.

3. Kontrata e nënshkruar nga palët me ndryshimet sipas pikës 2 në këtë vendim, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi. Me miratimin e kësaj kontrate shfuqizohen të gjitha aktet që bien në kundërshtim të saj.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë “KESH” sh.a., “FSHU” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Nr. 2436/3 prot., datë 31.05. 2024Nr. 3823 prot., datë 30.05. 2024

KONTRATË TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A. (KESH SH.A.) DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A. (FSHU SH.A.), PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE UNIVERSALË PËR PERIUdhËN KOHORE

01/01/2024 – 31/12/2024

E lidhur sot më datë 30.05.2024 ndërmjet:

Shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) SH.A., shoqëri aksionare regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rrugën “Viktor Eftimiu”, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga **Z. Erlind Sulo**, Administrator i shoqërisë që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A., shoqëri aksionare, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530016L, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Algert Luzi**, Administrator i shoqërisë, që më poshtë do të quhet “Blerësi”

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 20 gërma h);
- Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar;
- Vendimi i Bordit të ERE Nr. 112, datë 08.07.2016 “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”,
- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit dhe e Klerimit dhe e Shlyerjes);



- Vendimi Nr. 23, datë 25.03.2009 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, i ndryshuar;
- Vendim Nr. 271, datë 19.09.2023, i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Vendimi nr. 164, datë 04.11.2019 i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU SH.A.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;
- Urdhër Nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrit përgjegjës për Energjinë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 28, datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar
- Vendimi i Ministrit përgjegjës për Energjinë Nr. 936/1 Prot., datë 14.02.2024 (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për vitin 2024.

Në kushtet kur:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SH.A., në aktivitetin e licencuar të furnizuesit është ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve universalë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Vendimit nr. 449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike” dhe vendimit Nr. 112, datë 08.07.2016 të Bordit të ERE “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;
- Furnizuesit të Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;
- Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar është e detyruar të furnizojë Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë, për qëllime të plotësisht të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal.
- Në bazë të Urdhërit Nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrit përgjegjës për Energjinë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 28, datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, duke filluar nga 01.01.2024, ka detyrimin të tregtohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX), energjia elektrike për furnizimin e klientëve nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe klientëve me status të veçantë. Për këtë arsye, marrëdhëniet mes palëve për sasinë e energjisë që do të tregtohet në ALPEX, do të rregullohen bazuar në parashikimet e pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.



- Në dispozitat kalimtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, parashikohet që kushtet e parashikuara në këtë VKM do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në bërjen funksionale dhe likuide të bursës së energjisë. Çmimi për njësi i energjisë elektrike, për qëllime të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.
- Ministri përgjegjës për energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë) me vendimin Nr. 936/1 Prot., datë 14.02.2024, ka miratuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik nga shoqëria e prodhimit aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës tip të shit-blerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik si më poshtë vijon:

NENI 1

QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo Kontratë (së bashku me Shtojcat apo anekset e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për periudhën kohore 1 Janar-31 Dhjetor 2024.

NENI 2

SASIA E KONTRAKTUAR DHE ÇMIMI I SHITJES

1. Sasia e kontraktuar, nominuar për vitin, që Shitësi është i detyruar të furnizojë Blerësin, është e gjithë sasia e nevojshme për plotësimin e kërkesës së plotë të Blerësit, kjo referuar programeve mujore/javore/ditore/day ahead/intra-day sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 5 të kësaj kontrate.
2. Energjia e cila ka për destinacion përdorimi furnizimin e klientëve universalë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tensionit 6/10 KV dhe klientët me status të vecantë të lidhur në nivel tensioni 20 kV nën shërbimin FMF, tregëtohet mes palëve nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë.
3. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin 2024 është ai i miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit Nr.936/1 Prot., datë 14.02.2024.
4. Për energjinë e furnizuar për realizimin e shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, palët rregullojnë marrëdhëniet tregtare sipas aneksit II që i bashkëlidhet kësaj kontrate “Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a.dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.”.



NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **“Referencat në Kohë”** - Referencat e kohës do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
2. **“Përputhja me Aktet nënligjore dhe Rregullat e Tregut”** - Kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.
3. **“Sasia e kontraktuar”** – sasia totale e energjisë referuar programeve mujore/ javore/ditore/intra-day të “FSHU” SH.A. për klientët universalë objekt i kësaj kontrate.
4. **“Aneksi Nr. 1”** parashikimi sasivë të plotë vjetore të konsumit të “FSHU” SH.A.
5. **“Aneksi Nr. 2”** Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.
6. **“Çmimi i kontratës”**- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë publike së prodhimit, KESH SH.A., në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar.
7. **Dita e Punës:** do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar;
8. **“Përgjegjësia për Balancimin”** shitësi dhe blerësi janë përgjegjës për të balancuar pozicionin e tyre në tregun e energjisë
9. **“Koha Qendrore Evropiane”** ose **“CET”** do të thotë Koha Qendrore Evropiane dhe do të përfshijë Kohën Dimërore Qendrore Evropiane dhe Kohën Verore Qendrore Evropiane sipas zbatimit;
10. **“Kapaciteti i Kontratës”** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në MWH.
11. **“Dëmet”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 13. (**Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare**)
12. **“Pala që nuk përmbush detyrimet”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 11 (**Pezullimi i Livrimit**);
13. **“Filial”** lidhur me një Palë do të thotë një Njësi e Kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo Njësi që Kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo Njësi direkt ose indirekt nën Kontrollin e përbashkët të një Pale
14. **“Pika e Livrimit”** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes Palëve;
15. **“Programi i Livrimit”** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve për ditën në advance sipas rregullave përkatëse;
16. **“Data e Pagesës”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 14 (**Faturimi dhe Pagesa**)
17. **“Data e Hyrjes në Fuqi”** ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate;
18. **“Programi”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 6, pika 3 dhe 7.2 (**Përkufizimi i Programit**) dhe **“I Programuar”** dhe **“Programimi”** do të interpretohen sipas kësaj;



19. **"Taksë"** do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas Kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;
20. **"Instrument financiar"** nënkuptojnë marrëveshje për faturimin reciprok të diferencës midis çmimit klerues për njësi kohore të tregut (të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë) për ditën e lëvrimit me çmimin e parashikuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve, të cilat sigurojnë pjesëmarrësit ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.
21. Çdo term tjetër i përdorur në këtë kontratë do të lexohet në kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

1. Blerësi, bazuar në kërkesën vjetore për energji, Aneksi Nr. 1 i kësaj kontrate, dhe në trendin e ngarkesës do t'i paraqesë Shitësit brënda datës 30 tetor, programin vjetor të ndarë me bazë mujore të ngarkesës së klientëve universalë, në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike
2. Blerësi jo më vonë se 7 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit të furnizimit do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë ditore dhe orare të ngarkesës.
3. Blerësi jo më vonë se dita e enjte e çdo jave do ti dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve universalë për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.
4. Blerësi brenda orës 12:00 të çdo dite do ti dërgojë Shitësit programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës sipas afateve të përcaktuara në Rregullat e Tregun Shqiptar të Balancimit.
5. Blerësi, në rastet kur është e nevojshme, brenda orës 15:00 do t'i dërgojë Shitësit përditësim të kërkesës për furnizimin e klientëve fundore për ditën D+2, me bazë orare me qëllim garantimin e furnizimit të plotë për periudhën vijuese.
6. Blerësi pas mbylljes së bilancit energjetik, të muajit duhet t'i dërgojë Shitësit informacionin mbi sasinë e energjisë së faturuar dhe informacione të tjera për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të kësaj kontrate.
7. Blerësi i dërgon shitësit të dhënat lidhur me furnizimin e energjisë për FMF sipas parashikimeve të Aneksit II.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

1. Shitësi bazuar në programet mujore/javore/ditore në day-ahead dhe intra-day do të sigurojë përmbushjen e kërkesës së Blerësit.
2. Shitësi kompenson blerësin për çmimin e energjisë elektrike sipas parashikimeve të Aneksit II të kësaj kontrate.



NENI 6

DETYRIMET KRYESORE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

1. **Përgjegjësia për balancimin e energjisë:** Shitësi dhe blerësi janë subjekte të rregullave në fuqi për balancimin dhe për rrjedhojë përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike përkundrejt OST (deri sa nuk kanë një marrëveshje që rregullon përgjegjësinë e balancimit me të tretët).
2. **“Nominimi (Livrimi dhe Pranimi)”**: Shitësi dhe blerësi do të nominojnë në Platformën e OST për nominimet. Bazuar në konfirmimet e bëra paraprakisht, çka përbën konfirmimin për livrimin (Shitësi) dhe pranimin (Blerësi) e energjisë elektrike objekt i kësaj kontrate. Sasia e programuar nga palët në sistemin për nominime të OST është sasia kontraktuale për të cilën Blerësi do të paguajë Shitësit me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të Kontratës.
3. **Program** sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit dhe pranimit, që përfshin programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës apo me OST, Sasinë e Kontratës, Kapacitetin e Kontratës, Pikën e Livrimit, Programin e furnizimit, Periudhën Totale të Furnizimit, dhe çdo kusht tjetër të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

NENI 7

LIVRIMI, MATJA, TRANSMETIMI DHE RISKU

1. **Rryma/Frekuenca/Tensionet:** Energjia Elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standarteve të parashikuara në Kodet dhe Rregullat në fuqi.
2. **Programet e Deklaruara:** Sasia e Energjisë Elektrike që do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i furnizohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike si dhe Kodet e Rrjetit. Nominimi fizik/programi i livrimit për ditën e nesërme duhet paraqitur në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Kodet në fuqi.
3. **Dokumentacioni i Livrimeve dhe Marrjeve në Dorëzim:** Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët:
- do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e Programeve, sasive, livrimeve dhe pranimit të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të Kontratës Individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike (referuar nominimit në Platformën e OST për nominimet).
4. **Risqet e Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së energjisë së parashikuar në Kontratë deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, pranimit dhe transmetimit të Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.
5. **Pikat e Livrimit:** Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në kufijtë e sistemit të transmetimit të OST, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.



NENI 8

MOS-PERFORMANCA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

- Përkufizimi i Forcës Madhore:** Përveç se kur specifikohet ndryshe, “**Forcë Madhore**” për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore (“**Pala Pretenduese**”), siç përcaktohet në Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi; ose
 - pezullimi nga OST-ja përkatëse i livrimit, pranimi ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
- Çlirimi nga Detyrimet e Livrimit dhe Pranimi:** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës 8.3 (*Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore*), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjeshtë pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës 8 (*Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim*) nuk do t’i merret Palës Pretenduese lidhur me sasi të pa livruara ose të pamarra.
- Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore:** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t’i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimi të Forcës Madhore, do t’i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
- Efektet e Forcës Madhore mbi Palën Tjetër:** Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimi dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimi për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

NENI 9

RAKORDIMI I SASISË SË ENERGJISË TË LEVRUAR PËR QËLLIM TË FURNIZIMIT TË KLIENTËVE

- Shitësi dhe Blerësi jo më vonë se data 10 e muajit do të rakordojnë sasi të energjisë elektrike që kanë shkuar për furnizimin e klientëve universalë, sasi e cila është energjia elektrike totale e nominuar në sistemin për nominime të OST dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë ALPEX.
- Me mbylljen e bilancit mujor të shoqërisë FSHU, jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës, do të rakordohet mbi:
 - Sasinë e energjisë elektrike që nuk ka patur destinacion furnizimin e klientëve universalë por kapatur destinacion mbulimin e humbjeve dhe/ose furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit



- në tregun e lirë. Kjo sasi do të transferohet në marrëdhënien kontraktuale KESH-FTL, ndërsa për efekt të kësaj kontrate Shitësi do të bëjë një faturë sistemuese për FSHU.
- b) Sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi e cila ka shkuar për FSHU. Kjo sasi, është teprica nga prodhimi i burimeve të rinovueshme që rezultojnë nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme që tejkalojnë sasinë e pambuluar të humbjeve totale dhe nevojave të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë
- Sasitë e energjisë elektrike të evidentuara sipas pikes a) dhe b) do të transferohen në marrëdhënien kontraktore KESH-FTL. Për efekt të kësaj kontrate Shitësi do të bëjë në fund të vitit një faturë sistemuese për FSHU. Pagesat sipas faturave sistemuese mes palëve do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e fundit e livrimit për muajin përkatës.
- c) Sasinë e energjisë elektrike që ka shkuar për furnizimin e klientëve, ndarë sipas destinacionit të shitjes së energjisë apo fashës së furnizimit, në referencë të pikës 6, të Nenit 3 të kësaj kontrate, konkretisht :
- klientët e furnizuar në TM 6/10 dhe klientët 20 kV me status të veçantë
 - klientët – shoqëritë e UK në TM 6/10/20/35 kV ;
 - klientët fundorë të lidhur me nivel tensioni 0,4 kV.
3. Për qëllim të zbatimit të kësaj kontrate dhe parashikimeve të nenit 9, palët do të menaxhojnë nëpërmjet marrëveshjes financiare pjesë e kësaj kontrate (Aneksi 2) sasitë e energjisë të cilat shiten për mbulimin e nevojës së klientëve në TM. Në cdo rast sasia e energjisë e nominuar në ALPEX për klientët që furnizohen në TM, do të jetë e tillë që të lejojë palët të rakordojnë në fund të muajit të livrimit sasitë reale me destinacion këta klientë.

NENI 10

MOS PERFORMANCE TË LËVRIMIT OSE PRANIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

- Rasti i mos-performancës ana e shitësit:** Në atë shkallë që Shitësi - Pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike ("Pala Livruese") nuk i livron tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë të përcaktuar/rakorduar për ditën në avance, intra-day, dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala Livruese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Pranuese") një shumë si kompensim për atë sasinë të palëvruar me energji elektrike me koston e sigurimit të kësaj energjie.
- Rasti i mosrespektimit nga ana e blerësit:** Në rastin kur Blerësi ("Pala Pranuese") dështon të pranojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë elektrike të rakorduar për ditën në avancë dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala pranuese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Livruese") një shumë si kompensim për dëmtimet si kompensim për atë sasi të papranuar me energji elektrike me koston e sigurimit të kësaj energjie nga KESH.
- Shuma e pagueshme:** shumat e pagueshme sipas këtij neni do të faturohen dhe paguhen sipas Nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).



NENI 11

PEZULLIMI I LIVRIMIT

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të mundshme, nëse "Pala që nuk përmbush detyrimet" nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas Kontratës, ose sipas kushteve të garancive nëse do aplikohen nuk arrin ta sigurojë, apo zëvendësojë vlerën e kërkuar sipas Kontratës, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet jo më parë se tre (3) Ditë Pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike dhe të çlirohet (jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit sipas gjithë Kontratave specifike deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e tjera) të gjithë shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve, apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE.

NENI 12

KOHËZGJATJA

Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor të vitit 2024.

NENI 13

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË FINANCIARE

- Përrjashtimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumat e pagueshme sipas nenit 8 (**Zhdëmtimet**), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("**Dëmet**"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate specifike) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto Dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mos pagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjëseve, zyrtarëve, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.
- Dëmi Pasues dhe Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:
 - nuk përfshin përgjegjësinë financiare për Dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe
 - kufizohet me një shumë të barabartë me shumat e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo Kontrate specifike përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 8 (**Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim**).
- Mos pagesa e Qëllimshme, Mashtrimi dhe të Drejtat Themelore:** Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:
 - mos pagesën e qëllimshme,
 - mashtrimin; ose
 - çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.
- Detyra për Lehtësimin e Humbjeve:** Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i Legjislacionit në Fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë Dëmet dhe premton që do të përdorë përpjekje



komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo Dëmi që mund të pësojë sipas Kontratës ose lidhur me të.

NENI 14

FATURIMI DHE PAGESA

1. **Faturimi:** Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë elektronike sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të Energjisë Elektrike të lëvruar nga shitësi te blerësi sipas parashikimeve të nenit 9 pika 1, në monedhën Lekë.
Për qëllime të zbatimit të pikës 3 të nenit 2 të kontratës, kur nga Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen nga shteti, janë përcaktuar cmime të shitjes së energjisë elektrike sipas destinacionit të përdorimit nga ana e shoqërisë së furnizimit (kategoria e klientit sipas nivelit të tensionit ku furnizohet dhe/ose fashës së konsumit mujor kur aplikohen çmime të ndryshme shitjeje).
Sasi të energjisë e nominuar në sistemin për nominime të OST do të faturohet me cmimin e përcaktuar për nivelin e tensionit 0.4 kv. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të Muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.
2. **Saktësimi i faturimit:** Shitësi mbi bazën e të dhënave të rakorduara ndërmjet palëve sipas parashikimeve të nenit 9 duhet të korrektojë faturat e lëshuara sipas pikës 1 të këtij neni, duke lëshuar përkatësisht, në monedhën Lekë :
 - a) faturë për energjinë faktike të livruar për klientët e ndryshëm nga klientët universalë në kategorinë Ujësjetllës Kanalizime, çmim, i cili është miratuar dhe me Vendimin Nr.46, datë 02.04.2024 të Entit Rregullator të Energjisë.
 - b) një faturë saktësuese financiare referuar në energjinë faktike të livruar për klientët e furnizuar në TM 6/10/ kV dhe 20 kV me status të veçantë, sipas Nenit 9, shkronja (c), pika (i) dhe Aneksit II të kontratës (Nenit 2, pika 4), për energji të shitur ne ALPEX por të përdorur për furnizim për klientët në tension 0.4 KV.
 - c) një faturë për energjinë faktike për klientët universalë për energji të faturuar mbi fashën me tarifë të rregulluar, nëse është aplikuar, dhe
 - d) një faturë saktësuese për klientët në tension 0.4 KV për sasinë e energjisë që rezultojnë si diferencë midis sasisë totale të faturuar sipas pikës 1 të këtij neni me energjinë e faturuar sipas shkronjës (a) dhe (c) të kësaj pike.
 - e) një faturë për periudhë livrimi të energjisë elektrike 12 mujore, për sasinë e përcaktuar sipas gërmës b) të pikës 2, neni 9, e cila ka patur destinacion furnizimin e klientëve universalë.

Pagesa: Pagesa e faturës principale do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Për faturat sistemuese, data e pagesës do të jetë e njëjta me faturën principale për të cilën bëhet sistemimi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.



NENI 15

TAKSAT DHE TATIMET

Çdo çështje që lidhet me taksat dhe tatimet rregullohet në përputhje me legjislacionin respektiv për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16

TRANSFERIMI

1. **Ndalimi:** Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo transferim i të drejtave dhe detyrimeve bëhet efektiv pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).
2. **Transferimi tek Filialet:** Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një Filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe miratimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

NENI 17

PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Për të adresuar riskun e çdo Pale, përsa i përket mundësisë për përmbushjen e detyrimeve të palës tjetër, dhe për të siguruar përmbushjen e të gjithë detyrimeve që rezultojnë nga kjo Kontratë apo kontrata specifike, Palët mund të dakortësojnë, më parë apo në çdo kohë pas hyrjes në fuqi, ose në kohën pas nënshkrimit të kontratave specifike, ekzistencën e mbështetjes me garanci kredie dhe Garantues sipas kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të dakortësuar prej tyre

NENI 18

PERSONAT E KONTAKTIT

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për Furnizuesi i Shërbimit Universal	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj. Ornela Barko	Z/Znj. Rakela Llanaj
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr.88, Tiranë	Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel: _____	Tel.: _____
Cel: 0694143777	cel: 0694033490
E-mail: ornela.barko@fshu.al	E-mail: llanajr@kesh.al
Programimi	
Z/Znj. Ermira Staka	Z/Znj. Aurora Bego
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr.88, Tiranë	Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
	Tel.: _____



Tel: _____ Cel: 0694147922 E-mail: ermira.staka@ftl.al	cel: 0672135152 E-mail: begoa@kesh.al
Back Office	
Z. Julind Toçila/Arbër Iljazi Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa nr.88, Tiranë Tel: _____ Cel: 0676357843/0686676777 E-mail: julind.tocila@fshu.al /arber.iljazi@fshu.al	Z/Znj. Arben Tase Adresa: Rr.”Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel.: _____ Cel : 0697033335 E-mail: tasea@kesh.al

NENI 19

LEGJISLACIONI NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- Legjislacioni në Fuqi:** Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve:** Nëse palët nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet për zgjidhje EREs. Sa më sipër nuk përjashton të drejtën e palëve për të adresuar nëpërmjet Gjykatës zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje të krijuar në interpretim apo kuptim të kësaj kontrate.

NENI 20

TË NDRYSHME

- Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, gjithë njoftimet, deklaratat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim (postë të shpejtë ose korrier). Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:
 - nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së fundit të livrimit;
 - nëse dërgohen me postë, Ditën e 2^{te} të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5^{te} të Punës pas ditës së postimit;
 - nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
- Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.
- Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken.



ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Në rast se legjislacioni në fuqi sjell ndryshime të dispozitave të kësaj kontrate, deri në miratimin nga ERE të këtyre ndryshimeve, legjislacioni i zbatueshëm do të prevalojë në kuptimin dhe interpretimin e këtyre dispozitave.

NENI 21

MIRATIMI I ERE-S DHE EFEKTET

1. Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor për vitin 2024.
2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n lidhur me nenshkrimin e kësaj kontrate, e cila hyn në fuqi pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë.
3. Kjo kontratë Tip mund të ndryshohet vetëm me miratimin e Entit Rregullator të Energjisë.
4. Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” SH.A.

“Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A.

Erinda Sub
ADMINISTRATOR

Alban Kuzi
ADMINISTRATOR



Shtojca 1: Programet e livrimit sipas Neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate

Shtojca 2: Sipas Nenit 19, të kësaj kontrate “Pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të Palëve për regjistrimet telefonike”



ANEKSI NR. 1

“Parashikimi i sasisë së plotë vjetore të konsumit të FSHU SH.A. për vitin 2024”



Ndërmjet shoqërive:

Në datë ____/____/____, KESH sh.a. ka livruar/nonimuarnë sistemin për nominime të OST energjinë elektrike sipas raportit të mëposhtëm:

Data/Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Totale
01/ /2024																									
02/ /2024																									
03/ /2024																									
04/ /2024																									
05/ /2024																									
06/ /2024																									
07/ /2024																									
08/ /2024																									
09/ /2024																									
10/ /2024																									
11/ /2024																									
12/ /2024																									
13/ /2024																									
14/ /2024																									
15/ /2024																									
16/ /2024																									
17/ /2024																									
18/ /2024																									
19/ /2024																									
20/ /2024																									
21/ /2024																									
22/ /2024																									
23/ /2024																									
24/ /2024																									
25/ /2024																									
26/ /2024																									
27/ /2024																									
28/ /2024																									
29/ /2024																									
30/ /2024																									
31/ /2024																									

- Sasia totale e energjisë e nominuar në sistemin për nominime të OST dhe ALPEX _____
- Sasia e energjisë elektrike për efekt shkëmbimi/humbje _____
- Sasia e energjisë e nominuar nga FSHU SH.A. për:
 - Klientët universalë _____
 - Klientët e ndryshëm nga klientët universalë _____

Konfirmuar nga KESH:

Konfirmuar nga FSHU:

Nr. 2436/3 Prot., datë 31.05.2024Nr. 3823/ Prot., datë 30.05.2024**ANEKSI II**

PËR RREGULLIMET FINANCIARE TË MARRËDHËNIES SË SHITBLERJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, KESH SH.A. DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SH.A., PËR PERIUDHËN KOHORE 01.01.2024-31.12.2024

E lidhur sot më datë 30.05.2024 ndërmjet:

Shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) SH.A., shoqëri aksionare regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rrugën “Viktor Eftimi”, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga Z. **Erlind Sulo**, Administrator i shoqërisë që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A., shoqëri aksionare, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530016L, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. **Algert Luzi**, Administrator i shoqërisë, që më poshtë do të quhet “Blerësi”

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Palët me vullnetin e tyre të lirë e të përbashkët bien dakord lidhur me përmbajtjen e këtij Aneksi të kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike, me qëllim rregullimin financiar të marrëdhënies së shitblerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbimin publik për furnizimin e FSHU SH.A. të sasisë së energjisë që përdoret për përmbushjen e detyrimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, si më poshtë vijon:

NENI 1**Qëllimi**

1.1 Ky Aneks, si pjesë e kontratës Tip së shitblerjes së energjisë elektrike (së bashku me Shtojcat e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien financiare të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore 01.01.2024 – 31.12.2024.

Marrëdhënia e shitjes dhe e blerjes së energjisë fizike ndërmjet Palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për energji për përmbushjen e rolit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF) do të



realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë që më poshtë do të quhet “ALPEX”, në ditën në avancë.

NENI 2

Përkufizime

- 2.1 Sasia e kontraktuar** - është sasia totale e energjisë e kontraktuar mes palëve në ALPEX.
- 2.2 Çmimi i shitjes së energjisë fizike** - është çmimi që do të rezultojë në bazë ditore nga shitblerja e energjisë në ALPEX.
- 2.3 Çmimi i rregulluar i energjisë elektrike** – është çmimi i shitjes së energjisë elektrike i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë publike së prodhimit, KESH SH.A., në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar.
- 2.4 Vlera e kompensimit** - është vlera që do të rezultojë si diferencë e çmimit të shitjes në ALPEX dhe çmimit të rregulluar të shitjes, në bazë ditore, për sasitë e qarkulluara të energjisë mes palëve. Palët do të rakordojnë mes tyre sipas Shtojcës Nr. 1 pjesë e këtij Aneksi.

NENI 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

- 3.1** Para hapjes së portës së ofertimit në DAM/ ALPEX, Blerësi dhe Shitësi do të rakordojnë me njëri-tjetrin programin ditor të energjisë me bazë orare të parashikuar për nevojat e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 6/10 kV dhe 20 kV me status të veçantë, në përputhje me dispozitat e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe parashikimeve të kontratës.
- 3.2** Palët do të paguajë njëra tjetrën për energjinë e qarkulluar sipas çmimeve që do të rezultojnë në ALPEX për ditën në avancë.
- 3.3** Shitësi bazuar në programet javore/ditore dhe përpara hapjes së portës, do të sigurojë përmbushjen e kërkesës së Blerësit, nëpërmjet ALPEX.
- 3.4** Shitësi do të kompensojë diferencën e çmimit mes çmimit të shitjes së energjisë për ditën në avancë në ALPEX dhe çmimit të rregulluar të energjisë, miratuar nga organet drejtuese sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456 datë 29.06.2022, i ndryshuar.
- 3.5** Blerësi do të kompensojë diferencën e çmimit, mes çmimit të rregulluar të energjisë miratuar nga organet drejtuese sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456 datë 29.06.2022, i ndryshuar dhe çmimit të shitjes së energjisë për ditën në avancë në ALPEX.
- 3.6** Kompensimet nga Shitësi dhe nga Blerësi, do të bëhen në monedhën Euro. Konvertimi në Euro i çmimit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456 datë 29.06.2022, i ndryshuar, do të bëhet me kursin e këmbimit si në faturën nga ALPEX për të njëjtën datë livrimi.

NENI 4

Faturimi dhe pagesa

- 4.1 Fatura:** Të dyja palët pasi kanë kleruar sasitë e energjisë në ALPEX në ankandin përkatës për cdo Njësi Kohore Tregtimi për ditë të caktuara livrimi, do të bëjnë rregullimin nëpërmjet faturimit për diferencën midis çmimit klerues për Njësi Kohore të Tregut për këtë ditë livrimi me çmimin e parashikuar në kontratë. Fatura do të jetë ditore, me qëllim barazimet financiare të energjisë sipas pikës 6, të këtij neni dhe do të lëshohet nga pala e cila mban të drejtën e kompensimit. Fatura do të lëshohet në raportin e hartuar nga palët sipas pikës 2, të këtij neni. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet në ditën D për cdo proces ankandi në



DAM të ditës D-1, dhe kur kjo ditë është ditë pushimi dhe ose festë zyrtare, ditën e ardhshme më të parë të punës, për secilin proces ankandi të ditës D-1.

4.2 Raporti: Palët do të hartojnë një raport i cili pasqyron diferencat midis çmimit të DAM/ALPEX dhe çmimit të kontraktuar për sasi të energjisë që shitësi i ka shitur blerësit gjatë një dite, sipas parashikimeve të kësaj kontrate. Ky raport do të shërbejë për lëshimin e faturës sipas pikës 1, të këtij neni.

4.3 Pagesa: Palët do të paguajnë vlerën e faturës sipas pikës 1 brenda ditës së nesërme të lëshimit të faturës dhe ekzekutimit të pagesës së faturës së shitjes së energjisë në ALPEX, në llogarinë bankare të dedikuar për transaksione e kryera në Bursë. Data e pagesës do të konsiderohet data kur fondet janë transferuar nga llogaria e blerësit.

4.4 Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse pala nuk arrin të kryejë pagesën brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, penaliteti për dëmet e shkaktuara si pasojë e vonesës do të llogaritet në përputhje me ligjin nr.48/2014, “Për vonesat në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i ndryshuar.

4.5 Përkufizimi i Kontratës në treg: Kjo Kontratë do të trajtohet si Kontratë OTC në DAM ALPEX, ku i jepet përparësi përputhjes së Urdhër Porosive të blerësit dhe shitësit. Si Blerësi ashtu edhe Shitësi do të krijojnë një portofol (të dedikuar për zbatimin e detyrimeve të OTC) në ALPEX DAM për të përmbushur vëllimet sipas kësaj Kontrate.

4.6 Barazimet financiare të energjisë elektrike: ALPEX do të sigurojë shlyerjen e volumit të kontraktuar në ALPEX DAM, sipas Rregullave të Tregut. Nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i lartë se çmimi i kontratës, Shitësi do të kompensojë blerësin për diferencën midis çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës. Përkatësisht, nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i ulët se çmimi i kontratës, blerësi do të kompensojë shitësin për diferencën ndërmjet çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës.

4.7 Realizimi i Transaksioneve dhe Tregtimi: Tregtimi i energjisë elektrike përfshin përputhjen e Urdhërporosive të blerjes dhe shitjes dhe do të bëhet sipas dispozitave të rregullave të tregut të ALPEX. Volumet që do të kërkojë Blerësi në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate për një ditë të caktuar levrimi dhe për çdo njësi kohore tregu, do të ofertojnë në Sistemin e Tregtimit të Energjisë (ETSS) në përputhje me dispozitat Rregullave të ALPEX-it dhe procedurat, nëpërmjet portofolit të tij, ndërkohë shitësi duhet që po nëpërmjet portofolit të tij (të dedikuar për zbatimin e OTC) të ofertojë për të njëjtën ditë levrimi dhe të njëjtat volume për çdo Njësi Kohore Tregu.

NENI 5

Hyrja në fuqi

5.1 Ky Aneks kontrate nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

5.2 Ky Aneks nënshkruhet nga palët dhe hyn në fuqi pas miratimit nga ERE.

“Korporata Elektroenergjitike
Shqiptare” SH.A.

Erlind Subo
ADMINISTRATOR

“Furnizuesi i Shërbimit Universal”
SH.A.

Alger
ADMINISTRATOR



SHTOJCA 1

RAKORDIM DITOR KESH SH.A. –FSHU SH.A.

Ndërmjet shoqërive:

Për periudhën-...2024, KESH sh.a. ka livruar dhe FSHU sh.a. ka pranuar energjinë elektrike për mbulimin e nevojës për furnizim nën FMF sipas raportit të mëposhtëm:

Data\ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Totale
/ /2024																									
Totale																									

Tipi i kontratës: Kontrate OTC. Kursi i Euro do të merret kursi i ditës së lëshimit të faturës

Data	Sasia MWh	Çmimi mesatar DAM/ALPEX Euro/MWh	Vlera në Euro	Kursi i Këmbimit	Vlera e faturës në lekë	Vlera sipas çmimit të kontratës OTC(lekë/MWh)	Diferenca në lekë	Fatura në Euro	Fatura me TVSH

Konfirmuar nga “KESH” SH.A.:

(emër, mbiemër, firmë)

Konfirmuar nga “FSHU” SH.A.:

(emër, mbiemër, firmë)

KËRKESË

Nr. 4/9, datë 30.5.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi i Qendrës së fshatit Liboshë, Njësia Administrative Liboshë, Bashkia Fier’”. Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për

pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “truall”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 1,294,661 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI RIKUALIFIKIMI I QENDRËS SË FSHATIT LIBOSHË, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOSHË, BASHKIA FIER”

Nr.	EMËR ATËSIA MBIEMËR	Zona kad.	NR. pas.	Lloji i pasurisë	Sip. e truallit gjithsej (m ²) /arë	Sip. e objektit të banimit (m ²)	Sip. e truallit që preket (m ²) /arë	Sip. e objektit të shërbimit (m ²)	Çmimi objektit të banimit (l/m ²)	Çmimi i truallit (l/m ²)/arë	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera e objektit të banimit (lek)	Vlera e truallit (lek)	VLERA totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lek)	SHËNIME MBI STATUSIN JURIDIK TË PASURISË	KONFIRMIM ASHK FIER
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1	Urani Kovi Shyte	2443	16/24-N3	Njësi				33,50			425,477			425,477	ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 16.5.2011	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
2	Qibarete Hasim Hasani	2443	16/24-N4	Njësi				33,50			194,348			194,348	ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 6.4.2012	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
3	Katerina Ndini Babuli 7/12 Grigor Thoma Babuli 5/12	2443	16/24-N5	Njësi				33,50			561,824			561,824	ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 10.6.2014	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
4	Qibarete Hasim Hasani	2443	16/27-ND	Ndërtesë				32,92			113,012			113,012	ME CERTIFIKATË PRONËSIE DATË 9.4.2012	ME CERTIFIKATË PRONËSIE
SHUMA TOTALE														1,294,661		

Shënim 1. Vlerësimi i pasurisë së paluajtshme është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.

Shënim 2. Çmimet për zërat e punimeve janë marrë nga EKB-ja të miratuara për qytetin e Fierit për vitin 2016.

Shënim 3. Çmimet për zërat e punimeve që nuk përfshihen në EKB të miratuara për qytetin e Fierit, jemi referuar Manualit Teknik miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.75.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

**KËRKESË**

Shtetasja Angje Matosha, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ernest Matosha, me atësi Vlash dhe amësi Angje, i datëlindjes 13.3.1967, lindur në Nenshat, Shkodër.

KËRKUESE
Angje Matosha

KËRKESË

Shtetasja Katerina Papa kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Latif Balo, me atësi Elmaz dhe amësi Asime, i datëlindjes 28.3.1964, lindur në Sarandë dhe banues në Çukë, Bashkia Sarandë, si dhe caktimin e saj si kujdestare të pasurisë së tij.

KËRKUESE
Katerina Papa

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 416 lekë

